



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në "Psikologji",
me profil "Psikologji Shkollore"**

ofruar nga

Universiteti i Tiranës

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:


Prof.as.Dr. Valentina Haxhiymeri

Prof.as.Dr. Erika Melonashie

Korrik/ 2025

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Master i Shkencave në "Psikologji", me profil "Psikologji Shkollore".**

1	IAL aplikues:	Universiteti i Tiranës Fakulteti i Shkencave Sociale
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Pedagogjisë Psikologjisë
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në "Psikologji" me profil në "Psikologji Shkollore"
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASH Nr. 53, datë 13.02.2012
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër Nr. 213, datë 19.06.2023
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i II- të
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	Raporti PAE/PAK për mbulimin ngarkesës mësimore të programit të studimit, për vitin akademik 2023-2024, rezultojnë: PAE (75.3%) me PAK (24.7%). 2022-2023: 13 PAE/ 8 PAK 2023-2024: 13 PAE/ 7 PAK
18	Numri i studentëve:	➤ 2022 – 2023: 33 studentë ➤ 2023 – 2024: 31 studentë
19	Komente / të tjera:	-



PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti i Tiranës (UT) është institucion publik i arsimit të lartë, hapur me Vendim nr. 207, datë 30.05.1957 të Këshillit të Ministrave. Përgjatë viteve, ky institucion ka pësuar një sërë ndryshimesh kryesisht në strukturën e tij. Pavarësisht kësaj, UT mbetet institucioni i arsimit të lartë më i madh në vend. UT është akredituar institucionalisht me Vendim nr. 04, datë 27.01.2023 të Bordit të Akreditimit, me kohëzgjatje 6 vite. Afati i vlefshmërisë së akreditimit institucional përfundon në 26.01.2029.¹

Fakulteti i Shkencave Sociale, ku ofrohet programi i studimit i marrë në vlerësim është pjesë përbërëse e strukturës akademike të Universitetit të Tiranës. Fillimisht, ky fakultet është hapur me VKM nr. 348, datë 31.07.1992 me emërtim “Fakulteti i Punës Sociale”.² Në vitin 1993, me Urdhër nr. 18 datë 31.07.1993, të Ministrisë së Arsimit, fakulteti emërtohet “Fakulteti i Shkencave Sociale” duke përfshirë në strukturën e tij edhe departamentin e “Psikologjisë dhe Pedagogjisë”, i cili deri në këtë kohë ishte pjesë përbërëse e Fakultetit të Histori – Filologjisë.³

Programi i studimit Master i Shkencave në “Psikologji” me profil në “Psikologji Shkollore” është hapur me Urdhër të MAS, nr. 53, datë 13.02.2012 “Për hapjen e programeve të studimeve “Master Profesional” dhe “Master i Shkencave”, të Universitetit të Tiranës”.⁴ Programi realizohet me 120 kredite dhe kohëzgjatje normale të studimeve dy vite akademike, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë universitare “Master i Shkencave” në “Psikologji” me profil në “Psikologji Shkollore”.

Së fundmi, me Vendim të Senatit Akademik të UT nr. 47, datë 28.10.2024 “Për miratimin e ndryshimeve deri në masën 20%, të planit mësimor të ciklit të dytë të studimeve, në Fakultetin e Shkencave Sociale, të UT-së, për vitin akademik 2025-2026”,⁵ programi i studimit “Master i Shkencave” në “Psikologji”, me profil në “Psikologji Shkollore”, ka pësuar ndryshime në masën 20% në përmbajtjen e kurrikulës, me synim përshtatjen e lëndëve formuese me kërkesat e nevojave të tregut dhe përditësimin e vazhdueshëm me zhvillimet shkencore të kësaj fushe studimore në Evropë dhe më gjerë.

Programi i studimeve “Master i Shkencave” në “Psikologji” me profil në “Psikologji Shkollore”, klasifikohet në nivelin 7 të studimeve sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Programi ofrohet në gjuhën shqipe dhe në formën e studimit me kohë të plotë. Programi ka për mision zhvillimin e mendimit kritik dhe përgatitjen e profesionistëve me kompetenca të avancuara teorike dhe praktike në psikologjinë shkollore. Programi ofron një kurrikule bashkëkohore dhe një proces arsimor

¹ Dokumenti 189/1.19. Akreditimi UT-vendim-nr.04-date-27.01.2023.pdf

² Dokumenti 27/2.1.VKM Nr. 348, datë 10.8.1992 “Për hapjen e Fakultetit të Punës Sociale”.pdf

³ Dokumenti 28/2.2.Urdhër i MA Nr. 18, datë 31.07.1993 hapja FSHS dhe Dep FIL-Soc.pdf; Dokumenti 61 ose 147/3.1. Vendimi për hapjen e Departamentit.pdf;

⁴ Dokumenti 196/3.4. Urdhëri për hapjen e programit të studimit.pdf

⁵ Dokumenti 153/3.15.4. Miratim senati për përmirësimin e kurrikulës së programit.pdf

konkurues për përmirësimin e cilësisë së jetës dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Ai synon formimin e studiuesve dhe specialistëve të nivelit të lartë që i përgjigjen prioriteteve kombëtare dhe ndërkombëtare në arsim.⁶

Programi studimeve i ciklit të dytë Master i Shkencave në Psikologji me profil në Psikologji Shkollore, ofrohet nën përgjegjësinë e Departamentit të Psikologji – Pedagogjisë⁷ (Pedagogji – Psikologjisë)⁸ i cili vepron si njësi bazë mësimore-kërkimore në fushën e psiko-pedagogjisë, në përbërje të Fakultetit të Shkencave Sociale, të Universitetit të Tiranës.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Ky raport prezanton rezultatet e procesit të vlerësimit të jashtëm të cilësisë së programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në Psikologji, me profil në Psikologji Shkollore, në FSHS, të UT, kryer nga Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ), i kontraktuar nga ASCAL.

Qëllimi i këtij procesi është që të sigurojë një vlerësim profesional, të pavarur dhe objektiv, të bazuar në tregues real dhe të matshëm të nivelit të arritjes së standardeve dhe garantimit të cilësisë së programit të studimit të përfshirë në vlerësim, mbi të cilin do të ngrihet gjykimi i Bordit të Akreditimit të ASCAL për akreditimin e tij. ASCAL bazuar në “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017”, ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga UT, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm. Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje: Prof.as. Dr. Erika Melonashi dhe Prof.as.Dr. Valentina Haxhiymeri. Gjatë gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga koordinatoria teknike e ASCAL, Msc. Rajna Lila. Vizita u realizua në datat 10 dhe 11 shkurt, 2025. Për të përmbushur me sukses këtë qëllim, GVJ mori në konsideratë udhëzimet etike dhe metodologjike të bëra me dije përmes trajnimeve paraprake nga specialistë të sektorit përkatës të ASCAL. Dokumentacioni bazë, mbi të cilin u mbështet procesi i vlerësimit të jashtëm për programin e studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në Psikologji me profil në Psikologji Shkollore, në FSHS, të UT, është:

- Ligji Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”,
- “Kodi i Cilësisë së Arsimit të Lartë” miratuar me VKM Nr.824, datë 24.12.2021,

⁶ Dokumenti 1/ 3.23. RVB ne gjuhen shqipe.pdf (fq.4)

⁷ Dokumenti 5/1.2.Statuti 2018.pdf; (Statutit të UT, 2018, Kreu II “Organizimi dhe strukturat përbërëse”, Neni 11 “Njësitë përbërëse të UT”, Pika 2, fq. 7).

⁸ Dokumenti 29/ 2.4.Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale 2023.pdf; Dokumenti 110/ 5.4. Rregullorja e programit te studimit.pdf (anglisht) Neni 5, fq.3

- "Raporti i Vlerësimit të Brendshëm" (mars, 2022);
- Dosja e VV me një tërësi të dispozitave normative, akteve dhe dëshmime të ngarkuara nga IAL në e-ASCAL, si dhe të dhëna të tjera të siguruar nga vizita në institucion, ushtruar në datat 10 dhe 11 shkurt, 2025, sipas një agjende të paracaktuar nga ASCAL, dhe informacioni i publikuar në faqen e webit-it të IAL-së.

Parimet kryesore që udhëhoqën veprimtarinë e GVJ janë:

- Qëndrim korrekt, pa paragjykime dhe plot respekt ndaj drejtuesve të IAL-së, stafit, studentëve dhe përpjekjes së tyre për të arritur standardet dhe cilësinë e dëshiruar;
- Bashkëpunim i sinqertë, nën frymën e besimit reciprok, për të siguruar një vlerësim të paanshëm, real, të mbështetur në dëshmi dhe tregues të matshëm të cilësisë;
- Objektivet në shqyrtimin dhe prezantimin e rezultateve të vlerësimit të jashtëm lidhur me nivelin e arritjes së standardeve dhe cilësisë;
- Transparencë për të mundësuar një proces konstruktiv të rishikimit të RVJ përpara publikimit të tij.

Për mbarëvajtjen e procesit të vlerësimit të jashtëm, kontribuan jo vetëm ekipi i caktuar nga ASCAL, por edhe autoritetet drejtuese, stafi dhe studentët e programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në Psikologji, me profil në Psikologji Shkollore, të FSHS, në UT, për të cilët GVJ shpreh vlerësime të posaçme për gatishmërinë dhe frymën e bashkëpunimit të treguar, si dhe për sensin e mirëkuptimit dhe besueshmërinë që ata i dhanë GVJ, duke vënë në dispozicion të tyre dokumentacionet e nevojshme për vlerësim.

Më datë 18.06.2025, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 22/25 Prot., Datë 18.06.2025, dërgohet në Institucion Draft-Raporti i Vlersimit të Jashtëm. IAL përcolli komentet me shkresë zyrtare Nr. 1981/3 Prot, Datë 08.07.2025.

Memo / Raporti i Vlerësimit të Jashtëm të programit të ciklit të dytë të studimeve "Master i Shkencave" në "Psikologji" me profil "Psikologji Shkollore", Universiteti i Tiranës.

Referuar shkresës së Institucionit të Arsimit të Lartë Publik, Universitetit të Tiranës, me emërtim "Komente lidhur me Draft Raportin e ekipit të ekspertëve", në përgjigje të procesit të rishikimit të përmbajtjes së Draft/Raportit të Vlerësimit të Jashtëm të Cilësisë së programit të ciklit të dytë të studimeve "Master i Shkencave" në "Psikologji" me profil "Psikologji Shkollore", Grupi i Vlerësimit të Jashtëm shqyrtoi me vëmendje të posaçme çështjet e diskutueshme të përshkruara në këtë shkresë dhe konkludoi si më poshtë:

1. Rekomandimi përkatës referuar Standardit II.1, Kriteri 1 dhe 3, është bazuar në shqyrtimin e të dhënave të pasqyruara në dokumentin “Plani Mësimor” (2018-2019)⁹, të cilin institucioni e ka dorëzuar në e-ASCAL në kuadër të procesit të vlerësimit të jashtëm të programit të ciklit të dytë të studimeve “Master i Shkencave” në “Psikologji”, me profil “Psikologji Shkollore”.

GVJ ka cilësuar në përmbajtjen e RVJ (2025) si praktikë pozitive angazhimin e institucionit në procesin e përmirësimit të vazhdueshëm të programit të studimit të marrë në vlerësim, referuar deklaratës së tij në RVB (2024) ku mësohet se **“propozimi (me ndryshime) i njësisë bazë është miratuar nga Senati Akademik me vendim nr. 45, datë 28.10.2024, dhe pritet implementimi për vitin akademik të jetë konform udhëzimeve në fuqi (fq.22)”**¹⁰

GVJ sqaron se nuk ka gjetur të depozituar në e-ASCAL dokumentin e Planit Mësimor (me ndryshime) që pritet të gjej zbatim, ndaj rekomandimi përkatës është arsyetuar bazuar në Planin Mësimor (2018-2019) i cili ka qënë në zbatim gjatë realizimit të procesit të vlerësimit të jashtëm të programit të studimit “Master i Shkencave” në “Psikologji”, me profil në “Psikologji Shkollore”.

GVJ vendosi që rekomandimi për përmbushjen e Standardit II.1, Kriteri 1 dhe 3, të mbetet i pandryshuar.

2. Lidhur me Standardit II.1, Kriteri 7, GVJ mori në konsideratë përshkrimin e detajuar dhe analizën krahasuese të institucionit në shkresën “Komente lidhur me Draft Raportin e ekipit të ekspertëve”, dhe konkludoi se programi i studimit i “Master i Shkencave” në “Psikologji”, me profil në “Psikologji Shkollore”, ka përmbajtje të ngjashme, së paku 70 %, me programet e tjera të studimit, që ofrohen nga IAL të tjera brenda vendit tonë, në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë.

GVJ do të dëshironte që informacioni i paraqitur në shkresën “Komente lidhur me Draft Raportin e ekipit të ekspertëve”, për Standardin II.1, Kriteri 7, të ishte dokumentuar paraprakisht në e-ASCAL ose të ishte raportuar nga institucioni në përmbajtjen e RVB (2024).

GVJ gjykon se informacioni i argumentuar nga institucioni në shkresën “Komente lidhur me Draft Raportin e ekipit të ekspertëve”, përbën një dëshmi të qartë të përmbushjes së Standardit II.1, Kriteri 7, si dhe një tregues domethënës të përputhshmërisë së programit të studimit të marrë në vlerësim, me Nenin 86, pika 2 të Ligjit nr. 80/2015 për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë.

GVJ vendosi të reflektojë komentin në përmbajtjen e RVJ (2025) lidhur me Standardin II.1, Kriteri 7, duke hequr paragrafin e mëposhtëm:

“Sidoqoftë, GVJ vlerëson se nuk është plotësisht e qartë se sa për qind e kurrikulës së programit të studimit Master i Shkencave në Psikologji, me profil Psikologji Shkollore, i cili

⁹ Dokumenti 99/4.2. Plani mësimor i programit të studimit.pdf

¹⁰ Dokumenti 1/ 3.23. RVB ne gjuhen shqipe.pdf

ofrohet nga Universiteti i Tiranës, është me përmbajtje të ngjashme me programet e studimit të ofruara në universitetet të tjera brenda vendit, të cilat janë në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë.”

3. Përsa i përket Standardit II.2, Kriteri 1, GVJ sqaron se rekomandimi është bazuar në shqyrtimin e të dhënave të pasqyruara në dokumentin “Aneks-Tabela përmbledhëse: Tabela 2 dhe Tabela 3”,¹¹ për PAK të angazhuar në dy vitet e fundit në realizimin e programit të studimit të marrë në vlerësim. Të dhënat tregojnë se për vitin akademik 2023-2024, rezulton 28.6% i PAK i kualifikuar me titull dhe gradë shkencore, dhe 71.4% e tij me nivelin MSc të kualifikimit. Për vitin akademik 2022-2023, rezulton 50% e PAK e kualifikuar me titull dhe gradë shkencore, dhe 50% me nivelin MSc të kualifikimit.

Institucioni shpjegon në shkresën “Komente lidhur me Draft Raportin e ekipit të ekspertëve”, se “është reflektuar në vitin 2024-2025 ku numri i PAK është 5, nga të cilët 1 mban titull Prof.Dr., 2 kanë gradën Dr., dhe 2 janë në proces doktorature”.

GVJ sqaron se të qenit në proces doktorature nuk nënkupton që PAK ka fituar gradën shkencore. Në këtë rast, PAK në proces doktorature kualifikohet në nivelin MSc.

Duke qenë se Ligji Nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë”, Neni 59, pika 6 i tij, shpreht qartë se “Personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës”, rekomandimi i GVJ për Standardin II.2, Kriteri 1, mbetet i pandryshuar.


4. Referuar Standardit IV.3 Kriteri 6, GVJ ka marrë në shqyrtim komentin e institucionit në shkresën “Komente lidhur me Draft Raportin e ekipit të ekspertëve”, dhe ka ristrukturuar paragrafin përkatës, duke reflektuar si më poshtë:

“Biblioteka përban një fond tekstesh bazë në funksion të programit të studimit dhe siguron akses në biblioteka online. Gjithsesi, gjykohet se nevojitet një përpjekje për të rritur numrin e posteve fizike për akses online (aktualisht vetëm 10), dhe nga vizita në institucion u konstatua se janë ndërmarrë hapa konkrete përmes përmirësimit të infrastrukturës me shtesën e një kati. Gjithashtu, rekomandohet inicimi i praktikës së mirë të raportimit periodik nga ana e bibliotekës në lidhje me shkallën e shfrytëzimit të materialeve/literaturës dhe rekomandimeve përkatëse për përmirësim.”

5. Për Standardin VI.4 Kriteri 1 dhe Kriteri 5, GVJ gjykon se informacioni shtesë i vënë në dispozicion nga institucioni në shkresën “Komente lidhur me Draft Raportin e ekipit të ekspertëve”, përbën evidencë për përfshirjen e palëve të treta në procesin e përmirësimit apo rritjes së cilësisë të programit të studimit, por jo në atë të vlerësimit të cilësisë, i cili është proces më vete. Për këtë arsye, GVJ i qëndron konkluzioneve të nxjerra për Standardin VI.4, përkatësisht Kriteri 1 dhe 5, si më poshtë:

“Institucioni përfshin aktorët e brendshëm si studentët dhe stafin akademik në procesin e vlerësimit të cilësisë por GVJ nuk gjeti evidencë të dokumentuar, formale, për përfshirjen e

¹¹ Dokumenti 165/4.16. Aneksë tabelë përmbledhëse ASCAL.pdf



alumni apo palëve të treta në procesin e vlerësimit të cilësisë. Pavarësisht se aktorët e jashtëm përfshihen në realizimin e programit të studimit, GVJ nuk gjeti informacion mbi përfshirjen e tyre aktive në procesin e vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë.”

Së fundi, duke vlerësuar si serioz dhe të dobishëm angazhimin e Institucionit të Arsimit të Lartë Publik, Universitetit të Tiranës/Fakultetit të Shkencave Sociale në procesin e rishikimit të Raportit të Vlerësimit të Jashtëm, grupi i vlerësimit i uron suksese të mëtejshme në përpjekjen e tij për të përmirësuar cilësinë dhe arritur standardet e dëshiruara.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof.as.Dr. Valentina Haxhiymeri

Prof.as.Dr. Erika Melonashi




Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Psikologji”, me profil në “Psikologji Shkollore”.

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Universiteti i Tiranës është një Institucion i Arsimit të Lartë i cili ofron programe studimi në përputhje tërësore me vlerat dhe interesat më të larta kombëtare. Në Statutin e UT (2018), Neni 5 i tij “Misioni”, deklarohet se <i>“Universiteti i Tiranës është një universitet publik që ofron një gamë të plotë të programeve të nivelit bachelor, master dhe studime doktorale. Universiteti kontribuon në zhvillimin e shoqërisë, përmes tre shtyllave të misionit të arsimit të lartë: kërkim shkencor, edukim, si dhe shërbim ndaj publikut që vazhdimisht pasurojnë dhe informojnë njëra-tjetrën. Ne ofrojmë edukim me në qendër studentin, si dhe nxsisim rritjen personale dhe intelektuale, për të përgatitur studentë për karrierë produktive dhe qytetare, të përgjegjshëm në një shoqëri globale”</i> . ¹² Programi i studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në Psikologji, me profil në Psikologji Shkollore, ofruar nga Departamenti i Pedagogjisë dhe Psikologjisë (DPP), në FSHS, të UT-së, është në përputhje me interesat kombëtare, me Ligjin Nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë”, si dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore të dala në zbatim të tij. Sipas “Kornizës konceptuale të programit të studimit Master i Shkencave në Psikologji, me profil në Psikologji Shkollore”, programi ka si objektiva parësor (a) “përgatitjen e specialistëve të lartë dhe studiuesëve në fushën e studimeve pedagogji-psikologjike, projekteve kërkimore mbi dukuri dhe problematika sociale, rekomandimeve për politikat publike arsimore dhe vlerësime të impaktit të reformave sociale”, (b) mbështetjen me njohuri të integruara të studiuesve të ardhshëm të dukurive pedagogji-psikologjike, me qëllim formimin e aftësimin e psikologëve shkollore dhe pajisjen e tyre me njohuri, qëndrime e shkathtësi,

¹² Dokumenti 5/ 1.2.Statuti 2018.pdf



	<i>kryesisht në fushën e zhvillimit personal e social dhe në fushën e psiko-patologjive, në fushën e matjes dhe të vlerësimit, në fushën e pedagogjisë dhe këshillimit, të aftë që të ofrojnë shërbime bashkëkohore në fushën e psikologjisë shkollore, për t'i shërbyer nxënësit, shkollës dhe sistemit arsimor, në funksion të parandalimit dhe minimizimit të shfaqjeve të problemeve shoqërore gjatë reformave të niveleve të ndryshme, si dhe të ndryshimit të shpejtë dhe shumëpërmasor të shoqërisë shqiptare”, etj.¹³</i> Programet e studimit të ofruara nga UT, përfshi edhe programin e studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në Psikologji, me profil në Psikologji Shkollore, synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. Ky synim gjen shprehje në dokumentin “Strategjia e Zhvillimit të Universitetit të Tiranës, 2023-2028”, seksioni “Përmirësimi i arsimit dhe novacionit të studimeve”, ku mes të tjerash, theksohet se “Programet e studimit në UT kanë për qëllim të përbashkët zhvillimin e arsimit, kulturës, shkencës dhe ekonomisë në shërbim të lirisë dhe diversitetit të ideve, për ndërtimin e konsolidimin e shoqërisë demokratike dhe shtetit ligjor për rritjen e mirëqënies e dinjitetit njerëzor... Të gjitha programet e studimit në UT, kanë si emërues të përbashkët: nxitjen e mendimit kritik dhe krijues me qëllim zhvillimin e frymës së qytetarisë demokratike, krijimin e një hapësire publike universitare të karakterizuar nga debati i lirë, serioz dhe përkushtimi për të mirën publike” (fq.6). Në seksionin “Përparimi i kërkimit shkencor dhe mbështetja e novacionit përmes qendrave të shkëlqyera kërkimore dhe përmirësimit të renditjes së universitetit”, deklarohet se: “Qëllimi i Universitetit të Tiranës është përgatitja e specialistëve shqiptarë që do t'i shërbenin vendit dhe do të ishin në gjendje të manovronin në një botë gjithnjë në ndryshim” (fq.11).¹⁴ Në dokumentin “Strategjia e zhvillimit të Departamentit të Pedagogji-Psikologjisë, 2020-2024” seksioni IV, shprehet se “Në programet e ofruara, DPP është përpjekur të përshtasë traditat më të mira morale, kulturore, historike, arsimore dhe shkencore të vendit, si dhe të praktikojë modelet më të mira kurrikulare të vendeve perndimore” (fq.7).¹⁵
--	---

¹³ Dokumenti 100/ 4.1. Korniza konceptuale e programit të studimit.pdf e-ASCAL, fq.3-4

¹⁴ Dokumenti 9/1.4. Strategjia-e-Zhvillimit-e-Universitetit-te-Tiranes-2023-2028.pdf

¹⁵ Dokumenti 62/3.2. Strategjia e zhvillimit te departamentit.pdf

	Programi i studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në Psikologji me profil në Psikologji Shkollore, i referohet nivelit 7 të studimeve sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në Psikologji, me profil në Psikologji Shkollore, është hartuar dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin, si dhe fushën e veprimtarisë së UT-së, Fakultetit të Shkencave Sociale, Departamentit të Pedagogjisë dhe Psikologjisë (DPP). Ky kriter pasqyrohet qartë në dokumente të tilla si: - Statuti i UT (2018), Neni 5 i tij "Misioni", ku mes të tjerash, IAL delaron se <i>"Universiteti kontribuon në zhvillimin e shoqërisë, përmes tri shtyllave të misionit të arsimit të lartë publik: kërkim shkencor, edukim, si dhe shërbim ndaj publikut, që vazhdimisht pasurojnë dhe informojnë njëra-tjetrën. Ne ofrojmë edukim me në qendër studentin, si dhe nxisim rritjen personale dhe intelektuale për të përgatitur studentë për karrierë produktive dhe qytetare, të përgjegjshëm në një shoqëri globale"</i> (fq.3);¹⁶ - Regulations Master of Science in School Psychology, Article 6 <i>"The mission of MSH-SPH"</i>, ku mes të tjerash specifikohet se Misioni i MSH në PSH është <i>"përgatitja e specialistëve dhe kërkuesve të rinj në fushën e studimeve psiko-pedagogjike, projekteve të kërkimit mbi fenomene dhe çështje sociale, rekomandimeve për politikat e edukimit publik dhe vlerësimet për impaktin e reformave sociale"</i>.¹⁷
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike të Institucionit.	Programi i studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në Psikologji, me profil në Psikologji Shkollore, është hartuar dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike të Institucionit. - Dokumentin <i>"Strategjia e zhvillimit të DPP, 2020-2024"</i>, ku theksohet se nëpërmjet programeve të studimit të ofruara <i>"DPP synon të përgatisë jo vetëm profesionistë të kualifikuar në fushën e kërkimeve psikologjike, por edhe studentë të përgjegjshëm e të kulturuar të një shoqërie që reflektojnë vlerat më të larta, morale dhe etike, në shërbim të shoqërisë, të</i>

¹⁶ Dokumenti 5/ 1.2.Statuti 2018.pdf

¹⁷ Dokumenti 110/ 5.4. Rregullorja e programit të studimit.pdf; (anglisht)

	zhvillimit cilësor dhe të qëndrueshëm të vendit”(Seksioni IV, fq. 7).¹⁸ - Kornizën konceptuale të programit të studimit Master i Shkencave në “Psikologji” me profil në “Psikologji Shkollore”, Pika 2, e tij theksohet se “Parimet dhe kërkesat themelore të programit burojnë nga kuadri ligjor për arsimin e lartë, Statuti dhe rregullore të UT në lidhje me rregullat dhe objektivat e zhvillimit të arsimit të lartë dhe specifikisht të shprehura në formimin e psikologëve klinikë” (fq.2).¹⁹
Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.	Programi i studimit Master i Shkencave në Psikologji, me profil në Psikologji Shkollore është hartuar dhe zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar. Në dokumentin “Strategjia e zhvillimit të programit të studimit “Master i Shkencave” në “Psikologji Shkollore” (2020-2024), përshkruhet se “Kjo strategji është hartuar duke u bazuar në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; Strategjinë Kombëtare për shkencën, teknologjinë dhe inovacionin (2017-2022); në përputhje me Statutin e Universitetin e Tiranës...; Strategjinë e zhvillimit të UT (2018-2023) dhe Planin e Kërkimit Shkencor në UT (2018-2022) (fq.4)”.²⁰ Në seksionin II të këtij dokumenti, sqarohet se “Programi i studimit Master i Shkencave në Psikologji me profil ‘Psikologji Shkollore’ që ofrohet në Departamentin e Pedagogji-Psikologjisë, është organizuar në bazë të marrëveshjes së Kartës së Bolonjës dhe legjislacionit në fuqi... Kurrikula e programeve të ofrura për nivelin Master i Shkencave është hartuar mbi bazën e literaturës shkencore dhe përvojave mësimore të universiteteve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Anglisë, Gjermanisë, Italisë, etj. (fq.5)”²¹
Konkluzione	GVJ vlerëson se UT/ FSHS/ DPP ofron programin e studimit Masteri i Shkencave në Psikologji, me profil në Psikologji Shkollore në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon

¹⁸ Dokumenti 62/3.2. Strategjia e zhvillimit të departamentit.pdf

¹⁹ Dokumenti 100/4.1. Korniza konceptuale e programit të studimit.pdf

²⁰ Dokumenti 139/ 3.5. Strategjia e zhvillimit të programit të studimit.pdf

²¹ Dokumenti 139/ 3.5. Strategjia e zhvillimit të programit të studimit.pdf

	ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve									
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Sipas Statutit të UT (2018), Universiteti i Tiranës është krijuar në vitin 1957, si institucioni i parë universitar i arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor në Shqipëri. Mbështetur në traditat dhe arritjet arsimore dhe shkencore më të përparuara të vendit dhe ato botërore, UT është vlerësuar dhe ka zënë një vend të denjë ndër institucionet arsimore e shkencore në vend (fq.2).²² UT përbëhet nga 6 njësi kryesore, duke përfshirë edhe FSHS. Fillimisht, fakulteti është hapur me VKM nr. 348, datë 31.07.1992 me emërtim “Fakulteti i Punës Sociale”.²³ Në vitin 1993, me Urdhër nr.18 date 31.07.1993, të Ministrisë së Arsimit, fakulteti emërtohet “Fakulteti i Shkencave Sociale” duke përfshirë në strukturën e tij edhe departamentin e “Psikologjisë dhe Pedagogjisë”.²⁴ FSHS dhe DPP demonstrojnë se kanë përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e programit të studimit Master i Shkencave në Psikologji, me profil në Psikologji Shkollore. Referuar dokumentit “Aneks-Tabela përmbledhëse: Tabela 2 dhe Tabela 3”,²⁵ mësohet se DPP, përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit të marrë në vlerësim, ka në përbërje të tij, personel akademik të kualifikuar, si vijon: <table><tr><th colspan="3">Personel Akademik i DPP (2022-2023)</th></tr><tr><th>Grada /Titulli</th><th>PAE</th><th>PAK</th></tr><tr><td>Prof.Dr.</td><td>4</td><td>1</td></tr></table>	Personel Akademik i DPP (2022-2023)			Grada /Titulli	PAE	PAK	Prof.Dr.	4	1
Personel Akademik i DPP (2022-2023)										
Grada /Titulli	PAE	PAK								
Prof.Dr.	4	1								

²² Dokumenti 5/ 1.2.Statuti 2018.pdf

²³ Dokumenti 27/ 2.1. VKM Nr. 348, datë 10.8.1992 "Për hapjen e Fakultetit të Punës Sociale".pdf

²⁴ Dokumenti 28/ 2.2. Urdhër i MA Nr. 18, datë 31.07.1993 hapja FSHS dhe Dep FIL-Soc.pdf

²⁵ Dokumenti 165/ 4.16. Aneksë tabelë përmbledhëse ASCAL.pdf

	Prof.as.Dr	6	0
	Dr.	3	3
	MSc.	0	4
	Totali	13	8

Personel Akademik i DPP (2023-2024)		
Grada /Titulli	PAE	PAK
Prof.Dr.	3	1
Prof.as.Dr	6	0
Dr.	4	1
MSc.	0	5
Totali	13	7

Sipas dokumentit “Ngarkesa totale e personelit akademik të programit Psikologji Shkollore në një vit akademik 2023-2024”, (tabela 4),²⁶ dëshmohet se janë angazhuar **14 personel akademik efektiv (PAE)** nga të cilët 3 me titullin “Profesor”, 6 me titullin “Profesor i Asocuar”, dhe 5 me gradën “Doktor”, dhe **7 personel akademik me kontratë (PAK)** nga të cilët 1 është me titull “Profesor”, 6 të tjerë me status kualifikimi të papërkshkruar. Bazuar në këtë dokument, rezulton se raporti midis PAE dhe PAK është në favor të PAE.

GVJ sugjeron që të rakordohen të dhënat në tabelat përkatëse.

DPP ka 2 Personel Ndhmës Akademik, nga të cilët një sekretare (MSc) dhe një laborante (MSc).²⁷

| **Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë** | Në dokumentin “Raporti vjetor për veprimtaritë e kryera 2021-2022”, shënohet se “Fakulteti i Shkencave Sociale (FSHS) vepron në përputhje me statutin dhe misionin e Universitetit të Tiranës në funksion të zhvillimit dhe përparimit të fushave të shkencave sociale përfshirë edhe psikologjinë dhe edukimin, punën sociale, sociologjinë, filozofinë dhe shkencat politike dhe duke integruar | |

²⁶ Dokumenti 107/ 4.6. Te dhenat tabelore per personelin akademik per programin e studimit.pdf;

²⁷ Dokumenti 165/ 4.16. Aneksë tabelë përmbledhëse ASCAL.pdf

13

14

kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	<i>kontributet në fushën e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe ofrimit të shërbimeve. Në përmbushje të misionit të saj, FSHS ka si vizion arritjen e standardeve akademike më të larta bashkëkohore kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe përkrahjen e aspiratave dhe arritjeve të çdo studenti që kërkon të zhvillojë dije në fushat në fokus të FSHS nëpërmjet mësimdhënies dhe kërkimit shkencor (fq.3).²⁸</i> Sipas Urdhrit të MAS, nr. 297, datë 20.07.2012 “Për regjistrimin e formës së diplomave të programeve të studimeve “Bachelor”, “Master Profesional” dhe “Master i Shkencave” të Universitetit të Tiranës”, gërma “sh”, specifikohet se Fakulteti i Shkencave Sociale, lëshon diplomë me emërtesë “Master i Shkencave” në Psikologji, me profil në Psikologji Shkollore, me kod 000775 (fq. 2-3).²⁹ <i>Për sa më lartë, GVJ konkludon se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit Master i Shkencave në Psikologji, me profil në Psikologji Shkollore, është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të FSHS-së, njësisë kryesore përgjegjëse për këtë program studimi, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</i>
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	Në Rregullore e DPP, 2021, Neni 6, pika 6.2 (fq.3) përcaktohet se: a) DPP ofron programe studimi të ciklit të parë, të dytë dhe të tretë, ku organizimi struktura dhe përmbajtja e këtyrë programeve, ofrohen në përputhje të plotë me fushat dhe drejtimet akademike të DPP-së, si dhe në përputhje të plotë me klasifikimin/kodifikimin e programeve të studimit sipas legjislacionit shqiptar të fushës, si edhe direktivave europiane në ato raste kur këto direktiva janë ratifikuar nga RSH; b) DPP përgjigjet për formulimin e profileve, si edhe të përmbajtjeve lëndore, për diplomat e ciklit të parë, të dytë dhe të tretë së studimit që ndodhen nën administrimin e tij;³⁰ Në pikën 6.3 të Rregullores së DPP (2021) (fq.3), gërma “a”, përshkruhet se “DPP kryen kërkim shkencor në drejtimet e përcaktuara në Strategjinë e Kërkimit Shkencor të UT, duke patur

²⁸ Dokumenti 136/ 2.16. Analizë vjetore e punës së Fakultetit të Shkencave Sociale 2021-2022, 2022-2023.pdf

²⁹ Dokumenti 149/3.7. Shkresa e QSHA për Kodin e programit të studimit.pdf

³⁰ Dokumenti 63/3.3. Rregullore e departamentit.pdf

	<i>parasysh drejtimet specifike të kërimit shkencor në fushën e Pedagogjisë dhe Psikologjisë.”³¹</i> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit Master i Shkencave në Psikologji, me profil në Psikologji Shkollore, është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, DPP përgjegjëse për programin e studimit.
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohej nga institucionet partnere.	Programi i studimit Master i Shkencave në Psikologji, me profil në Psikologji Shkollore, ofrohet brenda profilit akademik dhe kërkimor të FSHS dhe DPP, sikurse është përshkruar edhe në kriterin 2 dhe 3 të këtij standardi.
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtijshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	FSHS, në UT, ofron trajnime profesionale për studentët aktualë dhe studentët e diplomuar në bashkërendim me Zyrën e Karrierës që ndërmjetëson edhe me punëdhënësit. Në dokumentin “<i>Plani i veprimit për Zyrën e Karrierës, në FSHS për vitin akademik 2024-2025</i>”,³² përshkruhet se “<i>Zyra e karrierës në FSHS, ka si qëllim të shërbejë si një strukturë e efikase e Fakultetit, të cilën studentët mund ta vizitojnë përgjatë formimit të tyre akademik dhe profesional dhe që do të ndihmojë në ndërmjetësimin e studentëve me tregun e punës.</i>” Në rubrikën dokumentacione shtese, Institucioni dëshmon për realizimin një sërë akativiteve trajnuese në bashkëpunim me Zyrën e Karrierës, institucione të ndryshme, shoqata dhe organizma të tjerë nga bota e biznesit.³³ Në RVB, institucioni mes të tjerash përshkruan se “Departamenti ka bashkëpunuar edhe me institucione si Urdhri i Psikologut të Republikës së Shqipërisë për të zhvilluar trajnime për profesionistët në fushën e psikologjisë. Kjo ka përfshirë trajnime të vazhdueshme për psikologët dhe profesionistët e fushës, që mundësojnë përgatitjen e tyre për përballimin e situatave të ndryshme, përfshirë emergjencat civile (fq. 14)”.³⁴
Konkluzione	GVJ vlerëson se programi i studimit Master i Shkencave në Psikologji, me profil në Psikologji Shkollore, është në përputhje me fushën akademike të FSHS (njësisë kryesore) dhe DPP (njësisë bazë) përgjegjëse për programin e studimit.

³¹ Dokumenti 63/3.3. Rregullore e departamentit.pdf

³² Dokumenti shtesë 2/ 4. Evidenca nr. 9. Plani i punes 2024-2025 Karriera (1) 1.pdf

³³ Dokumenti shtesë 1/3. Programi i trajnimit 1.pdf

³⁴ Dokumenti 1/3.23. RVB ne gjuhen shqipe.pdf

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	FSHS, në UT, i cili ofron programin e studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Psikologji”, me profil në “Psikologji Shkollore”, demonstroi angazhimin e tij, bazuar në Ligjin nr. 80/2015 për AL, Statutin e UT (2018), dokumentet rregullatore, udhëzimet dhe aktet të tjera ligjore e nënligjore, lidhur me hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit përkatës, sigurimin e marrëdhënieve të bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre. Sipas Rregullores së FSHS (2023), Neni 4, pika 2, deklarohet se “Kjo Rregullore i shtrin efektet në të gjitha strukturat, organet dhe autoritetet drejtuese, personelin akademik, ndihmës akademik, administrative dhe studentët, si dhe mbi çdo person fizik apo juridik që vepron në objektet dhe territorin e FSHS, dhe pika 3 specifikon se “Rregullorja e FSHS rregullon marrëdhëniet me njësitë bazë të saj”. Neni 5 i Rregullores së FSHS (2023), përcakton se “Organet dhe autoritetet drejtuese të FSHS, për të siguruar zbatimin e ligjit për arsimin e lartë ose kur kanë detyrim ligjor të posaçëm, në drejtime, situate apo kushte të gjendjes së jashtëzakonshme ose fatkeqësie natyrore, mund të hartojnë dhe të miratojnë rregullore të veçanta, të përherëshme apo të përkohshme, vetëm për një fushë, drejtim, objekt, veprimtari, komision apo njësi të caktuar.”³⁵ Në Rregulloren e DPP (2021), Neni 5 “Organizimi i DPP”, përcaktohet se “DPP është njësi bazë që përgjigjet për cilësinë e programeve të studimit që mbulon, për kryerjen e aktivitetit mësimdhënës dhe shkencor, si edhe për shërbimet administrative që mbulon”, dhe në Nenin 6, “Funksionet e DPP”, pika 1 e tij,

³⁵ Dokumenti 29/ 2.4.Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale 2023.pdf

XB *A*

	përkufizohet se “ DPP next, programon, bashkërendon, zhvillon, organizon dhe administron veprimtarinë e mësimdhënies, veprimtarinë kërkimore-shkencore, si edhe veprimtarinë administrative”, dhe në Nenin 8 “Përgjegjësitë e drejtuesit të DPP”, Pika 8.1 “Kompetencat e Drejtuesit të Departamentit në drejtim të mësimdhënies”, përshkruhet si vijon: - Kujdeset për mbarëvajtjen e programeve të studimit të tre cikleve të studimit, si dhe programeve të lëndëve që menaxhon, duke bashkëpunuar me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë të Institucionit. - Miraton dhe ndjek zbatimin e planit strategjik për zhvillimin e programeve të studimit të departamentit, në përputhje me planin strategjik të zhvillimit të FSHS, si edhe kryen studime periodike të tregut të punës. Etj. Në vijim, Neni 11 i këtij dokumenti “Për përgjegjësitë e koordinatorëve të programeve të studimit që mbulon DPP”, deklaron se “Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin, për çdo program studimi cakton një person në rolin e Koordinatorit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinatori i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse”.³⁶ Në “Rregullore e programit Master i Shkencave në Psikologji me profil ‘Psikologji Shkollore’” (anglisht), në Nenin 1, përcaktohet se “Rregullorja e brendshme e Masterit të Shkencave në Psikologji Shkollore (MSH-SPH) vendos rregullat normative të funksionimit të MSH-SPH dhe të marrëdhënieve që krijohen midis subjekteve pjesëmarrëse në veprimtarinë e këtij MSH-SPH”. Në Nenin 10.2.2 të këtij dokumenti “Për detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorit”, përshkruhet se koordinatori i programit të studimit, mes të tjerash, ka përgjegjësi “të përgatisë në bashkëpunim me anëtarët e komitetit shkencor raportin e analizës vjetore të veprimtarisë së kryer për përmbushjen e misionit dhe objektiveve të programit, identifikon pikat e forta dhe të dobëta, dhe paraqet rekomandimet përkatëse për përmirësimin e programit të studimit” (fq.7).³⁷
--	---

³⁶ Dokumenti 63/3.3. Rregullore e departamentit.pdf

³⁷ Dokumenti 110/ 5.4. Rregullorja e programit të studimit.pdf; (anglisht)

	Dokumenti “Raporti analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit të praktikës”³⁸ për programin Master i Shkencave në Psikologji me profil ‘Psikologji Shkollore’, përpiluar nga koordinatori e këtij programi, përbën një praktikë të mirë pune dhe është një tregues tjetër i bashkëpunimit të frytshëm brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njërive e personelit, marrjes së përgjegjësisë respektive, dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre. Institucioni ka dokumentuar raporte dhe analiza të ndryshme, të tilla si: ✓ Dokumenti 42/2.17. Raporte periodike NJSBC 2023, 2024.pdf ✓ Dokumenti 123/ 3.18.1. Raport për veprimtarinë e programit të studimit për vitin akademik.pdf ✓ 136/ 2.16. Analizë vjetore e punës së Fakultetit të Shkencave Sociale 2021-2022, 2022-2023.pdf
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	FSHS, si pjesë përbërëse e UT, dëshmon përmes dokumenteve “Lista e marrëveshjeve të praktikës”³⁹, “Marrëveshje ndërinstytucionale”⁴⁰, “Lista e projekteve për këtë program studimi (racionale)”⁴¹ se ka vendosur marrëveshje bashkëpunimi me institucione homologe brenda vendit dhe disa jashtë vendit, si dhe me institucione publike, qendra të shërbimit psiko-social, agjensi e biznese private, organizata të ndryshme joqeveritare, etj, për të realizuar objektivat e procesit mësimor e formues të studentëve të cilët ndjekin programet e studimit të ofruara nga FSHS, duke përfshirë edhe ata që ndjekin programin e studimit Master i Shkencave në Psikologji, me profil në Psikologji Shkollore. Nga vizita në institucion, GVJ mësoi se disa marrëveshje bashkëpunimi të UT/FSHS-së me institucionet homologe brenda dhe jashtë vendit kanë qënë frytdhënëse në organizmin konferencave të përbashkëta, workshop-et, ftesa për leksione të hapura, mobilitet stafi dhe studentësh.
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me	Dokumenti “Lista e marrëveshjeve të praktikës”⁴² dëshmon se FSHS/DPP ka nënshkruar marrëveshje të posaçme bashkëpunimi me institucione brenda vendit, qendra të shërbimit psiko-social, agjensi e biznese private, organizata të ndryshme joqeveritare, etj,

³⁸ Dokumenti 122/3.19. Raporti i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në.pdf

³⁹ Dokumenti 144/ 3.17. Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe e partnerëve për praktikën profesionale.pdf

⁴⁰ Dokumenti 96/ 4.16. Marrëveshjet e nënshkruara në funksion të praktikës profesionale .pdf

⁴¹ Dokumenti 3/5. Liste projektsh për këtë program studimi (racionale) 1 1.pdf (vizita dy ditore)

⁴² Dokumenti 144/ 3.17. Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe e partnerëve për praktikën profesionale.pdf

institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.	me synim realizimin e praktikave profesionale të studentëve të programit të studimit të marrë në vlerësim. Kohëzgjatja e marrëveshjeve varion nga 1 deri në 5 vite, dhe në disa raste me afat të pacaktuar. Gjithashtu, FSHS dëshmon se realizon marrëdhënie bashkëpunimi me institucione apo agjensi të ndryshme për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programit të studimit. Format standard <i>“Marrëveshje për vlerësimin e praktikës”</i> të cilin aplikon FSHS, është tregues konkret i formalizimit të një bashkëpunimi ndërinstitutional me agjensitë përkatëse sipas përgjegjësi reciproke lidhur me kryerjen, mbikëqyrjen dhe vlerësimin e praktikës profesionale.⁴³ Nga vizita në institucion, GJV mësoi se për të siguruar kontakte të drejtpërdrejta me agjensitë apo qendrat ku zhvillohet praktika, me qëllim mbarëvajtjen e praktikës profesionale të studentëve, FSHS/DPP ka caktuar një personel akademik si udhëheqës të praktikës. Dokumentet <i>“Marrëveshje për bashkëpunim institucional”</i>⁴⁴ dhe <i>“Liste projektsh për kete program studimi (racionale)”</i>⁴⁵, dëshmojnë se FSHS/DPP është reciprokisht e anagazhuar në bashkëpunime ndërinstitutionale që përfshijnë mes të tjerash edhe realizimin kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	DPP, njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit të marrë në vlerësim, dëshmon se harton raporte të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve, përfshi edhe programin e studimit në vlerësim. Referuar përmbajtjes së dokumentit <i>“Raporti i fundit analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit të praktikës”</i>⁴⁶ vërehet se përcillet një informacion i përgjithshëm mbi përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit të pasqyruara në tabelën që shoqëron dokumentin. Në dokumentin <i>“Raport vjetor për veprimtaritë e kryera (2021)”</i>⁴⁷ dhe <i>“Raport vjetor për veprimtaritë e kryera (2022)”</i>⁴⁸, DPP dëshmon se harton raporte periodike, ku analizon mes të tjerash,

⁴³ Dokumenti 105/ 4.4. Paketa e praktikës për programin e studimit.pdf

⁴⁴ Dokumenti 96/ 4.16. Marrëveshjet e nenshkruaja ne funksion te praktikës profesionale .pdf

⁴⁵ Dokumenti 3/5. Liste projektsh për kete program studimi (racionale) 1 1.pdf (vizita dy ditore)

⁴⁶ Dokumenti 122/ 3.19. Raporti i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në.pdf

⁴⁷ Dokumenti 124/ 3.18. Raport për veprimtarinë e programit të studimit për vitin akademik.pdf

⁴⁸ Dokumenti 123/ 3.18.1. Raport për veprimtarinë e programit të studimit për vitin akademik.pdf

	edhe marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione vendase dhe të huaja në fushën e kërkimit dhe veprimtarive të tjera të realizimit të programeve të studimit.			
Konkluzione	<i>UT/FSHS/DPP siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit të stafit akademik dhe studentëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Ligji nr. 80/2015 për AL, Neni 71, “Për programet e studimit në institucionet e arsimit të lartë”, Pika 2 e tij, përcakton se “Elementet, që duhet të përmbajnë programet e studimit, të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave”. Sipas VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar me VKM Nr. 879, datë 18.12.2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, Pika 2 e tij, shprehet se: Elementet që përbëjnë strukturën e programeve të studimit, të ofruara nga IAL-të, konsistojnë në:

	a) kreditet, sipas Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS); b) kontrollin e dijeve dhe instrumentet e vlerësimit; c) rezultatet e të nxënësve (objektivat formues) dhe kompetencat profesionale; ç) veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit; d) kategoritë e veprimtarive formuese, që karakterizojnë një program studimi; dh) planin mësimor; e) kuotat e pranimit dhe grupet mësimore; ë) programin lëndor (Syllabus-et); f) profilin e programit; g) diplomën dhe suplementin Pika 2.4/a e VKM Nr. 41, datë 24.1.2018, "Për veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit", përcakton se: Veprimtaritë formuese që karakterizojnë një program studimi, përbëhen nga komponentët mësimorë, të cilët ndahen në: - mësim në auditor, si leksione, seminare, lëndë individuale artistike, ushtrime, laboratorë, forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale, të zhvilluara në auditor; - studim individual, si studim e punim relacionesh, detyrash apo projektesh; - përgatitje për provime; - përgatitje e tezës së diplomës; - veprimtari të tjera, si praktika profesionale, praktika në terren apo stazh pranë subjekteve publike ose private; GVJ vëren se programi i studimeve të ciklit të dytë Master i Shkencave në Psikologji, me profil në Psikologji Shkollore, përmban të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore në fuqi.
--	--

Referuar dokumentit “Korniza konceptuale e programit të studimit”⁴⁹, çështja 4 (fq.5-6) “Struktura dhe karakteristikat e programit të studimeve” mësohet se: Programi i studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave në Psikologji me Profil ‘Psikologji Shkollore’” është program studimesh universitare i organizuar në lëndë dhe i vlerësuar me kredite, sipas “Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve” (ECTS). Disiplinat mësimore dhe aktivitetet e tjera janë organizuar në disa kategori lëndësh me 120 kredite... Klasifikimi sipas komponentëve mësimorë është:

- *Kategori A – Lëndët bazë – përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme zë aktualisht rreth 20% të krediteve.*
- *Kategoria B – Lëndë karakterizuese zë aktualisht rreth 38.33% të krediteve.*
- *Kategoria C – Lëndë ndërdisiplinore / integruese - ndërdisiplinore, profile dhe grup – lëndë me zgjedhje – zë aktualisht 9.16% të krediteve.*
- *Kategoria D – Lëndë plotësuese – praktika profesionale 7.5% të krediteve.*
- *Kategoria E – Detyrime përmbyllëse – punimi i diplomës zë rreth 25% të krediteve.*

Veprimtaritë formuese që karakterizojnë programin e studimit janë:

- *Mësimi në auditor (leksione, seminare, ushtrime);*
- *Studimi individual (hulumtimi, kërkimi, studimi, punim relacionesh, detyrat apo projektet, përgatitjet e provimeve, përgatitja e tezës së diplomës, etj.);*
- *Veprimtari të tjera të lidhura ngushtësisht me aspekte profesionale, si praktika jashtë auditorit pranë institucioneve, sipërmarrjes private dhe organizatave të ndryshme joqeveritare.*

Institucioni parashikon se “disiplinat mësimore dhe veprimtaritë formuese që ofrohen në këtë program studimi (por edhe kreditet për secilën prej tyre) mund të rishikohen nga departamenti dhe miratohen në Senatin Akademik (fq. 6)”⁵⁰.

⁴⁹ Dokumenti 100/4.1. Korniza konceptuale e programit të studimit.pdf

⁵⁰ Dokumenti 100/4.1. Korniza konceptuale e programit të studimit.pdf

Bazuar në Planin Mësimor (2018-2019)⁵¹, GVJ mori në shqyrtim të dhënat e pasqyruara në këtë dokument, të cilat për qëllime vlerësimi, i organizoi në % dhe i krahasoi me përcaktimet në VKM nr. 41/2018 (i ndryshuar), për kategorizimin e komponentëve mësimorë të programit të ciklit të dytë, rezultatet e të cilave janë përmbledhur në tabelën e mëposhtme:

Kategori	Përshkrimi	Sipas VKM 41/2018 (i ndryshuar)	Të dhënat në PS	
			ETCS	%
A	Lëndë Bazë	5%-10%	24	20 %
B	Lëndë karakterizuese	50%-60%	46	38.33%
C	Lëndë ndërdisiplinore/ integruese	12%-20%	11	9.16%
D	Lëndë plotësuese	10%	9	7.5%
E	Detyrime përmbyllëse	10%-15%	30	25%

Krahasimi i krediteve të shprehura në % për çdo kategori të përshkruar në dokumentin “Planin Mësimor 2018-2019”, me kreditet e shprehura në % të përcaktuara në VKM, Nr. 41/2018, Shtojca (Tabela 1) për programet e ciklit të dytë, nxori në pah se disa kategori të programit *nuk përqasen*, konkretisht:

- Gjenden gati dyfish më shumë lëndë mësimore të kategorisë A (lëndë bazë) në Planin Mësimor të shprehura në 20 % të krediteve, në raport me 5% - 10% kredite të përcaktuara në VKM, Nr. 41/2018 për këtë kategori;
- Gjenden më pak lëndë të kategorisë B (lëndë karakterizuese) në Planin Mësimor të shprehura në 38.33% të krediteve, në raport me 50% - 60% kredite të përcaktuara në VKM, Nr. 41/2018 për këtë kategori;
- Sipas përcaktimeve të VKM, Nr. 41/2018, përqindja totale e lëndëve të kategorive A dhe B nuk duhet të jetë më pak se 60% në rastin e programeve “Master i shkencave”. Në rastin e programit të marrë në vlerësim, *përqindja totale e lëndëve të kategorive A dhe B* rezulton të jetë 58.33%;

⁵¹ Dokumenti 99/4.2. Planin mësimor i programit të studimit.pdf

	- Gjithashtu, gjenden <i>më pak lëndë mësimore të kategorisë C (lëndë ndërdisiplinore)</i> në Planin Mësimor të shprehura në 9.16% të krediteve, në raport me 12% - 20% kredite të përcaktuara në VKM, nr. 41/2018 për këtë kategori; - Kategoria D (lëndë plotësuese) rezulton me 7.5% të krediteve nga 10% të krediteve përcaktuara në VKM nr. 41/2018; - Përsa i përket kategorisë E (<i>provës finale</i>), rezultojnë 25% kredite të akorduara, krahasuar me 10% - 15% kredite të përcaktuara në VKM nr. 41/2018. <i>Për sa më sipër GVI sugjeron, që të rishikohet shpërndarja e ngarkesës përkatëse në kredite për kategoritë A, B, C, D, E, me qëllim që të për afrohen / pajtohen me përcaktimet e VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 (e ndryshuar);</i> Sidoqoftë, në RVB (2024), institucioni ka pasqyruar një tabelë me të dhëna të krahasueshme, duke treguar se është i vetëdijshëm për përmbushjen e këtij kriteri. Institucioni deklaron në RVB (2024) se propozimi (me ndryshime) i njësisë bazë është miratuar nga Senati Akademik me vendim nr. 45, datë 28.10.2024, dhe pritet implementimi për vitin akademik të ndryshimeve të jetë konform udhëzimeve në fuqi (fq.22).⁵²
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparura në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparura në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një	Referuar dokumentit “Korniza konceptuale e programit të studimit”, rubrikës 1 “Për objektivat e programit të studimit dhe rezultatet e pritshme”, mes të tjerash mësohet se “Programi është ndërtuar në mënyrë të tillë që të mundësojë psikologët shkollorë të zhvillojnë aftësi dhe shkathtësi specifike përmes të cilave të mund të përballen me një gamë të gjerë çështjesh të lidhura me intervistimin e personave për qëllime vlerësimi, ndërtimi i planeve për shërbim psikologjik në shkollë, vlerësimi i nevojave institucionale, ndërtimi i instrumenteve të vlerësimit dhe monitorimit, ofrimi i këshillimit për grupet shkollorë, përbën fokusin kryesor të programit të formimit të psikologut shkollor, si dhe kompetenca të lidhura me rritjen e efikasitetit profesional dhe bashkëveprimi me profesionistë të tjerë në fushën e shëndetit mendor, si dhe aftësi në kërkimin shkencor cilësor dhe sasior (fq.4). ⁵³

⁵² Dokumenti 1/ 3.23. RVB ne gjuhen shqipe.pdf

⁵³ Dokumenti 100/4.1. Korniza konceptuale e programit të studimit.pdf

fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Në rubrikën 4 të këtij dokumenti “Për strukturën dhe karakteristikat e programit të studimeve”, specifikohet se “Lëndët mësimore janë përzgjedhur nga disa fusha studimi të psikologjisë, si: • Metodat e kërkimit shkencor • Vlerësimi dhe trajtimi i çrregullimeve të ndryshme • Praktikumet në zhvillimin e shprehive klinike • Njohja e thelluar e teorive në fusha të ndryshme si trauma, llojet e ndryshme të terapive individuale dhe familjare (fq.5). Në rubrikën 7 “Për njohuritë dhe kompetencat që karakterizojnë profilin”, përshkruhet se “Dijet dhe njohuritë e përvetësuara në këtë program studimi janë të orientuara drejt thellimit të shprehive klinike për të ndihmuar individët, familjet dhe grupet me çrregullime të ndryshme neurologjike apo të personalitetit. Ndërlidhja e ngushtë e dijeve teorike, aftësive kërkimore, studimeve të rastit, udhëheqin drejt formimit të profesionistëve të rinj. Ky program studimi i orienton studentët drejt praktikave kërkimore, për të rritur aftësitë përshtatëse në tregun e punës ku roli i kërkuesit shkencor po bëhet gjithnjë e më i domosdoshëm (fq. 8).⁵⁴ Në vijim të dokumentit, në rubrikën 9 “Për punimin e diplomës”, parashtrohet se “Punimi i diplomës realizohet në mënyrë individuale e të pavarur, për një problem a çështje nga fusha e psikologjisë klinike dhe paraqitet për mbrojtje pas përfundimit të detyrimeve të programit. Punimi synon të demonstrojë njohuritë dhe aftësitë e studentit për të studiuar, analizuar dhe interpretuar probleme të ndryshme klinike” (fq.9).⁵⁵ Referuar dokumentit “RVB 2024” mësohet se “Gjithashtu, ky program e pajis studentin me aftësitë kryesore të një psikologu të përgjithshëm (fq. 23).⁵⁶
Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Programi i studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në Psikologji, me profil Psikologji Shkollore, ka përcaktuar në dokumentet rregullatore dhe Planin Mësimor (2018-2019) ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.

⁵⁴ Dokumenti 100/4.1. Korniza konceptuale e programit të studimit.pdf

⁵⁵ Dokumenti 100/4.1. Korniza konceptuale e programit të studimit.pdf

⁵⁶ Dokumenti 1/ 3.23. RVB në gjuhën shqipe.pdf

	Në “<i>Regulations Master of Science in School Psychology</i>”, Neni 18, Pika 18.3, specifikohet se “30 kredite janë alokuar për tezën” (fq. 11).⁵⁷ Duke përcaktuar 30 kredite për punimin e diplomës në programin e marrë në vlerësim, FSHS/DPP demonstroi se i jep peshë dhe rëndësi të posaçme aftësimit të studentëve në fushën e kërkimit të psikologjisë shkollore. Kategoria E – <i>Detyrime përmbyllëse – Punimi i Diplomës</i> zë 25% të krediteve, krahasuar me 10% - 15% të krediteve të përcaktuara në VKM nr. 41/2018. Referuar Planit Mësimor (2018-2019), vërehet se Praktika Profesionale përfshin 9 kredite ose 7.5 % të krediteve nga 12 kredite ose 10% të krediteve të përcaktuara në VKM nr. 41/2018. <u>GVJ sugjeron të rishikohet përcaktimi i ngarkesës në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse në programin e studimit të marrë në vlerësim për të siguruar përputhje me VKM nr. 41/2018.</u>
Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.	Ligji nr. 80/2015, Neni 75/pika 3, përcakton se “Programet e studimit “Master i shkencave” pajisin të diplomuarit me njohuri të thelluara teorike, si edhe me aftësim për kërkim shkencor në një fushë të caktuar.”⁵⁸ Programi i studimit të marrë në vlerësim është program i ciklit të dytë të studimeve “Master i Shkencave” në Psikologji, me profil në Psikologji Shkollore.⁵⁹ Ai është një nga profilet studimore të ofruara nga njësia bazë DPP, në FSHS të UT.⁶⁰ Programi është ndërtuar në mënyrë të tillë që të mundësojë (studentët) psikologët shkollore të zhvillojnë aftësi dhe shkathtësi specifike përmes të cilave të mund të përballen me një gamë të gjërë çështjesh të lidhura me ... shërbim psikologjik në shkollë ... si dhe aftësi në kërkimin shkencor cilësor dhe sasior (fq.4).⁶¹
Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të	N/A

⁵⁷ Dokumenti 110/5.4. Rregullorja e programit të studimit.pdf (anglisht)

⁵⁸ https://unitir.edu.al/images/dokumenta/Legjislacion/Ligj_80-2015_22.07.2015.pdf

⁵⁹ Dokumenti 100/4.1. Korniza konceptuale e programit të studimit.pdf

⁶⁰ Dokumenti 110/5.4. Rregullorja e programit të studimit.pdf (anglisht)

⁶¹ Dokumenti 100/4.1. Korniza konceptuale e programit të studimit.pdf

krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.	
Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	Ligji nr. 80/2015 për AL, Kreu VII “Për organizimin e studimeve në institucionet e arsimit të lartë”, Neni 69 “Për format e studimeve dhe pranimi në institucionet e arsimit të lartë”, Pika 2 e tij, mes të tjerash përkufizon se “... Programet e studimit, që japin të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar, organizohen vetëm në formën e studimeve me kohë të plotë”. Neni 75, pika 3/a e tij, përcakton se “Programet e studimit “Master i shkencave” ... organizohen në: a) programe që realizohen me jo më pak se 120 kredite formimi në vijim të ciklit të parë dhe me kohëzgjatje normale dy vite akademike”.⁶² Sipas dokumentit “Korniza konceptuale e programit të studimit”, rubrika 4 e tij “Për strukturën dhe karakteristikat e programit të studimeve”, deklarohet se “Programi i studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave në Psikologji me profil ‘Psikologji Shkollore’” është program studimesh universitar i organizuar në lëndë dhe i vlerësuar me kredite, sipas “Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve” (ECTS)” (fq. 5). Programi realizohet “... me kohë të plotë, me 120 kredite, kohëzgjatje normale 2 vite akademike” (fq.6). Kriteret përzgjedhëse të përgjithshme për kandidatët janë: 1) të kenë përfunduar studimet universitare të ciklit të parë dhe të zotërojnë një diplomë Bachelor në fushat e studimit: Psikologji ose Psikologji-Sociologji, të fituar brenda ose jashtë vendit. 2) Dëshmi e zotërimit të gjuhës angleze e noteruar e shoqëruar me origjinalen ... në përputhje me Udhëzimin e MAS. Njohja nga kandidati e një prej gjuhëve të huaja të Bashkimit Europian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht. Nëse individit ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për

⁶² https://unitir.edu.al/images/dokumenta/Legjislacion/Ligj_80-2015_22.07.2015.pdf

	plotësimin e këtij kriteri... 3) <i>Kritere të veçanta: kanë prioritet studentët e diplomuar nga FSHS të UT</i>" (fq.6-7).⁶³ Gjithashtu, në dokumentin "<i>Regulations Master of Science in School Psychology</i>", Nenet 26, 27, 28 dhe 29 përcaktojnë qartë politikën, procedurat dhe kriteret e pranimit të studentëve në programin e studimit të marrë në vlerësim. Për sa më lartë, Institucioni dëshmon se forma e organizimit të studimeve dhe pranimi i studentëve në programin e studimit të marrë në vlerësim, realizohen në përputhje me Ligjin nr. 80/2015 të AL dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të MAS.
Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Ligji nr. 80/2015, Neni 86/pika 2, përcakton se "<i>Programet e studimit, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind</i>".⁶⁴ Aktualisht, në Shqipëri gjenden disa universitete të cilat ofrojnë programe të ciklit të dytë të studimeve Master në fushën e psikologjisë shkollore, si: • Universiteti Barleti (UniBa), në Tiranë, ofron programin "Master i Shkencave" në Psikologji Shkollore dhe Zhvillim.⁶⁵ • Universiteti "Aleksandër Moisiu", në Durrës, ofron programin "Master Profesional" në Psikologji Shkollore dhe Zhvillimore" (Certifikatë Europiane e Psikologjisë "EuroPsy").⁶⁶ • Universiteti European i Tiranës, ofron programin "Master i Shkencave" në Psikologji me profil Psikologji Shkollore. <i>Struktura dhe përmbajtja e programit janë të dizenuara në përputhje me fushën e kompetencave profesionale të psikologut shkollor, duke ofruar njohuri teorike dhe praktike të nevojshme për këtë rol. Mbi 70% e lëndëve përbëhen nga tematika të psikologjisë shkollore, duke siguruar kështu një dominim të njohurive dhe</i>

⁶³ Dokumenti 100/4.1. Korniza konceptuale e programit të studimit.pdf

⁶⁴ https://unitir.edu.al/images/dokumenta/Legjislacion/Ligj_80-2015_22.07.2015.pdf

⁶⁵ <https://umb.edu.al/program-studimi/master-shkencor/msc-psikologji-shkollore-dhe-zhvillimi.html>

⁶⁶ <https://uamd.edu.al/fakultetit-i-edukimit-uamd-permbush-kriteret-e-certifikates-evropiane-te-psikologjise-europsy-per-programin-e-studimit-master-profesional-120-etc-psikologji-shkollore-dhe-zhvillimore/>

	<i>aftësive të nevojshme për zhvillimin e këtij profili profesional” (fq.27).⁶⁷</i> Sipas dokumentit “<i>Korniza konceptuale e programit të studimit</i>”, rubrika 4 e tij “<i>Për strukturën dhe karakteristikat e programit të studimeve</i>”, specifikohet se për hartimin e kurrikulës së programit të studimit të marrë në vlerësim “<i>Lëndët mësimore janë përzgjedhur nga disa fusha studimi të psikologjisë, si:</i> • <i>Metodat e kërkimit shkencor</i> • <i>Vlerësimi dhe trajtimi i çrregullimeve të ndryshme</i> • <i>Praktikume në zhvillimin e shprehive klinike</i> • <i>Njohja e thelluar e teorive në fusha të ndryshme si trauma, llojet e ndryshme të terapive individuale dhe familjare (fq.5).⁶⁸</i>
Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Programi i studimit Master i Shkencave në Psikologji, me profil në Psikologji Shkollore, shoqërohet me kodin përkatës 000775 sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga MAS, në udhëzimin Nr. 297, datë 20.07.2012, “<i>Për regjistrimin e formës së diplomave të programeve të studimeve “Bachelor”, “Master Profesional” dhe “Master i Shkencave” të Universitetit të Tiranës</i>”.⁶⁹
Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	N/A
Konkluzione	Programi i ciklit të dytë të studimeve “Master i Shkencave në Psikologji, me profil Psikologji Shkollore”, në tërësinë e dokumentacioneve që e shoqërojnë aktualisht atë, dëshmon se kryesisht është organizuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore. Në këtë moment të vlerësimit, GVJ <u>vëren nevojën për të rishikuar shpërndarjen të ngarkesës përkatëse në kredite për kategoritë A, B,</u>

⁶⁷ Dokumenti 1/ 3.23. RVB ne gjuhen shqipe.pdf

⁶⁸ Dokumenti 100/4.1. Korniza konceptuale e programit të studimit.pdf

⁶⁹ Dokumenti 149/ 3.7. Shkresa e QSHA për Kodin e programit të studimit.pdf

	C, D, E, me qëllim që të përafrohen / pajtohen me përcaktimet e VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 (e ndryshuar). Megjithatë, lidhur me këtë standard, GVJ merr në konsideratë angazhimin konkret dhe deklarin e Insitucionit në RVB (2024) se <i>“propozimi (me ndryshime) i njësisë bazë është miratuar nga Senati Akademik me vendim nr. 45, datë 28.10.2024, dhe pritet që implementimi për vitin akademik të ndryshimeve të jetë konform udhëzimeve në fuqi”</i> (fq.22).⁷⁰			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Bazuar në DVV (e-ASCAL) dhe dokumentacionin e siguruar nga institucioni, GVJ konstaton se Fakulteti i Shkencave Sociale si njësi kryesore, dhe Departamenti Pedagogji-Psikologjisë, si njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit Master i Shkencave në Psikologji, me profil në Psikologji Shkollore, përmbushin detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike. Fakulteti i Shkencave Sociale (FSHS), plotëson kriteret minimale të përcaktuara në nenin 23 të Ligjit nr. 80/2015 <i>“Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”</i>. Sipas dokumentit <i>“Struktura organizative e FSHS 2024”</i>⁷¹, FSHS ka në përbërje të tij 5 njësi bazë/departamente: 1. Departamenti i Psikologji-Pedagogjisë; 2. Departamenti i Punës dhe Politikave Sociale; 3. Departamenti i Filozofisë; 4. Departamenti i Sociologjisë; 5. Departamenti i Shkencave Politike.

⁷⁰ Dokumenti 1/ 3.23. RVB ne gjuhen shqipe.pdf

⁷¹ Dokumenti 30/ 2.5. Struktura organizative e FSHS 2024.pdf

XB 31



Referuar dokumentit “Aneks-Tabela përmbledhëse: Tabela 2 dhe Tabela 3”,⁷² mësohet njësia bazë/ Departamenti i Psikologji Pedagogjisë, përgjegjës për programin e studimit të marrë në vlerësim, **përmbush detyrimet për numrin minimal të përcaktuara në nenin 25 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”**. Personeli akademik i angazhuar në dy vitet e fundit, paraqitet me nivel kualifikimi si më poshtë:

Tituj/ grada	2023-2024		2022-2023	
	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	3	1	4	1
Prof. Asoc.	6	0	6	0
Dr./PhD.	4	1	3	3
Msc.	0	5	0	4
Totali	13	7	13	8

Shqyrtimi i të dhënave në tabelën e mësipërme, tregon se personeli akademik me kohë të plotë (PAE) i angazhuar në realizimin e programit të studimit, në vitet akademike 2023-2024 dhe 2022-2023, rezulton 100% i kualifikuar me tituj dhe gradë shkencore dhe përmbush kërkesat ligjore në fuqi për nivelin e kualifikimit.

Personeli akademik me kohë të pjesshme (PAK) i angazhuar në realizimin e programit të studimit për vitin akademik 2023-2024, rezulton 28.6% i kualifikuar me titull dhe gradë shkencore, dhe 71.4% me nivelin MSc të kualifikimit. Për vitin akademik 2022-2023, rezulton 50% e PAK e kualifikuar me titull dhe gradë shkencore, dhe 50% me nivelin MSc të kualifikimit.

Për sa më sipër, Njësia kryesore (FSHS) dhe njësia bazë (DPP) përgjegjëse për programin e studimit të marrë në vlerësim, përmbushin detyrimet ligjore dhe nënligjore për:

- ✓ numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik me kohë të plotë;
- ✓ organizimin dhe strukturën akademike;

⁷² Dokumenti 165/ 4.16. Aneksë tabelë përmbledhëse ASCAL.pdf

	Lidhur me kriterin për shkallën e kualifikimit të personelit akademik me kohë të pjesshme të angazhuar për realizimin e programit të studimit Master i Shkencave në Psikologji me profil ‘Psikologji Shkollore’, <u>GVJ sugjeron</u> që të respektohet neni 59, pika 6 e tij, e ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, ku specifikohet se “Personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës.” Sipas të dhënave në tabelën nr. 4, të dokumentit “Ngarkesa totale e personelit akademik të programit Psikologji Shkollore për një vit akademik 2023-2024”, konstatohet se nga 1095 orë mësimore në total, PAE mbulon 825 orë (75.3%) dhe PAK mbulon 270 orë (24.7%).⁷³ Raporti PAE/PAK (75.3 % me 24.7 %) për mbulimin e ngarkesës mësimore për realizimin e programit të studimit të marrë në vlerësim, dëshmon se <i>institucioni respekton përcaktimet e VKM Nr. 418, datë 10.5.2017 “Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe të degëve të tyre”, Pika 2 (b) e tij, “Standardet për personelin akademik të IAL-së”, ku specifikohet se: Personeli akademik me kohë të plotë duhet të mbulojë jo më pak se 70% të ngarkesës mësimore për çdo program studimi”.</i>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	Bazuar në dokumentin “Aneks-Tabela përmbledhëse: Tabela 2 dhe Tabela 3”, mësohet se aktualisht Departamenti i Psikologji-Pedagogjisë ka në përbërje të tij 2 Personel Ndhmës Akademik, nga të cilët një sekretare (MSc) dhe një laborante (MSc). ⁷⁴
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program	DPP, njësia bazë përgjegjëse cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit në përputhje me objektivat e tij.

⁷³ Dokumenti 107/4.6. Të dhëna tabelore për personelin akademik të programit të studimit.pdf;

⁷⁴ Dokumenti 165/ 4.16. Aneksë tabelë përmbledhëse ASCAL.pdf

studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Sipas dokumentit “<i>Regulations Master of Science in School Psychology</i>”, Article / Neni 10.2.1, deklarohet se “Koordinatori i programit të studimit caktohet nga drejtuesi i njësisë bazë që ofron programin e studimit”. Article 10.1, përkufizon se “Koordinatori i programit të studimit mbështet planifikimin, koordinon dhe mbikqyr veprimtarinë e programit të studimit që mbulon për të siguruar përmbushjen e misionit dhe objektive të programit”. Në Article / Neni 10.2.2, janë përshkruar detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorit, mes të tjerash, në piken 4 specifikohet se “koordinon organizimin e praktikave profesionale dhe praktikave të kërkimit të studentëve”.⁷⁵ Gjatë vizitës në institucion (10-11, shkurt, 2025), Koordinatorja e Programit Master i Shkencave në Psikologji me profil ‘Psikologji Shkollore’, shpjegoi se “Caktimi i Koordinatorit të Programit ka për qëllim të lehtësojë punën e DPP dhe të sigurojë mbarëvajtjen e programit të studimit, ecurinë e mësimdhënies në program, si dhe të raportojë te Përgjegjësi i Departamentit mbi problematikat e ndeshura në procesin mësimor, për të marrë masa e nevojshme dhe siguruar zgjidhje në kohë sa të shpejtë”. Studentët e programit të studimit konfirmuan gjithashtu ruajtjen e komunikimit të vazhdueshëm me Koordinatorin e Programit përkatës. Ata u shprehën se “Problemet e tyre kanë marrë zgjidhje të shpejtë, për raste të tilla si: mbingarkesa me detyra, rregullimi i orarit, nevoja për konsultime shtesë, etj.)”.			
Konkluzione	Fakulteti i Shkencave Sociale dhe Departamenti i Psikologji-Pedagogjisë, njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi. Megjithatë, <u>GVJ sugjeron</u> që të respektohet neni 59, pika 6 e tij, e ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, lidhur me kriterin për shkallën e kualifikimit të personelit akademik me kohë të pjesshme të angazhuar për realizimin e programit të studimit Master i Shkencave në Psikologji me profil ‘Psikologji Shkollore’.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
		X		

⁷⁵ Dokumenti 110/5.4. Rregullorja e programit të studimit.pdf; (anglisht)

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Në Rregulloren e FSHS (2023),⁷⁶ Kreu V “Viti akademik dhe organizimi i studimeve”, në tërësinë e neneve të tij, përcaktohet baza rregullatore për organizimin dhe zhvillimin e programeve të studimit të ofruara nga FSHS. Nëpërmjet “<i>Kornizës konceptuale të programit të studimit Master i Shkencave në Psikologji me profil ‘Psikologji Shkollore’</i>”,⁷⁷ FSHS/DPP ofron informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit të ciklit të dytë të marrë në vlerësim. Gjithashtu, Plani Mësimor i programit të studimit <i>Master i Shkencave në Psikologji me profil ‘Psikologji Shkollore’</i> (2018-2019),⁷⁸ përmban informacionet e nevojshme për strukturën dhe përmbajtjen lëndore të programin e studimit të ciklit të dytë të marrë në vlerësim. FSHS ka publikuar dokumentin “<i>Rregullore e diplomimit</i>” (2024),⁷⁹ ku përshkruhen procedurat e diplomimit të studentëve në programeve të studimit Bachelor, Master profesional, Master i Shkencave dhe përcaktohen përgjegjësitë e strukturave akademike, ndihmësakademike dhe administrative të përfshira në procesin e diplomimit.” DPP ka përgatitur dokumentin “<i>Regulations Master of Science in School Psychology</i>”,⁸⁰ ku parashtrahet statusi, organizimi dhe menaxhimi i programit të studimit të marrë në vlerësim. Bazuar në dokumentet e mësipërme, GVJ konstaton se FSHS/DPP përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë të marrë në vlerësim, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.

⁷⁶ Dokumenti 29/2.4.Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale 2023.pdf

⁷⁷ Dokumenti 100/4.1. Korniza konceptuale e programit të studimit.pdf

⁷⁸ Dokumenti 99/4.2. Plani mësimor i programit të studimit.pdf

⁷⁹ Dokumenti 193/2.11.Rregullore e Diplomimit FSHS.pdf

⁸⁰ Dokumenti Dokumenti 110/ 5.4. Rregullorja e programit të studimit.pdf; (anglisht)

Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Programi i studimit Master i Shkencave në Psikologji me profil ‘Psikologji Shkollore’, përmban planin mësimor, ku përfshihen informacionet për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, tipin e veprimtarisë mësimore, dhe komponentë të tjerë informues. Plani Mësimor i programit të studimit, në total përmban 16 lëndë/module, duke përfshirë praktikën dhe provën finale. Komponentët mësimorë (lëndët/modulet) janë klasifikuar dhe vlerësuar me kredite. Programi është shtrirë në 2 vite akademike, 4 semestra dhe realizohet në total me 120 kredite.⁸¹ Nuk është e qartë shpërndarja e ngarkesës mësimore javore e praktikës profesionale sepse në Planin Mësimor mungojnë të dhënat përkatëse në kolonën “ngarkesa javore”. <u>GVJ sugjeron të përfshihet në Planin Mësimor informacioni për ngarkesën mësimore javore të lëndës së praktikës, si dhe informacioni për formën e kontrollit të dijeve ose shlyerjes së lëndëve, duke specifikuar lëndët që shlyen me provim (P) dhe lëndët/modulet apo praktika që shlyen me firmë (F).</u>
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Në Rregulloren e FSHS (2023), Kreu V “Viti akademik dhe organizimi i studimeve”, Neni 24 “Për programet e studimeve të ciklit të dytë”, Neni 25 “Për procedurat e pranimit dhe regjistrimit në programet e ciklit të parë dhe të dytë të studimeve të kandidatëve të tjerë”, Neni 64 “Për njohjen dhe njësimin e periudhave të studimit” dhe Neni 65 “Për transferimin e studentëve”, janë përcaktuar modalitetet, rregullat dhe informacionet e nevojshme për programin e studimit që lidhen me procedurën e transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Dokumenti “Korniza konceptuale e programit të studimit Master i Shkencave në Psikologji me profil ‘Psikologji Shkollore’”, pika e 5 e tij, përfshin informacion të nevojshëm për kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të pranimit të studentëve (fq.6-7).⁸² Kritere përzgjedhëse të përgjithshme; 1) Të kenë përfunduar studimet universitare të ciklit të parë dhe të zotërojnë diploma Bachelor në fushat e studimit Psikologji ose Psikologji-Sociologji, të fituar si brenda dhe jashtë vendit. 2) Dëshmi e zotërimit të gjuhës angleze e notuar e shoqëruar me origjinalen. (Dëshmi e provimit e lëshuar nga TOEFL ose

⁸¹ Dokumenti 99/4.2. Plani mësimor i programit të studimit.pdf

⁸² Dokumenti 100/4.1. Korniza konceptuale e programit të studimit.pdf

	Cambridge IELTS, CPE, CAE) në përputhje me udhëzimin e MAS. Njohja nga kandidati e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Europian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht. Nëse individ ka fituar një diploma të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri. Niveli i njohjes së gjuhës së huaj përcaktohet me akt nënligjor të ministries përgjegjëse të arsimit të lartë. Kritere specifike: Kanë prioritet studentët e diplomuar nga FSHS të UT. Kriteret specifike të FSHS, për programet Master i Shkencave janë: 1. Gjuha e huaj niveli B1 e certifikuar me teste ndërkombëtare. 2. Kanë prioritet studentët e FSHS dhe UT. 3. Të kenë përfunduar studimet universitare të ciklit të parë të studimeve universitare. 4. Kandidatët fitues shpallen sipas rendit zbritës të notes mesatare të ciklit të parë të studimeve universitare. (fq.35).⁸³ Në shkresën “Kriteret e pranimit për studime të ciklit të parë dhe të ciklit të dytë në DPP”, datë 18.12.2020, është përcaktuar kriter pranimi në programin e studimit Master i Shkencave në Psikologji me profile Psikologji Shkollore, kandidatë të cilët zotërojnë diploma Bachelor dhe të sistemit 4 vjeçar në Psikologji.⁸⁴ Për sa më sipër, programi i studimit Master i Shkencave në “Psikologji” me profil “Psikologji Shkollore” përmban dokumente rregullatore të cilat përfshijnë informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të	Programi i studimit Master i Shkencave në “Psikologji” me profil “Psikologji Shkollore” përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit. Referuar tërësisë së dokumenteve të ngarkuara në e-ASCAL për programet mësimore të lëndëve të programit të studimit,⁸⁵ vërehet

⁸³ Dokumenti 1/ 3.23. RVB ne gjuhen shqipe.pdf

⁸⁴ Dokumenti 198/ 3.14.1. Vendim për miratimin e kriterëve të pranimit për programin e studimit.pdf

⁸⁵ Dokumenti 101/doc00121020241218120711.pdf; 102/doc00121120241218120733.pdf; 103/doc00121220241218120746.pdf; 104/ doc00121420241218120824.pdf; 114/doc00121320241218120805.pdf;

gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	se të gjitha syllabuset përmbajnë informacion të detajuar, duke filluar me titullin e lëndës, titullarin/pedagogun e lëndës, ngarkesën mësimore dhe kreditet, tipologjinë, vitin akademik/semestrin kur zhvillohet, objektivat e përgjithshëm/ specifikë të formimit në atë lëndë, nëndarjen e çështjeve, raportin e orëve të leksioneve dhe seminareve apo orët e laboratorit për secilën lëndë, përfshi edhe praktikën profesionale, formën e kontrollit të dijes, bibliografinë e detyruar dhe atë të rekomanduar, etj. Modeli i programit të lëndës që përdoret për hartimin e <i>syllabus</i>-eve, në programin e studimit përmban të gjitha elementet në përputhje me formatin e miratuar në VKM Nr. 41, datë 24.01.2018, “Për veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit”, shtojca nr. 2 “Programi i lëndës”.
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	FSHS i përmbahet bazës rregullatore dhe udhëzimeve të UT për zhvillimin dhe përmirësimin e kurrikulave. Në dokumentin “<i>Informacion për politikën e zhvillimit dhe përmirësimit të kurrikulave</i>”, Seksionin 3 “<i>Sigurimi i cilësisë së programeve të studimit</i>”, përshkruhet tërësia e procedurave dhe hapave që ndiqen për hartimin, ristrukturimin dhe përmirësimin e programeve të studimit. Në pikën 3.1.1 janë përshkruar kriteret dhe procedurat për përmirësimin e programeve të ofruara. Në këtë kuadër, janë specifikuar kategoritë e ndryshimeve. Ndryshimet në shkallë të madhe që përfshijnë ndryshime mbi masën 20 %, kanë të bëjnë me riorganizimin e programit të studimit dhe kërkojnë domosdoshmërisht miratim nga MASR. Ndryshimet në shkallë të vogël, përfshijnë ndryshime profilizuese, nën masën 20 %, miratimi i të cilave bëhet nga Senati Akademik mbi bazën e propozimit të paraqitur nga njësia kryesore dhe njoftohet MASR jo më vonë se gjashtë muaj para fillimit të vitit të ri akademik.⁸⁶ DPP përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit të marrë në vlerësim ka publikuar gjithashtu dokumentin “<i>Strategjia e zhvillimit të programit të studimit Master i Shkencave në Psikologji me Profil</i>

115/doc00121820241218121000.pdf; 116/doc00121920241218121016.pdf; 117/doc00122020241218121035.pdf; 118/doc00122920241218121451.pdf; 158/doc00123220241218121605.pdf; 159/doc00124920241218122237.pdf; 173/doc00131720241218130806.pdf; 174/doc00133920241218133643.pdf; 175/doc00133620241218133530.pdf; 176/doc00134520241218133907.pdf; 177/doc00135620241218134415.pdf; 180/doc00135020241218134202.pdf; 181/doc00134420241218133829.pdf; 183/doc00133820241218133620.pdf; 185/doc00133320241218133120.pdf; 200/doc00121520241218120854.pdf; 201/doc00121620241218120924.pdf; 202/doc00121720241218120942.pdf; 203/doc00122320241218121215.pdf; 204/doc00122420241218121244.pdf; 206/doc00123420241218121654.pdf;

⁸⁶ Dokumenti 39/2.14. Informacion për politikën e zhvillimit dhe të përmirësimit të kurrikulave.pdf

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

38



	<i>'Psikologji Shkollore' 2020-2024</i>", ku mes të tjerash, përcaktohet si prioritet i parë strategjik: Zhvillimi i kurrikulës (fq.2).⁸⁷ Në rubrikën IV të emërtuar "<i>Prioritete strategjike</i>", DPP ka formuluar objektivat lidhur me zhvillimin e kurrikulave, të tilla si: (5) <i>Rishikimi i kurrikulave me qëllim rritjen e përqindjes së lëndëve me zgjedhje për t'u mundësuar studentëve peshë më të madhe individuale në përpilimin e planeve mësimore.</i> (6) <i>Rishikimi i kurrikulave me qëllim përshtatjen e tyre për të pasqyruar zhvillimet në shkencën e psikologjisë, pasuruar me veprimtarinë shkencore të vendeve të zhvilluara kryesisht OECD, BE, G20.</i> (7) <i>Rishikimi i kurrikulave me qëllim përshtatjen e tyre me nevojat e tregut, prioritetet e zhvillimit kombëtar, rajonal dhe European sipas VKM 41, për të parë përqindjet dhe emërtimet e lëndëve</i> (fq.9). Sipas dokumentit, "<i>Informacion për politikën e zhvillimit dhe përmirësimit të kurrikulave</i>", Seksioni 3, pika 3.5 "<i>Vlerësimi i programit të studimit</i>", njësia bazë organizon në fund të çdo viti akademik rishikimin periodik të programit të studimit dhe rregullores së studimeve me qëllim përmirësimin dhe planifikimin e ardhshëm. Drejtuesi i njësisë bazë aktivizon Komitetin Shkencor të Programit i cili përgjigjet për këtë proces".⁸⁸ Nëpërmjet akteve institucionale të tilla si, procedura⁸⁹ dhe vendime departamenti⁹⁰, FSHS/DPP dëshmon se ka krijuar një praktikë pune të vazhdueshme, të mirëorganizuar për përmirësimin e programeve të studimit të cilat ofron. Dokumentet e paraqitura më sipër dhe bashkëbisedimi gjatë vizitës në institucion, mbi praktikat konkrete që ndërmerr institucioni për përmirësimin e programit të studimit, dëshmojnë se përmbajtja e këtij programi është në proces përmirësimi dhe përditësimi të vazhdueshëm, dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.
Konkluzione	Programi i studimit Master i Shkencave në "Psikologji" me profil "Psikologji Shkollore" është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.

⁸⁷ Dokumenti 139/3.5. Strategjia e zhvillimit të programit të studimit.pdf

⁸⁸ Dokumenti 39/2.14. Informacion për politikën e zhvillimit dhe të përmirësimit të kurrikulave.pdf

⁸⁹ Dokumenti 140/ 3.15. Procedura e ndjekur për përmirësimin e kurrikulës së programit.pdf

⁹⁰ Dokumenti 140/ 3.15.1. Vendim departamenti për përmirësimin e kurrikulës së programit.pdf; 142/ 3.15.2. Shkresa drejtuar rektorit për përmirësimin e kurrikulës së programit.pdf; 143/ 3.15.3. Vendim departamenti për përmirësimin e kurrikulës së programit.pdf;

	Megjithatë, <u>GVJ sugjeron</u> të përfshihet në Planin Mësimor informacioni për ngarkesën mësimore javore të lëndës së praktikës, si dhe informacioni për formën e kontrollit të dijeve ose shlyerjes së lëndëve, duke specifikuar lëndët që shlyen me provim (P) dhe lëndët/modulet apo praktika që shlyen me firmë (F).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënës, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Sipas dokumentit “Korniza konceptuale e programit të studimit Master i Shkencave në Psikologji Shkollore”, çështja 7 “Njohuritë dhe kompetencat që karakterizojnë profilin”, deklarohet se “Dijet dhe njohuritë e përvetësuara në këtë program studimi janë të orinetuara drejt thellimit të shprehive klinike për të ndihmuar individët, familjet dhe grupet me çrregullime të ndryshme neurologjike apo të personalitetit. Ndërlidhja e ngushtë e dijeve teorike, aftësive kërkimore, studimeve të rastit udhëheqin drejt formimit të profesionistëve të rinj. Ky program studimi i orienon studentët drejt praktikave kërkimore, për të rritur aftësitë përshtatëse në tregun e punës ku roli i kërkuesit shkencor po bëhet gjithnjë e më i domosdoshëm” (fq. 8). Realizimi i programit të studimit bazohet në planin mësimor të hartuar, i cili ndërthur disiplina të formimit të përgjithshëm me ato të formimit karakterizues (profesional); disiplina të përafërta plotësuese si dhe ato të natyrës praktike. Programi është ndërtuar në mënyrë të atillë që të mundësojë psikologët shkollore të zhvillojnë aftësi, shprehje dhe shkathtësi specifike, përmes të cilave mund të përballen me një gamë të gjerë çështjesh të lidhura me intervistimin e personave për qëllime vlerësimi, ndërtimin e instrumenteve të vlerësimit dhe monitorimit, ofrimit të këshillimit për grupet shkollore, përbën fokusin kryesor të programit të formimit të psikologut shkollor, si dhe kompetenca të lidhura me rritjen e efikasitetit profesional dhe bashkëveprimin me

	profesionistë të tjerë në fushën e shëndetit mendor; si edhe aftësi të kërkimit shkencor cilësor dhe sasior (fq. 4). ⁹¹ Bazuar në Planin Mësimor të programit të studimit Master i Shkencave në Psikologji me profil 'Psikologji Shkollore', 2018-2019, vërehet se përmban 16 lëndë / module, duke përfshirë edhe praktikën dhe provën finale. Lëndët/modulet janë të ndara sipas kategorive të veprimtarive formuese nga A në E referuar VKM nr. 41/2018, si dhe në vite e semestra dhe me kreditet përkatëse. Programi është shtrirë në 2 vite akademike, 4 semestra dhe realizohet me 120 kredite, sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). ⁹² Shpërndarja e lëndëve dhe praktikës në Planin Mësimor të programit të ciklit të dytë Master i Shkencave në Psikologji me profil Psikologji Shkollore ndjek një hierarki të caktuar që përmbyllet në semestrin e katërt me punimit e diplomës në kuadër të provës finale. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikës, mundëson studentët që të thellojnë njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për punësim, ose mundëson ata të vijojnë studimet në programe të ciklit të tretë.
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.	Lidhur me shpërndarjen e lëndëve/moduleve sipas kategorive nga A në E, për çdo vit akademik të Planit Mësimor, vërehet se: ▪ <u>Në vitin e I-rë akademik zhvillohen:</u> - 4 lëndë të kategorisë A (lëndë bazë/ 24 kredite); - 5 lëndë të kategorisë B (lëndë karakterizuese/30 kredite); - 1 lëndë e kategorisë C (lëndë me zgjedhje/ 6 kredite); ▪ <u>Në vitin e II-të akademik zhvillohen:</u> - 3 lëndë e kategorisë B (lëndë karakterizuese/ 16 kredite); - 1 lëndë e kategorisë C (lëndë me zgjedhje/5 kredite); - 1 lëndë e kategorisë D (praktika 9 kredite); - 1 lëndë e kategorisë E (prova finale/ 30 kredite); Praktika Profesionale (kategoria D/9 kredite/225 orë, nga të cilat 200 orë në auditor dhe 25 orë jashtë auditorit) zhvillohet në semestrin e parë të vitit të dytë. Llogariten rreth 13.3 orë/në javë në auditor dhe 1.6 orë /në javë jashtë auditorit, ose 2.6 orë /në ditë në auditor dhe 0.2 orë jashtë auditorit.

⁹¹ Dokumenti 100/4.1. Korniza konceptuale e programit të studimit.pdf;

⁹² Dokumenti 99/4.2. Plani mësimor i programit të studimit.pdf;

	<u>Nuk është e qartë</u> shpërndarja e ngarkesës mësimore javore e praktikës profesionale, sepse në Planin Mësimor mungojnë të dhënat përkatëse në kolonën “ngarkesa javore”. Në syllabusin e lëndës “Praktikë profesionale”, shpjegohet se praktika “duhet të ofrojë të paktën: (a) 5 orë eksperiencë praktike psikologjike në javë, e cila në 60% të saj të jetë eksperiencë direct vëzhguese por më shumë pritet të jetë ndërhyrëse në institucion. (b) 1 orë në javë mbikqyrje nga një psikolog apo specialist në drejtimin shkollor. (c) Aktivitete të tjera të praktikës mund të jenë: konferencat për rastet apo arritjet e tjera të psikologut shkollor, shkrimi i raporteve, pjesëmarrja në trajnime për çështjet që janë me interes të rritjes profesionale të studentit të DND (fq.4).”⁹³ Prova finale (30 kredite/750 orë mësimore, nga të cilat 50 orë praktikë dhe 700 orë studim individual) realizohet në semestrin e dytë të vitit të dytë.⁹⁴ Në dokumntin “Rregullore e diplomimit në FSHS (2024)”, Kreu III, Neni 8, pika 2, përcakton se “Programet e ciklit të dytë “Master i Shkencave”, përmbillen me punim diplome dhe në përfundim të tyre lëshohet diplomë “Master i Shkencave” në fushën e arsimimit të kryer. Punimi i diplomës përlogaritet nga 10%-15% (kredite) ECTS të planit mësimor”. Neni 9, pika 1 përshkruan se “Punimi i diplomës në ciklin e dytë është kërkim shkencor i pavarur për një problematikë që lidhet me fushën e studimit të programit përkatës. Studentët duhet të jenë të aftë të bëjnë kërkim dhe të raportojnë në lidhje me të gjithë procesin e kërimit, i cili kurorëzohet me tekstin përfundimtar të punimit të diplomës.”⁹⁵ Sipas dokumentit “Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në Psikologji me profil ‘Psikologji Shkollore’” (anglisht), Neni 18, pika 18.1, shprehet se “Teza është një punim shkencor që studenti duhet ta mbrojë për të fituar diplomën Master i Shkencave në “Psikologji Shkollore”.⁹⁶ Për sa më lartë, GVJ vlerëson se lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe kërimit shkencor.
--	---

⁹³ Dokumenti 213/doc00125420241218122636.pdf; (syllabusi praktikës profesionale)

⁹⁴ Dokumenti 99/4.2. Plani mësimor i programit të studimit.pdf;

⁹⁵ Dokumenti 193/ 2.11.Rregullore e Diplomimit FSHS.pdf;

⁹⁶ Dokumenti 110/ 5.4. Rregullorja e programit të studimit.pdf;

Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	Në Planin Mësimor (2018-2019) të programit të studimit Master i Shkencave në Psikologji me profil Psikologji Shkollore, janë pasqyruar 16 lëndë, duke përfshirë edhe praktikën dhe provën finale, të cilat janë ndarë sipas kategorive të veprimtarive formuese, si dhe në vite e semestra, dhe me kreditet përkatëse. Çdo lëndë në Planin Mësimor e parashikuar për t’u zhvilluar në auditor, përbëhet nga komponentët mësimore si “leksione”, “seminare” dhe “orë praktike”. Me përjashtim të lëndës “Praktikë profesionale”, nuk konstatohen ndonjë lëndë tjetër që të përfshijë përveç leksioneve dhe seminareve, edhe komponentin mësimor “praktikë/laborator”. Në Planin Mësimor të programit të studimit të marrë në vlerësim, gjenden dy lëndë (<i>Praktikum në punën me familjen dhe grupet në kontekstin shkollor; Praktikum në këshillim</i>), emërtimi i të cilave lë vend për përfshirjen e praktikës/laboratorit. Komponenti i praktikës profesionale përmban 9 kredite /225 orë dhe zhvillohet në semestrin e parë, të vitit të dytë. Nga kjo pikëpamje, raporti teori – praktikë në programin e ciklit të dytë Master i Shkencave në Psikologji me profil ‘Psikologji Shkollore’ (9 kredite/225 orë) rezulton në favor të teorisë me 92,5% kredite teori dhe 7,5% kredite praktikë. Ky raport nuk përputhet plotësisht me përcaktimet e VKM Nr. 41, datë 24.01.2018, “Për veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit” (Shtojca, Tabela 1, Për ciklin e dytë). Gjatë takimit me stafin akademik dhe studentët e programit Master i Shkencave në Psikologji me profil ‘Psikologji Shkollore’, u shpjegua se “<i>Detyrat lëndore / studimore që u jepen studentëve për t’u punuar në auditor ose jashtë auditorit, si dhe teza e diplomimit synojnë që të lidhin ngushtësisht teorinë me praktikën</i>”. <u>GVJ sugjeron</u> të rritet numri i krediteve për realizimin e lëndës “Praktikë profesionale” sipas përcaktimeve të VKM Nr. 41, datë 24.01.2018. Gjithashtu, të merren në shqyrtim komponentët mësimorë të disa lëndëve profesionale në Planin Mësimor të programit Master i Shkencave në Psikologji me profil në Psikologji Shkollore, të cilat janë parashikuar të zhvillohen vetëm me leksione dhe seminare, për të gjykuar mbi nevojën e përfshirjes edhe të komponentit “praktikë/laborator”.
---	---

Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.

Referuar dokumentit “Korniza kurrikulare e programit Master i Shkencave në Psikologji me profil Psikologji Shkollore”, çështja 3 “Objektivat e programit të studimit dhe rezultatet e pritshme”, përshkruhet se “Realizimi i programit të studimit bazohet në planin mësimor të hartuar, i cili ndërthur disiplina të formimit të përgjithshëm me ato të formimit karakterizues (profesional); disiplina të përafërta plotësuese si dhe ato të natyrës praktike. Programi është ndërtuar në mënyrë të atillë që të mundësojë psikologët shkollore të zhvillojnë aftësi, shprehje dhe shkathtësi specifike, përmes të cilave mund të përballen me një gamë të gjerë çështjesh të lidhura me intervistimin e personave për qëllime vlerësimi, ndërtimin e instrumenteve të vlerësimit dhe monitorimit, ofrimit të këshillimit për grupet shkollore, përbën fokusin kryesor të programit të formimit të psikologut shkollor, si dhe kompetenca të lidhura me rritjen e efikasitetit profesional dhe bashkëveprimin me profesionistë të tjerë në fushën e shëndetit mendor; si edhe aftësi të kërkimit shkencor cilësor dhe sasior” (fq. 4).⁹⁷

Në Planin Mësimor (2018-2019) të programit të studimit Master i Shkencave në Psikologji me profil ‘Psikologji Shkollore’, janë pasqyruar 16 lëndë, duke përfshirë edhe praktikën dhe provën finale, të cilat janë ndarë sipas kategorive të veprimtarive formuese, si dhe në vite e semestra, dhe me kreditet përkatëse.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur të dhënat lidhur me strukturën e programit të studimit referuar Planit Mësimor, krahasuar me përcaktimet në VKM Nr. 41/2018 “Për veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit” (Shtojca, Tabela 1, Për ciklin e dytë)

Kategor.	Përshkrimi	Sipas VKM 41/2018 (i ndryshuar)	Të dhënat në PS	
			ETCS	%
A	Lëndë Bazë	5%-10%	24	20 %
B	Lëndë karakterizuese	50%-60%	46	38.33%
C	Lëndë ndërdisiplinore/ integruese	12%-20%	11	9.16%
D	Lëndë plotësuese	10%	9	7.5%

⁹⁷ Dokumenti 100/4.1. Korniza konceptuale e programit të studimit.pdf;

	E	Detyrime përmbyllëse	10%-15%	30	25%
	Analiza e të dhënave tregon se ngarkesa në kredite për lëndët e kategorisë A, B, C, D dhe E, nuk janë në përputhje me përcaktimet e VKM Nr. 41/2018 për programet e ciklit të dytë Master i Shkencave. Gjithashtu, lëndët e kategorive A dhe B, të marra së bashku, rezultojnë më pak se 60 kredite të përcaktuara në VKM Nr. 41/2018 (e ndryshuar me VKM Nr. 879/2019) për rastin e programeve “Master i shkencave”. Komponenti i praktikës përmban 9 kredite /225 orë nga 10 kredite të përcaktuara në VKM Nr. 41/2018 (e ndryshuar me VKM Nr. 879/2019) për rastin e programeve “Master i shkencave”. Praktika profesionale zhvillohet në semestrin e parë, të vitit të dytë. Nga kjo pikëpamje, raporti teori – praktikë në programin e ciklit të dytë Master i Shkencave në Psikologji me profil ‘Psikologji Shkollorë’ (9 kredite/225 orë) rezulton në favor të teorisë me 92.5% kredite teori dhe 7.5% kredite praktikë. Ky raport <i>nuk është në përputhje të plotë</i> me natyrën e programit Master i Shkencave dhe me përcaktimet e VKM Nr. 41, datë 24.01.2018, “Për veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit” (Shtojca, Tabela 1, Për ciklin e dytë). Pavarësisht se ndarja sipas veprimtarive formuese të programit të studimit të marrë në vlerësim, nuk përputhet plotësisht me përcaktimet e VKM NR. 41/2018, raportet midis formimit teorik (92.5 % kredite) dhe praktik (7.5 % kredite) mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve. Procedurat për transferimin e studentëve përshkruhen në Rregulloren e FSHS (2023), Kreu V, Neni 64 dhe Neni 65 i këtij dokumenti.⁹⁸ Sipas të dhënave të institucionit për trevitët e fundit, nuk ka raste të studentëve të transferuar.⁹⁹ FSHS/DPP dëshmon në dokumentin “Të dhëna për mobilitetin e studentëve dhe të pedagogëve” se gjatë dy viteve të fundit 2022-				

⁹⁸ Dokumenti 29/ 2.4.Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale 2023.pdf;

⁹⁹ Dokumenti 108/4.8.Të dhëna të plota për regjistrimin, ecurinë, diplomimin e studentëve.pdf;



	2023 dhe 2023-2024 kanë përfituar 2 pedagogë dhe 1 student nga projektet e mobilitetit. ¹⁰⁰
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Shqyrtimi i programeve lëndore (syllabuset) për dy vitet e studimit të programit Master i Shkencave në Psikologji me profil ‘Psikologji Shkollore’, tregoi se ato janë hartuar në përputhje me elementet e modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 2 që i bashkëlidhet VKM Nr. 41, datë 24.01.2018, “Për veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit”, Pika 2.8 “Programi lëndor (syllabus-et)”, (i ndryshuar me VKM Nr. 879, datë 18.12.2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, “për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, Shtojca 3 “Programi i lëndës”) Lidhur me këtë element të programit lëndor janë evidentuar praktika të mira të përditësimit të literaturës. Gjenden disa syllabuse që kanë përfshirë botime të 5 viteve të fundit si: 2023; 2022; 2021; 2020.¹⁰¹ Një pjesë e syllabuseve kanë nevojë që titullarët e tyre të vijojnë përpjekjen për të përditësuar literaturën bazë të detyruar dhe literaturën ndihmëse/ të rekomanduar me botime të 5 viteve të fundit. Gjithashtu, janë vërejtur raste kur literatura e rekomanduar dominohen kryesisht nga botime në gjuhë të huaj angleze. Për këto raste, gjatë takimit në institucion, stafi akademik arsyetoi se studentët zotërojnë gjuhën angleze dhe punojnë lehtësisht me literaturën. Titullarët e lëndëve kujdesen që literatura të jetë e aksesueshme, qoftë në librari, në bibliotekën universitare, apo bibliotekat digjitale, duke u ofruar studentëve literaturë në format e-book, kryesisht në gjuhën angleze. Përveç kësaj, titullarët e lëndëve kanë përgatitur cikle të leksioneve në gjuhën shqipe. Ndërkohë, studentët pohuan gjatë takimit në institucion se ata nuk ndihen të mbingarkuar me literaturën bazë dhe të rekomanduar në gjuhë angleze.
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve,	Referuar dokumentit “Korniza konceptuale e programit të studimit Master i Shkencave në Psikologji me profil ‘Psikologji Shkollore’”, çështja 3 “Objektivat e programit të studimit dhe rezultatet e

¹⁰⁰ Dokumenti 121/3.20. Të dhëna për mobilitetin e studentëve dhe të pedagogëve.pdf;

¹⁰¹ Dokumenti 117/ doc00122020241218121035.pdf; 173/doc00131720241218130806.pdf; 176/ doc00134520241218133907.pdf;

aftësive dhe kompetencave të synuara.	<i>pritshme</i>”, deklarohet se “Programi është ndërtuar në mënyrë të atillë që të mundësojë psikologët shkollorë të zhvillojnë aftësi, shprehi dhe shkathtësi specifike, përmes të cilave mund të përballen me një gamë të gjerë çështjesh të lidhura me intervistimin e personave për qëllime vlerësimi, ndërtimin e instrumenteve të vlerësimit dhe monitorimit, ofrimit të këshillimit për grupet shkollorë, përbën fokusin kryesor të programit të formimit të psikologut shkollor, si dhe kompetenca të lidhura me rritjen e efikasitetit profesional dhe bashkëpunimin me profesionistë të tjerë në fushën e shëndetit mendor; si edhe aftësi të kërkimit shkencor cilësor dhe sasior” (fq. 4).¹⁰² Disiplinat mësimore dhe aktivitetet e tjera janë organizuar në disa kategori lëndësh me 120 kredite. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programin e studimit të ciklit të dytë.
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Sipas dokumentit “Korniza konceptuale e programit të studimit Master i Shkencave në Psikologji me profil ‘Psikologji Shkollorë’”, çështja 7 “Njohuritë dhe kompetencat që karakterizojnë profilin”, deklarohet se “Dijet dhe njohuritë e përvetësuara në këtë program studimi janë të orinetuara drejt thellimit të shprehive klinike për të ndihmuar individët, familjet dhe grupet me çrregullime të ndryshme neurologjike apo të personalitetit. Ndërlidhja e ngushtë e dijeve teorike, aftësive kërkimore, studimeve të rastit udhëheqin drejt formimit të profesionistëve të rinj. Ky program studimi i orienton studentët drejt praktikave kërkimore, për të rritur aftësitë përshtatëse në tregun e punës ku roli i kërkuesit shkencor po bëhet gjithnjë e më i domosdoshëm” (fq. 8).¹⁰³ Programi i studimit Master i Shkencave në Psikologji me profil ‘Psikologji Shkollorë’ i referohet nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Nga kjo pikëpamje, përmbajtja e programit të studimit mundëson studentët për vijimin e mëtejshëm të studimeve në ciklin e tretë ose punësimin e tyre në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës. Punësimi në profesionin e psikologut shkollor është i rregulluar me Ligjin 40/2016 “Për Urdhrin e psikologut në RSH”, i cili sipas Nenit 2, ka për qëllim përcaktimin e kriterëve për ushtrimin e profesionit të psikologut, garantimin e standardeve

¹⁰² Dokumenti 100/4.1. Korniza konceptuale e programit të studimit.pdf;

¹⁰³ Dokumenti 100/4.1. Korniza konceptuale e programit të studimit.pdf;

	etiko-profesionale në ushtrimin e këtij profesioni, në mbrojtje të interesit publik, duke respektuar parimin e autonomisë së profesionit të psikologut. Një nga kriteret kyç për punësim është që kandidati të ketë plotësuar 2 cikle të plota studimi Bachelor në Psikologji dhe Master në një degë të specialitetit në Psikologji, të ketë kryer praktikën e supervizuar njëvjeçare pas përfundimit të studimeve Master, dhe të ketë fituar licensën përmes Urdhrit të Psikologut për ushtrimin e profesionit. Institucioni zotëron një informacion të plotë për numrin e të diplomuarve të punësuar të ofruar përmes një studimi gjurmues të tregut të punës dhe të pasqyruar në dokumentin “<i>Alumni Master Profesional në Psikologji Shkollore – Rezultate mbi punësimin (dhjetor, 2024)</i>”¹⁰⁴ Të dhënat e mësipërme dhe rezultatet e studimit për punësimin e ish-studentëve të diplomuar në FSHS/DPP, janë një tregues real se përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve ose punësimin në përshtatje me kërkesat e tregut e punës brenda dhe jashtë vendit.			
Konkluzione	Struktura dhe organizimi i programit të studimit të marrë në vlerësim është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës. <i>Megjithatë, GVJ sugjeron të rritet numri i krediteve për realizimin e lëndës “Praktikë profesionale” sipas përcaktimeve të VKM VKM Nr. 41, datë 24.01.2018. Gjithashtu, të merren në shqyrtim komponentët mësimorë të disa lëndëve profesionale në Planin Mësimor të programit Master i Shkencave në Psikologji me profil ‘Psikologji Shkollore’, të cilat janë parashikuar të zhvillohen vetëm me leksione dhe seminare, për të gjykuar mbi nevojën e përfshirjes edhe të komponentit “praktikë/laborator”.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

¹⁰⁴ Dokumenti 120/3.22. Studimi mbi tregun e punës së psikologut shkollore (rezultate mbi punësimin).pdf;

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	FSHS/DPP ka shpallur prioritet strategjik zhvillimin e kurrikulave, përfshi edhe kurrikulën e programit të studimit të marrë në vlerësim. Në dokumentin “Strategjia e zhvillimit të programit të studimit Master i Shkencave në Psikologji me profil ‘Psikologji Shkollore’” (2020-2024), mes të tjerash theksohet se “(7) <i>Rishikimi i kurrikulave me qëllim përshtatjen e tyre me nevojat e tregut, prioritetet e zhvillimit kombëtar, rajonal dhe European sipas VKM 41 për të pare përqindjet dhe emërtimin e lëndëve</i> (fq.9)”.¹⁰⁵ FSHS, si pjesë e UT, dëshmon me anë të dokumentit “<i>Lista e marrëveshjeve të praktikës</i>” se ka vendosur marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programit të studimit.¹⁰⁶ Gjenden të depozituara në e-ASCAL formate të marrëveshjeve ndërinstytucionale midis UT/FSHS me institucione dhe organizata të ndryshme, ku përcaktohen qartë përgjegjësitë reciproke lidhur me kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës profesionale.¹⁰⁷ Gjatë vizitës në institucion, drejtuesja dhe koordinatoja e programit të studimit shpjegoi se rishikimi i programeve të studimit bëhet para fillimit të vitit të ri akademik. Ky proces synon korrigjimin e problemeve që janë ndeshur gjatë procesit mësimor dhe praktikave profesionale, si dhe përditësimin e përmbajtjes së programit të studimit në përgjigje të kërkesave të tregut të punës. Vëmëndje e posaçme tregohet për përmirësimin e programeve lëndore, duke reflektuar prirjet teorike dhe praktike më të mira në fushat lëndore respektive, si dhe rifreskimin e burimeve të literaturës bazë të detyruar dhe të rekomanduar për studentët. Në lëndën e praktikës, diskutohet së bashku me studentët rreth sfidave që janë hasur gjatë periudhës së praktikimit dhe pasi analizohen me kujdes, kthehen në objektiva për vitin pasardhës. DPP planifikon takime pune, tryeza të rrumbullakta, si dhe vendos komunikim të drejtpërdrejtë me institucionet partnere, jo vetëm për realizimin e praktikës

¹⁰⁵ Dokumenti 139/ 3.5. Strategjia e zhvillimit të programit të studimit.pdf;

¹⁰⁶ Dokumenti 144/3.17. Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe e partnerëve për praktikën profesionale.pdf;

¹⁰⁷ Dokumenti 238/doc00117520241218115421.pdf; 239/doc00117720241218115447.pdf; 240/doc00117620241218115427.pdf; 241/doc00116920241218115014.pdf;

	profesionale, por edhe për të përfituar nga konsultimi me ekspertë të ndryshëm nga këto institucione lidhur me sfidat për të përmirësuar programin e studimit MSH-PSH, në përgjigje të kërkesave të tregut të punës. GVJ vlerëson si një praktikë të mirë që FSHS/DPP konsultohet dhe merr parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit Master i Shkencave në Psikologji me profile Psikologji Shkollore, si dhe përshtatjen sa më mirë të tij me kërkesat e tregut të punës.
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	FSHS/DPP inkurajon dhe përfshin në diskutime në kuadër të përmirësimit të programit të studimit edhe studentët. Propozimet diskutohen dhe reflektohen nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit. Në dokumentin “Rregullore e Masterit të Shkencave në Psikologji Shkollore” (anglisht), në Nenin 10.2.2 “<i>Detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorit</i>”, specifikohet se “(20) Koordinatori ndërvepron dhe mban lidhje me studentët, personelin akademik, ndihmësakademik dhe agjencitë e jashtme/komunitetin për të lehtësuar përmbushjen e objektivave të programit”.¹⁰⁸ Gjatë vizitës në institucion, GVJ mësoi se koordinatorja e programit MSH-PSH, në zbatim të Rregullores përkatëse, kryen takime periodike me studentët dhe pedagogët e përfshirë në këtë program, për të ndjekur nga afër dhe zgjidhur në kohë problematikat e mundshme. Këto takime synojnë që të inkurajojnë studentët të diskutojnë hapur rreth problemeve apo vështirësive të ndeshura, si dhe të përcjellin mendimet dhe propozimet e tyre për çështje të ndryshme, duke kontribuar në përmirësimin e procesit mësimor dhe arritjes së objektivave të programit të studimit. Në rastet kur studentët kanë vërejtur nevojën për të rishikuar orarin mësimor, apo aspekte të mbingarkesës me detyra, vecanërisht për studentët e punësuar, koordinatori ka diskutuar me pedagogë të caktuar për të përshtatur oraret ose rishikuar afatet e dorëzimit të detyrave, etj. FSHS/DPP mban kontakte me studentët e diplomuar në mënyrë të vazhdueshme, konsultohet me ta dhe merr prej tyre propozime profesionale për përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit. DPP dëshmon se përfshin ish-studentët e diplomuar në

¹⁰⁸ Dokumenti/110/5.4. Rregullorja e programit të studimit.pdf (anglisht)

	MSH-PSH, në studime me qëllim përmirësimin e treguesve të cilësisë së programit të studimit që ofron.			
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	FSHS si pjesë e UT, dëshmon se ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucione homologe dhe kërkimore e shkencore, publike e private, njësitë e pushtetit vendor, agjensi, qendra shërbimi dhe trajtimi psikologjik, etj., me të cilat bashkëpunon për realizimit të praktikave profesionale dhe projekteve kërkimore, dhe që ndihmojnë institucionin të reflektojë dhe të punojë për mbarëvajtjen, përditësimin, përshtatjen dhe riorganizimin e programeve të posaçme me fushë specifike studimi e kërkimi, sikurse programi MSH-PSH. Në dokumentin “<i>Strategjia e zhvillimit të programit të studimit Master i Shkencave në Psikologji me profil ‘Psikologji Shkollore’ (2020-2024)</i>”, institucioni deklaron se është angazhuar për të përmbushur objektivat lidhur me “rishikimin e kurrikulave me qëllim përshtatjen e tyre për të pasqyruar zhvillimet në shkencën e Psikologjisë, pasuruar në veprimtarinë shkencore të vendeve të zhvilluara kryesisht OECD, BE, G20.”¹⁰⁹ Gjatë vizitës së institucionit, GVI mësoi se FSHS/DPP ka marrëdhënie bashkëpunimi edhe me Institucionin e Urdhrit të Psikologut, me të cilin kooperon për të këmbyer të dhëna studimore për numrin e të diplomuarve të licensuar dhe punësuar ndër vite, si dhe kontakton dhe mirëpret këshilla e propozime nga ekspertë dhe profesionistë të fushës së psikologjisë klinike, lidhur me zhvillimet e reja në tregun punës me qëllim përmirësimin e përmbytjes së programit të studimit të marrë në vlerësim.			
Konkluzione	UT/FSHS/DPP dëshmon se nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.6

Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.

Kriteret


Vlerësimi i ekspertëve

¹⁰⁹ Dokumenti 139/ 3.5. *Strategjia e zhvillimit të programit të studimit.pdf*;

Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesore të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Programi i studimit Master i Shkencave në Psikologji me profile Psikologji Shkollore përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesore të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit. Sipas dokumentit “<i>Korniza konceptuale e programit të studimit Master i Shkencave në Psikologji me profil ‘Psikologji Shkollore’</i>”, në çështjen 7 “<i>Njohuritë dhe kompetencat që karakterizojnë profilin</i>”, përkufizohet se “Dijet dhe njohuritë e përvetësuara në këtë program studimi janë të orinetuara drejt thellimit të shprehive klinike për të ndihmuar individët, familjet dhe grupet me çrregullime të ndryshme neurologjike apo të personalitetit. Ndërlidhja e ngushtë e dijeve teorike, aftësive kërkimore, studimeve të rastit udhëheqin drejt formimit të profesionistëve të rinj. Ky program studimi i orienton studentët drejt praktikave kërkimore, për të rritur aftësitë përshtatëse në tregun e punës ku roli i kërkuesit shkencor po bëhet gjithnjë e më i domosdoshëm” (fq. 8).¹¹⁰ Në linjë me këtë dokument strategjik, FSHS/DPP ka përpunuar dokumentin “<i>Strategjia e zhvillimit të programit të studimit Master i Shkencave në Psikologji me profil Psikologji Shkollore (2020-2024)</i>” të përqëndruar në shtyllat prioritare si më poshtë: 1) Zhvillimi i kurrikulës; 2) Përsosmëria në mësimdhënie dhe në të nxënë; 3) Kërkimi shkencor; 4) Zhvillimi i partneriteteve; 5) Ndërkombëtarizimi; 6) Sigurimi i cilësisë;
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	FSHS/DPP nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies dhe veprimtaritë kërkimore, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit. Për përmbushjen e këtij kriteri, FSHS/DPP udhëhiqet nga përcaktimet e “Kodit të Etikës së UT (2011)”, Neni 6 i tij, pika 1, që shprehet se “<i>Personeli akademik gëzon liri akademike në kërkimet, punimet shkencore dhe metodologjinë e mësimdhënies. Pedagogët duhet t’i përmbahen përdorimit të përgjegjshëm të lirisë akademike duke iu nënshtruar një programi mësimor të miratuar. Ata duhet të realizojnë me performance të lartë kërkimin, mësimdhënien dhe praktikën, nëpërmjet leximit, studimit, eksperimentimit, vëzhgimit, shkëmbimit dhe vetëvlerësimit objektiv</i>

¹¹⁰ Dokumenti 100/4.1. Korniza konceptuale e programit të studimit.pdf;

13 52



	duke zgjedhur metoda dhe mënyra efikse, të dobishme, të kuptueshme dhe frytdhënëse për studentët” (fq.4).¹¹¹ Referuar dokumentit “Raport periodik analitik bazuar në të dhënat për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të personelit akademik në vitet e fundit (2024)” mësohet se stafi akademik i DPP përgjegjës për programin e studimit të marrë në vlerësim, ka shënuar angazhim domethënës në kërkim shkencor dhe projekte kombëtare dhe ndërkombëtare.¹¹²
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	Programi i studimit Master i Shkencave në Psikologji me profil ‘Psikologji Shkollore’ mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore. Për përmbushjen e këtij kriteri, FSHS/DPP udhëhiqet nga “Kodi i Etikës së UT (2011)”, Neni 6 i tij “Përhapja e dijeve dhe liria akademike”, pika 3, që përcakton se “Pedagogët duhet të përmirësojnë vazhdimisht metodologjinë në mënyrë që të kenë efektivitet në mësimdhënie, të inkurajojnë studentët për të vepruar në mënyrë të lire dhe të pavarur, si dhe t’u shpjegojnë atyre metodat e vlerësimit” (fq.4).¹¹³ Gjithashtu, FSHS/DPP bazohet edhe në dokumentin “Rregullore e Masterit të Shkencave në Psikologji Shkollore” (anglisht), neni 7 i tij “Veprimtaria e MSH-PSH”, ku mes të tjerash përshkruhet se “(7.3.2) Veprimtaria kërkimore realizohet nëpërmjet kërkesave specifike të lëndëve/moduleve të ndryshme, punimeve empirike të diplomës, konferencave, sesioneve shkencore, seminareve dhe veprimtarive të tjera me fokus kërkimin. (7.3.3) Gjetjet e projekteve kërkimore do të diskutohen nëpërmjet konferencave, sesioneve shkencore, seminareve dhe veprimtarive të tjera studentore, me përfshirje edhe të stafit akademik” (fq. 4).¹¹⁴ Gjatë vizitës në institucion, GVJ mësoi se studentët e programit angazhohen nga pedagogët e tyre në detyra kursi me karakter studimor me qëllim zhvillimin e aftësive për të hulumtuar dhe shqyrtuar literaturën përkatëse. Gjithashtu, studentët angazhohen në realizimin e projektit kërkimor në kuadër të punimit dhe mbrojtjes së temës së diplomës. FSHS/DPP përfshin studentët në aktivitetet shkencore të organizuara në nivel fakulteti, në projekte mobiliteti

¹¹¹ Dokumenti 186/1.5. kodi-i-etikes 2011.pdf;

¹¹² Dokumenti 86/4.7. Te dhenat e plota per kerkimin shkencor ne kuader te programit te studimit.pdf;

¹¹³ Dokumenti 186/1.5. kodi-i-etikes 2011.pdf;

¹¹⁴ Dokumenti 110/5.4. Rregullorja e programit te studimit.pdf (anglisht)

	dhe veprimtari të ndryshme studimore, me përfshirje edhe të stafit akademik.			
Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	Në dokumentin “Raport vjetor për veprimtaritë e kryera (10.10.2022)”, sqarohet se “shkëmbimet midis stafit të DPP dhe të huaj kanë qënë të mbuluara nga projekte të tjera (p.sh. Erasmus+). Njësia kryesore nuk ka mbuluar asnjëherë financiarisht aktivitetet e stafit akademik për shkëmbim eksperiencash. Por, ka qënë gjithnjë mbështetëse për të akomoduar lejet e stafit kur largoheshin për një periudhë të caktuar ... për të marrë pjesë në të tilla aktivitete”. ¹¹⁵			
Konkluzione	Programi i studimit Master i Shkencave në Psikologji me profil Psikologji Shkollore garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.7	
Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	UT/FSHS mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor. Disa projekte dhe aktivitete ku DPP është përfshirë janë: 1) Projekti “Learning Culture in Universities (LECU)”, i drejtuar nga Zurich University of Teacher Education (Pädagogische Hochschule Zürich), International Projects in Education (IPE); 2) Përmirësimi i programit dhe ndërtimi i laboratorit të parë për këshillim profesional pranë FSHS; 3) “Faces from the Past: The Fight for Freedom and Democracy during the Regime of Hoxha” with reference no. 609250-CITIZ-1-2019-1-AL- CITIZ-REMEM, grant agreement no. 2019-2111/001- 001, projekt i financuar nga programi - Europe for Citizens;

¹¹⁵ Dokumenti 123/ 3.18.1. Raport për veprimtarinë e programit të studimit për vitin akademik.pdf;

	4) Sexual harassment in academic area. Kërkim, i cili po zhvillohet në nëntë vende të Europës si: Suedi, Portugali, Kroaci, Angli, Maltë, etj; 5) Interba – Internationalization at Home: Embedding Approaches and Structures to Foster Internationalization at Western Balkans; Gjithashtu, institucioni informon se aktualisht veprojnë <i>tre projekte ku përfshihet programi i studimit i marrë në vlerësim.</i> 1. <i>Projekti Erasmus+ Universiteti Bergen në Norvegji.</i> 2. <i>Projekti Erasmus+ Universiteti i Romës "La Sapienza".</i> 3. <i>Projekti studimore quasi eksperimental midis tre universiteteve Epoka e Re, GIZ dhe UT/FSHS "Vlerësimi i ndikimit të sportit në zhvillimin e të rinjëve dhe orientimin e tyre në tregun e punës".¹¹⁶</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	DPP, njësia përgjegjëse për programin e studimit, angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe/ose studentët për realizimin e këtyre objektivave. DPP argumenton se <i>"Përfshirja e stafit akademik dhe studentëve të DPP-së në një sërë projektesh e studimesh me karakter kërkimor shkencor zhvillon dijet dhe kompetencat profesionale të tyre".¹¹⁷</i> Institucioni informon përmes dokumentit <i>"Lista e projekteve që kanë patur ndikim në zhvillimin e programit të studimit"</i> se stafi akademik dhe/ose studentët janë të angazhuar në 13 projekte kombëtare dhe 5 projekte ndërkombëtare.¹¹⁸ Disa prej projekteve janë: 1) <i>Shkolla e Drejtorëve (CSL);</i> 2) <i>AKKSHI;</i> 3) <i>Validimi i instrumentit të orientimit profesional VISA si pjesë e marrëveshjes me Risi Albania dhe Universitetin e Lozanës;</i> 4) <i>Sfida për përmirësimin e mësimin online – projekt kërkimor, mbështetur nga AMSHC - Forumi Shqiptar Social Ekonomik – Aset;</i>

¹¹⁶ Dokumenti shtesë 3/5. Liste projektsh për këtë program studimi (racionale) 1 1.pdf;

¹¹⁷ Dokumenti 1/ 3.23. RVB në gjuhën shqipe.pdf;

¹¹⁸ Dokumenti 167/ 4.12. Lista e projekteve që kanë patur ndikim në zhvillimin e programit të studimit.pdf;

	5) <i>Projekti kombëtar i Ministrisë së Arsimit, Rinisë dhe Sporteve "Për trajnimin e mësuesve 2019-2021", në bashkëpunim me Fondacionin "Joscelyn";</i> 6) <i>Implementation of Articles 16 & 12 of the Istanbul Convention – country report – UN Women & WWP EN;</i> 7) <i>Project Evaluation: "Support for the network for the catholic education institutions in Albania." Commissioned by Komisioni Kombëtar i Edukimit Katolik Shqiptar – KKEKSH;</i> 8) <i>Improving the Nutrition Status of school age children in Albania, ACER and UNICEF, Methodologist and coordinator for communication for behaviour change, 2020;</i> 9) <i>The causes of unethical behaviours and corruption in Albanian Education system, National Study in all Albanian education levels, Methodologist and data analyst, conducted by ACER and supported by Mary World Loreto, 2020;</i> 10) <i>National study for needs assessment targeting LGBTI in the project "Supporting LGBTI+ People in Albania through Empowerment Services, Standardization of Social Services and Changing of Negative Stereotypes" by "Streha" Center and German Embassy, 2020;</i> 11) <i>Evaluation Report "My school is a safe place" UNICEF and YËCA: Methodologist and Report writer", 2020;</i> 12) <i>Bashkëpunimi me rrjetin Rajonal Western Balkans European Social Survey për të promovuar Anketën Sociale Europiane;</i> 13) <i>Bashkëpunimi me GIZ për hartimin e një kurrikule për praktikantët e pastrimit të parave;¹¹⁹</i> 14) <i>Projekti Erasmus+ Universiteti Bergen në Norvegji.</i> 15) <i>Projekti Erasmus+ Universiteti i Romës "La Sapienza".</i> 16) <i>Projekti studimore quasi eksperimental midis tre universiteteve Epoka e Re, GIZ dhe UT/FSHS "Vlerësimi i ndikimit të sportit në zhvillimin e të rinjëve dhe orientimin e tyre në tregun e punës".¹²⁰</i>
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin	DPP, njësia përgjegjëse për programin e studimit organizon konferenca ose aktivitete të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave. Referuar dokumentit "<i>Raport periodik analitik bazuar në të dhënat për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të personelit akademik në</i>

¹¹⁹ Dokumenti 1/ 3.23. RVB ne gjuhen shqipe.pdf;

¹²⁰ Dokumenti shtesë 3/5. Liste projektesh per kete program studimi (racionale) 1 1.pdf;

dhe studentët për arritjen e objektivave.

vitet e fundit (2024)”¹²¹ mësohet se produktet dhe veprimtaritë shkencore të personeli akademik i DPP, janë si më poshtë:

Aktivitete individuale të stafit akademik në funksion edhe të programit të studimit, në vitet e fundit		
1	Numri i botimeve nga personeli akademik efektiv i Departamentit	19
2	Artikuj shkencor	74
3	Referime në konferenca shkencore	132
4	Monografi	7
5	Projekte shkencore të fituara nga DPP dhe si pale e tretë	36

Referuar të dhënave të paraqitura në RVB (2024), për veprimtarinë kërkimore shkencore të personelit akademik të DPP, për vitin 2018-2023, mësohet se kanë botuar rreth **36 botime shkencore** dhe **45 artikuj shkencor**. Botimet shkencore kanë qenë kryesisht brenda vendit, por disa pedagogë kanë botuar edhe në vende të Bashkimit Europian. Botimet shkencore kanë qenë si në formën e artikujve të mirëfilltë shkencorë, ashtu edhe në formën e raporteve. Gjatë vitit akademik 2018-2023 pedagogët e DPP kanë zhvilluar **104 referime në konferenca shkencore** të zhvilluara në Shqipëri, Zvicër, Gjermani, Bullgari, Azerbajxhan etj.; **5 Monografi** dhe **36 projekte shkencore** të fituara edhe si pale e tretë.”¹²²

Gjendet një mospërputhje e shifrave lidhur me produktet kërkimore shkencore të stafit akademik të DPP-së të deklaruara në RVB (2024) dhe dokumentin “Raport periodik analitik bazuar në të dhënat për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të personelit akademik në vitet e fundit (2024).

Megjithatë, shqyrtimi i raportimeve personale për veprimtarinë kërkimore¹²³ dhe CV-ve të personelit akademik¹²⁴ të DPP të

¹²¹ Dokumenti 86/4.7. Te dhenat e plota per kerkimin shkencor ne kuader te programit te studimit.pdf;

¹²² Dokumenti 1/ 3.23. RVB ne gjuhen shqipe.pdf;

¹²³ Dokumenti 160/ DOC0#NHZ.PDF; 161/ DOC0#41K.PDF; 162/ DOC0#EYN.PDF; 163/ DOC0#IAJ.PDF; 164/ DOC0#QO3.PDF; 168/ DOC0#BWQ.PDF;

¹²⁴ Dokumenti 170/ doc00128620241218123717.pdf; 220/ doc00128120241218123549.pdf; 221/ doc00128020241218123530.pdf; 222/ doc00128420241218123645.pdf; 224/ doc00129020241218123831.pdf; etj.

	depozituara në e-ASCAL, tregoi një rritje nga vitit në vit i angazhimit të tyre në veprimtari shkencore brenda dhe jashtë vendit, si dhe kontribute shkencore në lëmin e botimeve, artikujve shkencorë dhe referimeve në konferenca të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare. Gjatë vizitës në institucion, GVJ mësoi gjithashtu se organizimi i konferencave shkencore vjetore, kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e pedagogjisë dhe psikologjisë, është kthyer në një traditë akademike për DPP. Stafi akademik i DPP merr pjesë në veprimtari të ndryshme shkencore që organizojnë IAL-të e tjera në fusha të përafërta studimi.
Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	Programi i studimit <i>Master i Shkencave në Psikologji me profil Psikologji Shkollore</i>, formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar të punës. Në dokumentin "<i>Korniza konceptuale e programit të studimit Master i Shkencave në Psikologji me Profil 'Psikologji Shkollore'</i>", çështja 3 "<i>Objektivat e programit të studimit dhe rezultatet e pritshme</i>", përshkruhet se "<i>Programi ka si objektiva të tij:</i> <i>Përgatitjen e specialistëve të lartë dhe studiuesve në fushën e studimeve pedagogji-psikologjike, projekteve kërkimore mbi dukuri dhe problematika sociale, rekomandimeve për politikat publike arsimore dhe vlerësime të impaktit të reformave sociale.</i> <i>Mbëstetjen me njohuri të integruara të studiuesve të ardhshëm të dukurive pedagogji-psikologjike, me qëllim formimin e aftësimin e psikologëve shkollorë dhe pajisjen e tyre me njohuri, qëndrime e shkathtësi, kryesisht në fushën e zhvillimit personale sociale dhe në fushën e psikopatologjive, në fushën e matjes dhe të vlerësimit, në fushën e pedagogjisë dhe në fushën e këshillimit, të aftë që të ofrojnë shërbime bashkëkohore në fushën e psikologjisë shkollore, për t'i shërbyer nxënësit, shkollës dhe sistemit arsimor, në funksion të parandalimit dhe minimizimit të shfaqjeve të problemeve shoqërore gjatë reformave në nivele të ndryshme, si dhe ndryshimit të shpejtë dhe shumëpërmasor të shoqërisë shqiptare.</i> <i>Ofrimit të dijeve të integruara me qëllim që të aftësojnë studentët të ofrojnë shërbime bashkëkohore në fushën e psikologjisë shkollore, si intervistim, vlerësim, dhe</i>

	<i>diagnostikim, hartim i planeve të trajtimit dhe ofrimi i këshillimeve, apo ndërhyrjeve specifike për problematika dhe grupmosha të ndryshme shkollore.</i> d. <i>Zhvillimin e aftësive për të punuar në ekipe multidisiplinare, apo për të bashkëpunuar me profesionistë të tjerë të shëndetit mendor, duke koordinuar dijet dhe ekspertizën në funksion të adresimit profesional dhe efektiv të problemeve të shëndetit mendor.</i> e. <i>Zhvillimin e aftësisë për të kuptuar dhe përdorur rezultatet e kërkimeve shkencore bashkëkohore në fushën e psikologjisë klinike, si dhe për të hartuar dhe udhëhequr studime në fushë.</i>¹²⁵ Institucioni deklaron se është e rëndësishme të vlerësoet angazhimi i njësive bazë për unifikimin e këtij programi me standardet europiane të EuroPsy, për të siguruar një përvojë të pasur dhe të plotë për studentët në lëndët e tyre të specializimit. Urdhri i Psikologut të Shqipërisë ka lançuar linkun e aplikimit për Certifikatën EuroPsy për psikologët të cilët kanë përfunduar sistemin e Kartës së Bolonjës në Masterin e Shkencave në Psikologji Shkollore, FSHS, UT (dhe programe të tjera të FSHS/UT).¹²⁶
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	DPP, përgjegjës për realizimin e programit të studimit, dëshmon se merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit të Mësuesit, sipas akteve ligjore në fuqi. Institucioni informon se ka evidence që vërteton çertifikimin nga Urdhri i Psikologut për unifikimin e programit Master i Shkencave në Psikologji me profil 'Psikologji Shkollore', në përputhje me standardet e EuroPsy. Në këtë kategori përfshihen psikologë të cilët kanë përfunduar studimet në psikologji deri në vitin 2008 (https://www.europsy.al/kriterc-per-aplikim-kategoria.../);¹²⁷
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe	Programi i studimit <i>Master i Shkencave në Psikologji me profil Psikologji Shkollore</i> përputhet me aktet ligjore në vend, si: - Ligji Nr.10 171, datë 22.10.2009 (i ndryshuar me Ligjin Nr.10357, dt. 16.12.2010, me Ligjin Nr.10470, dt. 13.10.2011

¹²⁵ Dokumenti 100/4.1. Korniza konceptuale e programit të studimit.pdf;

¹²⁶ Dokumenti 1/ 3.23. RVB në gjuhën shqipe.pdf;

¹²⁷ <https://www.urdhriipsikologut.al/njoftim-106/>

rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive</i> , 2005/36/EU).	dhe Ligjin Nr.90/2015, dt. 17.07.2014) “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, Nenin 8 të tij që përcakton kriteret për të diplomuarit përpara se të ushtrojnë një profesion të rregulluar, duhet që: a) të kryejnë praktikën profesionale; b) të kryejnë provimin e shtetit; c) të regjistrohen në Urdhrin e Profesionit përkatës. Institucioni sqaron se <i>programi i studimit Master i Shkencave Psikologji Shkollore është në përputhje me aktet ligjore të vendit dhe rekomandimet ndërkombëtare, siç janë Direktivat e Bashkimit Evropian 36/2006 për profesionet e rregulluara... Kjo përshtatje me legjislacionin dhe standardet kombëtare e ndërkombëtare ndihmon në garantimin e standardeve të nevojshme për marrjen e licensës së profesionit dhe për mbrojtjen e interesave të studentëve dhe publikut...Përmbushja e këtyre standardeve kontribuon në garantimin e cilësisë së lartë të arsimit dhe përgatitjen e studentëve për të qënë konkurrues në profesionin që ata zgjedhin.</i>” ¹²⁸			
Konkluzione	Programi i studimit Master i Shkencave në Psikologji me profil Psikologji Shkollore garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.			
Shkalla e përmbushjes sëstandardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënës dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve

¹²⁸ Dokumenti 1/ 3.23. RVB ne gjuhen shqipe.pdf;

Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive, në programin e studimit Master i Shkencave në “Psikologji” me profil në “Psikologji Shkollore” janë: leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni. Në dokumentin “Rregullore e Masterit të Shkencave në Psikologji Shkollore (Regulations Master of Science in School Psychology)”, Neni 17 “Format e mësimi”, pika 17.1, është përshkruar se “Veprimtaria mësimore realizohet nëpërmjet orëve teorike dhe praktike: leksioneve, seminareve, detyrave të kursit, prezantimeve, projekteve të kërkimit, posterave, praktikës”.¹²⁹ Referuar programeve lëndore (syllabuse) të programit të studimit Master i Shkencave në Psikologji me Profil ‘Psikologji Shkollore’, veçanërisht rubrikës “Format e kontrollit të dijeve”, vërehet se përveç testimit/provimit si një formë e vlerësimit të rezultateve të nxënës, theksi vihet në përfshirjen e metodave që sigurojnë aktivizimin dhe pjesëmarrjen e studentëve në diskutime, ushtrime praktike, detyra kursi individuale, esse, punë në grupe, angazhim në punë të pavarura kërkimore, prezantim të detyrave studimore, etj.¹³⁰ Gjatë vizitës në institucion, në takimin me stafin akademik dhe studentët, GVJ mësoi se mësimdhënia organizohet në mënyrë interaktive duke përdorur metoda dhe teknika të ndryshme si: lojë me role, brainstorming, diskutim në grup, raste studimore, vëzhgime në situata praktike, praktika klinike, hartimi raporteve të vlerësimit klinik, refleksione, analiza e çështjeve në artikuj shkencorë, nxitje e mendimit kritik dhe zgjidhjes problemore, prezantime në PowerPoint, etj., duke mbështetur jo vetëm një të kuptuar më të mirë të tematikave që diskutohen në leksione dhe seminare, por edhe duke siguruar lidhjen e nevojshme të teorisë me praktikën. Gjithashtu, një formë tjetër e transmetimit të dijeve
--	---

¹²⁹ Dokumenti 110/5.4. Rregullorja e programit të studimit.pdf; (anglisht)

¹³⁰ Dokumenti 101/doc00121020241218120711.pdf; 102/doc00121120241218120733.pdf; 103/doc00121220241218120746.pdf; 104/doc00121420241218120824.pdf; 114/doc00121320241218120805.pdf; 115/doc00121820241218121000.pdf; 116/doc00121920241218121016.pdf; 117/doc00122020241218121035.pdf; 118/doc00122920241218121451.pdf; 158/doc00123220241218121605.pdf; 159/doc00124920241218122237.pdf; 173/doc00131720241218130806.pdf; 174/doc00133920241218133643.pdf; 175/doc00133620241218133530.pdf; 176/doc00134520241218133907.pdf; 177/doc00135620241218134415.pdf; 180/doc00135020241218134202.pdf; 181/doc00134420241218133829.pdf; 183/doc00133820241218133620.pdf; 185/doc00133320241218133120.pdf; 200/doc00121520241218120854.pdf; 201/doc00121620241218120924.pdf; 202/doc00121720241218120942.pdf; 203/doc00122320241218121215.pdf; 204/doc00122420241218121244.pdf; 206/doc00123420241218121654.pdf;

	është edhe përfshirja e studentëve në projekte kërkimi/mobilitetit, në konferenca kombëtare/ndërkombëtare të organizuara nga FSHS/DPP, si dhe në workshope profesionale, apo orë mësimi të hapura, konsultime tematike dhe veprimtari të tjera të miratuara nga institucioni.
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Referuar dokumentacionit që përfshin CV-në profesionale të personelit akademik të DPP, vërehet se secili prej tyre është i kualifikuar me grada shkencore e tituj akademikë, si dhe ka përvojë të pasur në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.¹³¹ Personeli akademik i DPP dëshmon se është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij. Shumica e stafit akademik ka përfutur ndër vite nga projekte të mobilitetit dhe trajnimet në fushën e mësimdhënies në AL,¹³² duke pasuruar dhe përmirësuar më tej metodat e mësimdhënies në përgjigje të diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar metoda dhe mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies në AL, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, si dhe reagimet e studentëve. Gjatë vizitës në institucion në takimin me stafin akademik dhe studentët, GVJ mësoi se personeli akademik ofron metoda dhe mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi, dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, duke respektuar nevojat, interesin dhe ritmin e studentëve. Gjithashtu, GVJ pati mundësi gjatë vizitës që të bashkëbisedojë edhe me një student me AK që ndiqte studimet në programin e marrë në vlerësim, i cili shpjegoi se institucioni mbështet përpjekjet e tij për të përfutur arsimim të barabartë, si dhe pedagogët lehtësojnë procesin e të nxënës duke përdorur forma dhe metoda të ndryshme të mësimdhënies në përgjigje të studentëve me nevojave të veçanta.
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik	Në dokumentin “Kodi i etikës së UT” (2011), Neni 6 “Përhapja e dijeve dhe liria akademike”, në pikën 3, deklarohej se “Pedagogët

¹³¹ Dokumenti 112/doc00130320241218125836.pdf; 160/DOC0#NHZ.PDF; 161/DOC0#41K.PDF; 162/DOC0#EYN.PDF; 163/DOC0#IAJ.PDF; etj.

¹³² Dokumenti 121/3.20. Të dhëna për mobilitetin e studentëve dhe të pedagogëve.pdf; 123/3.18.1. Raport për veprimtarinë e programit të studimit për vitin akademik.pdf;

në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	<i>duhet të përmirësojnë vazhdimisht metodologjinë në mënyrë që të kenë efektivitet në mësimdhënie, të inkurajojnë studentët për të vepruar në mënyrë të lirë dhe të pavarur, si dhe t'u shpjegojnë atyre metodat e vlerësimit</i>" (fq. 4). ¹³³ Auditorët janë të pajisura me mjete teknologjike të përshtatshme për të realizuar një mësimdhënie bashkëkohore... DPP ka një marrëveshje për përdorimin e programit teknologjik "Clean Score" që realizon me objektivitet dhe shpejtësi vlerësimin e studentëve. ¹³⁴ UT/FSHS ka në funksion një Qendër të Zhvillimit Profesional e cila ofron trajnime pa pagesë për stafin e ri akademik, studentët e masterit dhe doktoraturës, me tematika që kontribuojnë në përmirësimin e kompetencave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, në përgjigje të nevojave dhe interesave të studentëve. Qendra mirëmbahet vullnetarisht nga stafi akademik i FSHS/UT. Në kuadër të projektit Erasmus+, në datat 21-26 Prill, 2024, DPP dhe <i>Qendra për Zhvillimin Profesional</i>, në kooperim me Universitetin Bergen, Norvegji, kanë ofruar një seri aktivitete trajnimi me temë "Metodologjia e kërkimit shkencor dhe etika në kërkim", me pjesëmarrës studentë të ciklit të dytë dhe të tretë të studimeve, si edhe staf i ri akademik. ¹³⁵
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe	FSHS/DPP respekton procedura dhe kritere (të përgjithëshme dhe të veçanta) të parashikuara në dokumentin "<i>Manualin për punësimin e personelit në UT</i>" (2022), për përzgjedhjen e kandidatëve të kualifikuar për t'i angazhuar si staf akademik me kohë të plotë ose të pjesshme në realizimin e programeve të studimit. ¹³⁶ Ky tregues përbën një element të rëndësishëm për të siguruar cilësinë e mësimdhënies në realizimin e veprimtarive mësimore të programit të studimit. Në vitin akademik 2023-2024, Departamenti Pedagogji-Psikologji, përgjegjës për ofrimin e programit të studimit të marrë në vlerësim, rezulton të ketë në përbërje të tij, 13 PAE nga të cilët 3 mbajnë titullin Prof. Dr., 6 Prof.as.Dr., dhe 4 Dr., si dhe 7 PAK, nga të cilët 1 mban titullin Prof.Dr., 1 Dr., dhe 5 MSc. ¹³⁷

¹³³ Dokumenti 186/1.5. kodi-i-etikes 2011.pdf;

¹³⁴ Dokumenti 1/3.23. RVB ne gjuhen shqipe.pdf;

¹³⁵ Dokument shtesë 1/3. Programi i trajnimit 1.pdf;

¹³⁶ Dokumenti 128/1.12. Manuali për punësimin e personelit në UT.pdf;


¹³⁷ Dokumenti 165/4.16. Aneksë tabelë përmbledhëse ASCAL.pdf

ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Personeli akademik me kohë të plotë (PAE) i angazhuar në realizimin e programit të studimit, në vitet akademike 2023-2024 rezulton 100% i kualifikuar me tituj dhe gradë shkencore dhe përmbush kërkesat ligjore në fuqi për nivelin e kualifikimit. Personeli akademik me kohë të pjesshme (PAK) i angazhuar në realizimin e programit të studimit për vitin akademik 2023-2024, rezulton 28.6% i kualifikuar me titull dhe gradë shkencore, dhe 71.4% me nivelin MSc të kualifikimit. Lidhur me kriterin për shkallën e kualifikimit të personelit akademik me kohë të pjesshme të angazhuar për realizimin e programit të studimit Master i Shkencave në Psikologji me Profil ‘Psikologji Shkollorë’, <u>GVJ sjell në vëmendje të institucionit sugjerimin që të respektohet neni 59, pika 6 e tij, e ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.</u> Nga krahasimi i të dhënave të CV-së së PA¹³⁸ dhe syllabuseve të lëndëve¹³⁹, vërehet një përputhje midis fushës akademike dhe kërkimore të titullarit të lëndës/modulit dhe profilit të programit lëndor dhe studimor që PA zhvillon. Refruar programeve lëndore të përgatitura nga titullarët e lëndëve përkatëse, kategoria “<i>Format e kontrollit të dijeve</i>”, vërehet se një pjesë e konsiderueshme e programeve lëndore kanë të përshkruar edhe “<i>Metodologjinë e mësimdhënies</i>”. Sipas specifikës dhe synimeve lëndore, vërehet një larmi metodash, të tilla si: leksion, diskutime, debate, studim rasti, punë në grupe (fq. 39); diskutime të studimeve të ndryshme shkencore në fushë, projekte kërkimore (fq. 53-54); kombinim i leksioneve, diskutime të ndryshme nga konteksti i shkollës, praktikë e drejtëpërdrejtë nëpërmjet role-playing (fq. 58-59); leksion, seminare, ushtrime, fokus grupe,
---	--

¹³⁸ Dokumenti 170/ doc00128620241218123717.pdf; 220/ doc00128120241218123549.pdf; 221/ doc00128020241218123530.pdf; 222/ doc00128420241218123645.pdf; 224/ doc00129020241218123831.pdf; etj.

¹³⁹ Dokumenti 5/2. Sylabuset 2024-2025 I (I).pdf; Dokumenti 101/doc00121020241218120711.pdf; 102/doc00121120241218120733.pdf; 103/doc00121220241218120746.pdf; 104/ doc00121420241218120824.pdf; 114/doc00121320241218120805.pdf; 115/doc00121820241218121000.pdf; 116/doc00121920241218121016.pdf; 117/doc00122020241218121035.pdf; 118/doc00122920241218121451.pdf; 158/doc00123220241218121605.pdf; 159/doc00124920241218122237.pdf; 173/doc00131720241218130806.pdf; 174/doc00133920241218133643.pdf; 175/doc00133620241218133530.pdf; 176/doc00134520241218133907.pdf; 177/doc00135620241218134415.pdf; 180/doc00135020241218134202.pdf; 181/doc00134420241218133829.pdf; 183/doc00133820241218133620.pdf; 185/doc00133320241218133120.pdf; 200/doc00121520241218120854.pdf; 201/doc00121620241218120924.pdf; 202/doc00121720241218120942.pdf; 203/doc00122320241218121215.pdf; 204/doc00122420241218121244.pdf; 206/doc00123420241218121654.pdf; 207/doc00123620241218121737.pdf; 208/doc00123920241218121857.pdf; 213/doc00125420241218122636.pdf; 215/doc00124620241218122200.pdf

54



role-play, diskutime mbi tematika të caktuara (fq. 65-66); inkurajim i studentëve për të zhvilluar një këndvështrim kritik mbi pjesë të zgjedhura të literaturës, prezantime të studimit të rastit, video të ekspertëve të njohur kombëtarisht dhe ndërkombëtarisht (fq. 76); inkurajimi i të nxënit pozitiv, të menduarit kritik, detyra studimore, metoda interaktive, diskutim mbi raste nga konteksti i shkollës, video edukative, përdorim i zhvillimeve teknologjike (fq.84); leksion, seminar, detyra të pavaruara, diskutime, provime të shkurtra, konkurse (fq. 122); studim rasti, shpjegim interaktiv, veprimtari e pavarur dyshe dhe në grup, diskutime, metoda aktive dhe ndërvepruese, reflektive (fq. 160).¹⁴⁰

Tërësia e metodave të përshkruara në programet lëndore të programit të studimit, janë të njohura në literaturën bashkëkohore dhe synojnë të vendosin studentin në qendër, të inkurajojnë sensin e autonomisë së tij në procesin e të nxënit, si dhe të nxisin të menduarit krijues dhe kritik.

Gjatë vizitës në institucion, studentët treguan se gëzonin respekt në institucion, si dhe gjenin mbështetje dhe udhëheqje nga stafi akademik në situata të ndryshme. Ata adresuan komente pozitive për pedagogët e tyre, lidhur me metodat interaktive të përdorura gjatë leksioneve, seminareve dhe veprimtarive të tjera mësimore.

Komente të ngjashme janë analizuar edhe në dokumentin “Raport i anketimit mbi kënaqësinë e studentëve në lidhje me mësimdhënies në FSHS” (2023-2024). Në këtë dokument, mes të tjerash shënohet se “Nga analiza e përgjithëshme, rezultojnë që studentët e shprehur për pedagogët e tyre, kanë nivel të lartë të kënaqësisë prej tyre, sa i përket nivelit të përgatitjes, përkushtimit ndaj studentëve, marrëdhënieve njerëzore, kërkesës së llogarisë, stilit të mësimdhënies, etj. (fq.13).¹⁴¹

Në tërësinë e veprimtarive mësimore, personeli akademik i DPP-së, udhëhiqet nga “Kodi i etikës së UT” (2011), Neni 6 “Përhapja e dijeve dhe liria akademike”, pika 1, që përcakton se “Personeli akademik gëzon liri akademik në kërkimet, në punimet shkencore dhe metodologjinë e mësimdhënies. Pedagogët duhet t’i përmbahen përdorimit të ndërgjegjshëm të lirisë akademike, duke iu nënshtruar një programi mësimor të miratuar. Ata duhet të realizojnë me performance të lartë kërkimin, mësimdhënien dhe

¹⁴⁰ Dokumenti 5/2. Sylabuset 2024-2025 1 (1).pdf;

¹⁴¹ Dokumenti 42/2.17.Raporte periodike NJSBC 2023, 2024.pdf;

	praktikën, nëpërmjet leximit, studimit, eksperimentit, vëzhgimit, shkëmbimit dhe vetëvlerësimit objektiv doke zgjedhur metoda dhe mënyra efikase, të dobishme, të kuptueshme dhe frytdhënëse për studentët” (fq. 4).¹⁴²
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e progamit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Sipas dokumentit “Manuali i vlerësimit të performancës së personelit akademik të UT-së (2021), “(6)...Vlerësimi i personelit akademik në njësitë përbërëse të Universitetit bëhet nga grupe të ndryshëm vlerësuesish...” (fq.9). Në pikën 4 të këtij dokumenti “Për parimet e vlerësimit” specifikohet se “Përgjithësisht vlerësimi bëhet nga disa aktorë, që janë drejtuesi i njësisë bazë, vetë personi (anëtar i personelit akademik), studentët dhe grupi i vlerësimit të njësisë bazë...(fq. 8). Në vijim të dokumentit, në Tabelën nr. 1 janë pasqyruar subjektet që bëjnë vlerësimin e personelit akademik, duke përfshirë vetëvlerësimin dhe vlerësimin nga studentët (fq. 10). Në Aneksin nr. 1, është paraqitur “Formulari i planifikimit të objektivave të performancës, sipas veprimtarive për personelin akademik/drejtues” që materializon procesin e vetëvlerësimit nga ana e personelit akademik. Në fund të vitit akademik, secili pedagog plotëson pasqyrën e realizimit të objektivave të parashikuara, të cilat duhet të jenë të dokumentuara në dosje të veçantë pranë njësisë bazë. Kjo tabelë analizohet nga drejtuesi i njësisë bazë dhe grupi i vlerësimit/përgjegjës i lëndës, të cilën e gjejnë atë korrekte ose jo, dhe firmosin nëse është e saktë (fq.19).¹⁴³ Në Aneksin nr. 3 të Manualit, është pasqyruar “Formati vlerësimit nga studentët” (fq. 29), ku tregohet se UT/FSHS garanton të drejtën e studenëve për t’u përfshirë në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.¹⁴⁴ Tërësia e procedurave të vlerësimit dhe vetëvlerësimit e ndihmojnë personelin akademik të reflektojë mbi objektivat e parashikuar dhe realizimin e tyre, si nga ana sasiore ashtu edhe nga ana cilësore, si dhe të fuqizojë kulturën e cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.

¹⁴² Dokumenti 186/ 1.5. kodi-i-etikes 2011.pdf;

¹⁴³ Dokumenti 188/ 1.13.Manuali i vlerësimit të performancës së personelit akademik i UT-së.pdf;

¹⁴⁴ Dokumenti 188/ 1.13.Manuali i vlerësimit të performancës së personelit akademik i UT-së.pdf;


	<i>Gjatë vizitës në institucion, GVJ mësoi se gjykimi i studentëve merr zë përmes të dhënave e mbledhura nga pyetsori me studentët, fokus-grupet dhe komunikimi me koordinatoren e programit. FSHS/DPP vlerëson dhe përpiqet të adresojë kërkesat dhe sugjerimet e studentëve për të rritur cilësinë e mësimdhënies.</i>
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	Referuar Statutit të UT (2018), Neni 41, Neni 138, Neni 139, Neni 140 dhe Neni 141 të tij, dëshmohej se institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.¹⁴⁵ Gjatë vizitës në institucion dhe takimit me personelin në përbërje të NJSBC-së, GVJ mësoi se kjo strukturë e bazon veprimtarinë e saj në Rregulloren përkatëse. Në dokumentin “Rregullore për Sigurimin e Cilësisë, në UT (2020)”, Neni 5, mes të tjerash shprehet se “(4) Sigurimi i cilësisë ka tri qëllime: kontrollin e cilësisë, vlerësimin e gjendjes së cilësisë dhe propozime për përmirësimin e saj.”¹⁴⁶ Në dokumentin “Raport i anketimit mbi kënaqësinë e studentëve në lidhje me mësimdhënies në FSHS” (2023-2024), janë analizuar të dhënat dhe janë shoqëruar me rekomandime dhe propozime konkrete për përmirësimin e treguesve të mësimdhënies, si: Hartimi i një plani zhvillimi profesional të brendshëm e të jashtëm... Eksplorimi i mundësive për zhvillim profesional të ofruar nëpërmjet bashkëpunimit të Rektoratit të UT me universitete të tjera ndërkombëtare nëpërmjet projekteve Erasmus+, COST action, etj., dhe nxitja e pedagogëve të identifikuar me shume sfida që marrin pjesë në mundësi të tilla. (fq.87-88).¹⁴⁷ Gjatë vizitës në institucion, stafi akademik shpjegoi gjatë takimit me GVJ, se çdo pedagog është përgjegjës për rritjen e tij profesionale, rishikimin e programeve lëndore, përditësimin e literaturës, përmirësimin e metodologjisë së mësimdhënies, eksperimentimin me metoda të reja, cilësinë e kërkimit shkencor, etj.

¹⁴⁵ Dokumenti 5/ 1.2.Statuti 2018.pdf;

¹⁴⁶ Dokumenti 127/1.6. Rregullore per sigurimin e cilesise ne UT.pdf;

¹⁴⁷ Dokumenti 42/2.17.Raporte periodike NJSBC 2023, 2024.pdf;

X2



	UT/FSHS/DPP dëshmon se mbështet eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, si dhe trajnimin e vazhdueshëm të personelit akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja. Shëmbull i mirë në këtë drejtim është shkëmbimi i përvojës akademike përmes organizimit të orëve të hapura dhe zbatimit të projekteve kombëtare dhe ndërkombëtare, ku personeli akademik ka mundësi të ballafaqojë mësimdhënien e tij me atë të kolegëve homologë brenda dhe jashtë vendit. Institucioni informon se aktualisht veprojnë tre projekte ndërkombëtare ku përfshihen pedagogë të FSHS/DPP. 1. Projekti Erasmus+ Universiteti Bergen në Norvegji. 2. Projekti Erasmus+ Universiteti i Romës "La Sapienza". 3. Projekti studimore quasi eksperimental midis tre universiteteve Epoka e Re, GIZ dhe UT/FSHS "Vlerësimi i ndikimit të sportit në zhvillimin e të rinjve dhe orientimin e tyre në tregun e punës".¹⁴⁸			
Konkluzione	FSHS/DPP garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të	Në FSHS, kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët. Regulations Master of Science in School Psychology (anglisht) është një dokument i posaçëm i hartuar nga FSHS/DPP, që në kreun V "Vlerësimi i studentit", Neni 19, përcakton procedurën dhe kriteret e vlerësimit.¹⁴⁹

¹⁴⁸ Dokumenti shtesë 3/5. Liste projektesh për këtë program studimi (racionale) 1 1.pdf;

¹⁴⁹ Dokumenti 110/ 5.4. Rregullorja e programit të studimit.pdf;

posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Rregullore për diplomimin e ciklit të parë, të dytë dhe të tretë të studimeve Master Ekzekutiv, në UT (2022) është një dokument i përgjithshëm që përshkruan standardet dhe rregullat e punimit, udhëheqjes, mbrojtjes dhe vlerësimit të punimit të temës së diplomës për programet që ofron UT.¹⁵⁰ Rregullore për diplomat e ciklit të dytë të studimeve – Master i Shkencave në Psikologji me Profil ‘Psikologji Shkollore’” (2019), është një dokument I posaçëm që përcakton standardet dhe rregullat e punimit, të udhëheqjes, mbrojtjes dhe të vlerësimit të punimit të temës së diplomës për programin e ciklit të dytë Master i Shkencave në Psikologji me Profil ‘Psikologji Shkollore’ në FSHS, UT.¹⁵¹ Paketa e praktikës përfshin formularë me udhëzime dhe procedura të sistemit të vlerësimit të rezultateve të praktikës profesionale për studentët e programit Master i Shkencave në Psikologji me profil në Psikologji Shkollore.¹⁵²
Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Si pjesë e UT, personeli akademik i FSHS zbaton “Kodin e Etikës” (2021), Nenin 6 “Për përhapjen e dijes dhe lirisë akademike”, pika 4 që përcakton se “Çdo pedagog duhet t’u shpjegojë paraprakisht studentëve objektivat e kursit, duke e realizuar këtë nëpërmjet leksioneve, demonstrimit, praktikës e provimit”. Në dokumentin “Regulations Master of Science in School Psychology” (anglisht) Neni 19 “Procedura dhe kriteret e vlerësimit”, përcaktohet se (1), “Format dhe kriteret e vlerësimit të studentit përcaktohen në planin mësimor, në programin e lëndës dhe i bëhen të ditura studentëve”.¹⁵³ Në syllabuset e lëndëve/moduleve që zhvillohen në programin Master i Shkencave në Psikologji me profil në Psikologji Shkollore, në kategorinë “Forma e kontrollit të dijeve”, titullarët e lëndëve kanë përshkruar metodologjinë e testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore të studentëve.¹⁵⁴

¹⁵⁰ Dokumenti 129/ 1.9.Rregullore-për-diplomimin UT.pdf;

¹⁵¹ Dokumenti 106/ 4.5. Paketa e punimit të diplomës për programin e studimit.pdf;

¹⁵² Dokumenti 105/ 4.4.Paketa e praktikës për programin e studimit.pdf;

¹⁵³ Dokumenti 110/ 5.4. Rregullorja e programit të studimit.pdf;

¹⁵⁴ Dokumenti shtesë 5/ 2. Syllabuset 2024-2025 I (1).pdf;

	Çdo pedagog në fillim të lëndës i njeh studentët me përmbajtjen e syllabusit, me informacionin e nevojshëm që përmban syllabusi: emërtimi dhe kreditet e lëndës, pedagogun/pedagogët e lëndës, viti/semestri kur zhvillohet lënda, vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit, ngarkesa në orë në auditor si orë mësimore dhe jashtë tij, njohuritë dhe aftësitë që i jep studentit kjo lëndë, temat që do të trajtojnë lënda në formimin teorik dhe praktik, format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre, detyrimet e studentit për lëndën, format e vlerësimit të studentëve, si dhe literatura e detyruar dhe ajo e rekomanduar. Koordinator i programit, ndër të tjera, ka detyrë të mbajë të përditësuar studentët në lidhje me rregulloren e programit, kërkesat, vendimet e departamentit dhe çdo informacion tjetër të nevojshëm, si dhe të verifikojë çështjet që mund të hasin studentët apo pedagogët në lidhje me vlerësimin dhe mbarëvajtjen e procesit.¹⁵⁵
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Sipas dokumentit “Regulations Master of Science in School Psychology” (anglisht), Neni 19 “Procedura dhe kriteret të vlerësimit”, përcakton se (2) “<i>Vlerësimi në një lëndë mund të bëhet: a) me provim me shkrim; me gojë ose i kombinuar duke u specifikuar më parë në programin e lëndës; b) me detyra kursi, projekte, postera; c) i bazuar në një shumëllojshmëri formash vlerësimi</i>” (fq. 12).¹⁵⁶ Programi i studimit përmbyllet me mbrojtjen e tezës së diplomimit. Referuar programeve lëndore (syllabuset) të cilat zhvillohen në programin e studimit Master i Shkencave në Psikologji me profil në Psikologji Shkollore, kategorisë “<i>Forma e kontrollit të dijeve</i>”, vërehet se i gjithë procesi përfshin <i>kontrollin e vazhdueshëm</i> të njohurive, <i>kontrollin e ndërmjetëm</i> dhe <i>kontrollin përfundimtar</i>, ku studenti vlerësohet bazuar në %, sipas këtyre komponentëve: frekuentimi i lëndës dhe pjesëmarrja aktive, detyra e kursit, testi i pjesshëm dhe provimi përfundimtar.¹⁵⁷ Diversiteti i formave dhe mënyrave të vlerësimit, i japin mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.

¹⁵⁵ Dokumenti 1/ 3.23. RVB ne gjuhen shqipe.pdf;

¹⁵⁶ Dokumenti 110/ 5.4. Rregullorja e programit te studimit.pdf;

¹⁵⁷ Dokumenti shtesë 5/ 2. Syllabuset 2024-2025 1 (1).pdf;

13 70



Konkluzione	UT/FSHS/DPP harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre. Këto dokumente rregullatore janë bërë publike dhe të njohura nga studentët.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të studentit në një lëndë të caktuar, realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar. Në Rregulloren e FSHS, UT (2023), Neni 42 shprehet se “(1) <i>Kontrolli i dijeve shërben për vlerësimin e progresit dhe mat përvetësimin e rezultateve të të nxëniet e të kompetencave profesionale të programit nga studentët. (3/b) Vlerësimi i vazhduar, i cili bazohet në rezultatin që përfshihet nga kontrolli i vazhduar në leksione, seminare, ushtrime, laboratorë, praktika, etj. (b/1) Mjetet që përdoren për ushtrimin e kontrollit të vazhduar janë: testime me shkrim, testime me gojë, bashkëbisedime, kontolle ndërmjetëse, detyra të kursit, punë në grup, projekte, prezantime, esse, raporte, performanca të ndryshme, teza e diplomave, etj.</i>”. Neni 45 i Rregullores përcakton se (1) <i>Vlerësimi përfundimtar përfshin shumatoren e rezultatit të përfutur nga vlerësimi i vazhduar gjatë vitit dhe vlerësimit me provim. Shkalla e përvetësimit të programit të lëndës, vlerësohet me sistemin nga nota pakaluese 4 (katër) deri në notën 10 (dhjetë). Nota kaluese më e ulët është nota 5 (pesë). Në format e kontrollit me shkrim përdoret dhe sistemi i vlerësimit me pikë, rezultati i të cilit detyrimisht kthehet në notë</i>”.¹⁵⁸ Në syllabusin e çdo lënde që zhvillohet në programin Master i Shkencave në Psikologji me profil në Psikologji Shkollore, në kategorinë “<i>Forma e kontrollit të dijeve</i>”, është përcaktuar qartazi se vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive të studentit përfshin

¹⁵⁸ Dokumenti 29/ 2.4.Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale 2023.pdf;

	forma dhe mënyra të ndryshme, me raporte të caktuara, që realizohet gjatë gjithë vitit, si: <i>kontrolli i vazhduar</i> (paraqitja e punimit studimor, frekuentimi dhe aktivizimi, testimi ndërmjetëm në mes të semestrit) dhe <i>provimi/kontrolli përfundimtar</i> (me shkrim/gojë ose i kombinuar).¹⁵⁹ Rezultati përfundimtar reflekton vlerësimet e realizuara gjatë gjithë periudhës së zhvillimit të lëndës, duke u bazuar në një sistem pikëzimi i cili bëhet në mënyrë individuale nga secili pedagog, në varësi të natyrës që ka lënda, dhe duke respektuar një rreze të paracaktuar pikëzimi, sipas të cilës provimi final përlogaritet nga 40% – 50% të vlerësimit total. Rezultati përfundimtar konvertohet në note.¹⁶⁰ Gjatë vizitës në institucion, stafi akademik deklaroi se mënyra vjetore e vlerësimit ka si qëllim të mbajë të angazhuar studentin në procesin e të nxënës, si dhe të mundësojë pedagogun e lëndës që të ndihmojë studentin të përmirësohet hap pas hapi, dhe njëherazi të sigurojë një vlerësim përfundimtar sa më objektiv.
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Institucioni deklaroi në RVB (2024) se “FSHS ka bashkëpunim me AADF për zbatimin e projektit <i>Clean Score</i> ... Nga ky bashkëpunim është zhvilluar dhe përdoret platforma elektronike e <i>Clean Score</i>, e ngritur nga AADF për testime dhe vlerësime të informatizuara të njohurive, të cilat rrisin transparencën dhe objektivitetin në vlerësim.”¹⁶¹ Gjatë vizitës në institucion, stafit akademik vlerësoi avantazhet e përdorimit të platformës elektronike <i>Clean Score</i>, por pa përkufizuar masën e përdorimit të saj për korrigjimin e testeve. Shumica e stafit akademik dhe studentët pohuan se shpesh përdorin platformën elektronike “Microsoft Teams” për të komunikuar dhe ndarë informacion mbi tematika të ndryshme lëndore.
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Në Rregulloren e FSHS (2023), Neni 43 përcakton se “(1) Provimi, është forma kryesore për vlerësimin përfundimtar të njohurive të lëndëve, sipas planit mësimor. Kontrolli i lëndës me provim bëhet: me shkrim, me gojë ose i kombinuar”. Neni 44 “Zhvillimi i provimit”, pika 2 shprehet se “Studentët merren në provim nga një komision i përbërë nga dy pedagogë të lëndës (ose

¹⁵⁹ Dokumenti shtesë 5/ 2. Syllabuset 2024-2025 1 (1).pdf;

¹⁶⁰ Dokumenti shtesë 5/ 2. Syllabuset 2024-2025 1 (1).pdf;

¹⁶¹ Dokumenti 1/ 3.23. RVB ne gjuhen shqipe.pdf;

	<i>njësisë bazë), nga të cilët njëri, duhet të jetë personel akademik me kohë të plotë". (4) "Provimet me shkrim bëhen në fletë të sekretuara. Mënyra e sekretimit përcaktohet në rregulloret e brendshme të njësive kryesore".¹⁶²</i> Gjatë vizitës në institucion, stafi akademik dhe studentët treguan se provimet zhvillohen me procedurë sekretimi. Zhvillimi i provimeve në auditor monitorohet nga pedagogët e lëndës.
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënies për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Nga takimi në institucion me personelin akademik dhe studentët, GVJ mësoi se "Kur është e nevojshme, vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të studentit shoqërohet me komente nga pedagogu përkatës, me qëllim për ta ndihmuar atë që të përmirësohet. Kjo procedurë realizohet në kuadër të konsultave të cilat janë të detyruara për pedagogun dhe realizohen menjëherë pas përfundimit të procesit të vlerësimit dhe shpalljes së rezultateve. Gjithashtu, pedagogu i lëndës, pas provimit dorëzon në departament tezën origjinale dhe çelësin e zgjidhjes së tezës, të cilat mund t'i vihen në dispozicion studentit, nëse dëshiron të qartësohet për përgjigjet dhe vlerësimin e marrë. <i>"Notat duhet të shpallen brenda 5 ditëve nga data e provimit. Notat u komunikohen studentëve në mënyrë individuale duke respektuar të drejtën për konfidencialitet sipas udhëzimeve të Avokatit të Popullit."</i>¹⁶³
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Në Rregulloren e FSHS (2023), Neni 81 "Kuptimi i shkeljeve disiplinore", specifikohet se "Shkelje të rregullave konsiderohen të gjitha veprimet e kryera nga ana e studentit që çënojnë personalitetin e të tjerëve, rregullat dhe normat etiko-morale të shoqërisë si: kopjimi në provime, falsifikimi i dokumenteve të ndryshme ..."¹⁶⁴ Bazuar në dokumentin "Rregullore për diplomat e ciklit të dytë Master i Shkencave" (2019), Neni 12 "Kritere dhe kërkesa mbi etikën e kërkimit", shprehet: (a) Punimi i temës për diplomimin në Master i Shkencave duhet të jetë punë origjinale e kandidatit; (c) ... Kërkohet të shënohet referenca përkatëse nëse përdoren ide të të tjerëve. (d) Udhëheqësit duhet të sqarojnë që në fillim të punës se asnjë lloj mashtrimi, falsifikimi dhe plagjiature nuk do të tolerohet, por për kundrazhi për to ka ndëshkime të ndryshme.

¹⁶² Dokumenti 29/ 2.4.Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale 2023.pdf;

¹⁶³ Dokumenti 1/ 3.23. RVB ne gjuhen shqipe.pdf;

¹⁶⁴ Dokumenti 29/ 2.4.Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale 2023.pdf;

	<i>Pandershmëria akademike e cila përfshin deklarime false, të dhëna të rreme, prezantimi i punës së grupit si punë individuale dhe plagjiatura i duhen shpjeguar studentit</i>".¹⁶⁵ Gjatë vizitës në institucion, GVJ mësoi se: "Për shmangien e plagjiaturës dhe kopjimit në detyrat lëndore të punuara individualisht ose në grup nga studentët, stafi akademik u shpreh se ata bashkëpunojnë ngushtësisht me studentët nga fillimi deri në përfundim të detyrës, monitorojnë, mbështesin dhe vlerësojnë hap pas hapi punën e tyre me qëllim përmirësimi. Gjatë këtij procesi ekziston mundësia për të parandaluar ose evidentur në kohë rastet e këtij fenomeni".
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	FSHS/DPP bazohet në rregulloret përkatëse për të siguruar që rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale të studentëve të bazohen në meritë. Në dokumentin "Regulations Master of Science in School Psychology" (anglisht)), Neni 19 "Procedura dhe kriteret të vlerësimit", përcakton se "(1) Format dhe kriteri i vlerësimit të studentit përcaktohen në planin mësimor, programin e lëndës dhe i bëhen të ditura studentit; (3) Vlerësimi për secilën lëndë mësimore kryhet pas përfundimit të saj; (4) Shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistem prej 10 notash. Notat nga 5 e lartë janë kaluese".¹⁶⁶ Në programin lëndor (syllabusin), në seksionin "Forma e kontrollit të dijeve", është përfshirë një tabelë e detajuar pikëzimi për vlerësimin e studentëve, e ndarë në kategori: shkalla e pikëve, nota numerike, përshkrimi i notës, nota me shkronja sipas ECTS. Zbatimi i një sistemi të detajuar pikëzimi tregon se rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive të studentëve janë të bazuara në meritë. Lidhur me afatet dhe mënyrën e komunikimit të rezultateve të provimit, Rregullorja e UT (2022), Neni 60 "Vlerësimi përfundimtar", pika 3 shprehet se "Komisioni i provimit, në përfundim të provimit me shkrim ose/dhe me gojë, bën shpalljen e rezultateve brenda 10 (dhjetë) ditëve punë, nga data e zhvillimit të provimit..."¹⁶⁷

¹⁶⁵ Dokumenti 106/ 4.5. Paketa e punimit të diplomës për programin e studimit.pdf;

¹⁶⁶ Dokumenti 110/ 5.4. Rregullorja e programit të studimit.pdf;

¹⁶⁷ Dokumenti 6/ 1.3. rregullore-e-universitetit-te-tiranes-2022.pdf;

	Gjithashtu, edhe Rregullorja e FSHS 2023, Neni 45, pika 2 shprehet se “Komisioni i provimit, në përfundim të provimit me shkrim ose/dhe me gojë, bën shpalljen e rezultateve brenda 10 (dhjetë) ditëve punë, nga data e zhvillimit të provimit...”.¹⁶⁸ Dokumenti “Regulations Master of Science in School Psychology” (anglisht), Neni 22 “Komunikimi i vlerësimeve”, pika 1, shprehet se “Vlerësimet duhet të komunikohen nga pedagogu i lëndës brenda 10 ditëve”.¹⁶⁹
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	UT/FSHS garanton bazuar në dokumentet e saj rregullatore, të drejtën e studentëve për t’u njohur me vlerësimin dhe për të kërkuar rishikim/përmirësim të vlerësimit përkatës. Rregullorja e UT (2022), Neni 60 shprehet se “(3) Në përfundim të provimit njoftohet zyrtarisht zgjidhja e tezës, si data e nxjerrjes së rezultateve. Pas shpalljes së rezultateve të vlerësimit, mund të kryhen sqarime, nëse ka pasur kërkesa për sqarim nga studentët. Duhet të respektohen të drejtat e studentëve për rishikim të provimit, marrje të fotokopjes së zgjidhjes që ka bërë (në rast se nuk është i bindur me sqarimet e komisionit) e deri në ngritjen e komisionit të rivlerësimit të provimit në rast ankimi të mëtejshëm, bazuar në këtë rregullore. Brenda 2 (dy) ditëve punë nga data e trajtimit të kërkesave për sqarim, procesverbalet e rezultateve të provimit dorëzohen në sekretarinë mësimore”. Neni 62 i Rregullores së UT specifikon se “(1) Studenti ka të drejtë të ankohet për rezultatin përfundimtar të provimit. Ankesa i paraqitet me shkrim drejtuesit të njësisë bazë, brenda 48 (dyzetë e tetë) orëve nga shpallja e rezultatit të provimit. (2) Drejtuesi i njësisë bazë, brenda 24 orëve, nga data e depozitimit të ankimit, njofton personelin akademik të lëndës, që të bëjnë shqyrtimin e ankimit dhe të japin qëndrimin e tyre. (3) Qëndrimin e mbajtur për ankimin, nga personeli akademik i lëndës, drejtuesi i njësisë bazë brenda 24 orëve ia përcjell drejtuesit të njësisë kryesore. (4) Drejtuesi i njësisë kryesore, brenda 48 orëve nga marrja e informacionit sipas pikes 3, ngre një komision ad hoc, i cili brenda 3 (tre) ditëve punë, bën verifikimin e pretendimeve të studentit dhe përcakton vlerësimin përfundimtar të provimit, nëse ankesa qëndron. (5) Rezultatet e shqyrtimit të ankimit, Komisioni i përcjell tek drejtuesi i njësisë kryesore, i cili brenda 48 orëve,

¹⁶⁸ Dokumenti 29/ 2.4.Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale 2023.pdf;

¹⁶⁹ Dokumenti 110/ 5.4. Rregullorja e programit të studimit.pdf;

	<i>informon drejtuesin e njësisë bazë, personelin akademik të lëndës dhe ankuesin</i>".¹⁷⁰ Në rast se një notë është raportuar gabim, institucioni respekton përcaktimet në dokumentin "Regulations Master of Science in School Psychology" (anglisht), Neni 23 "<i>Dokumentimi i vlerësimeve</i>", pika 4, e cila shprehet se "<i>Një notë e raportuar mund të ndryshojë vetëm nëse rezulton se është bërë një gabim gjatë regjistrimit. Pedagogu duhet të dorëzojë një vërtetim me shkrim ku pranohet gabimi. Ndryshimi pranohet brenda një periudhe kohore prej tre ditësh nga data e dhënies së vlerësimit</i>".¹⁷¹ Megjithatë, Neni 23, i Rregullores së programit të studimit, lë të paqartë se ku drejtohet pedagogu për të dorëzuar vërtetimin me shkrim pasi pranon gabimin, dhe kush e miraton ndryshimin. GVJ vëren se nevojitet të plotësohet Neni 23 i Rregullores së programit të studimit, lidhur me përcaktimet e nevojshme në pikën 4.
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Çdo kërkesë, ankimim i studentit, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm sipas përcaktimeve në "Rregulloren e FSHS (2023), Neni 47 "<i>Ankimi për vlerësimin përfundimtar</i>", ku thuhet se "(1) Studenti ka të drejtë të ankohet për rezultatin përfundimtar të provimit. Ankesa i paraqitet me shkrim drejtuesit të njësisë bazë, brenda 48 (dyzetë e tetë) orëve nga shpallja e rezultatit të provimit. (2) Drejtuesi i njësisë bazë, brenda 24 orëve, nga data e depozitimit të ankimit, njofton personelin akademik të lëndës, që të bëjnë shqyrtimin e ankimit dhe të japin qëndrimin e tyre. (3) Qëndrimin e mbajtur për ankimin, nga personeli akademik i lëndës, drejtuesi i njësisë bazë brenda 24 orëve ia përcjell drejtuesit të njësisë kryesore. (4) Drejtuesi i njësisë kryesore, brenda 48 orëve nga marrja e informacionit sipas pikes 3, ngre një komision ad hoc, i cili brenda 3 (tre) ditëve punë, bën verifikimin e pretendimeve të studentit dhe përcakton vlerësimin përfundimtar të provimit, nëse ankesa qëndron. (5) Rezultatet e shqyrtimit të ankimit, Komisioni i përcjell tek drejtuesi i njësisë kryesore, i cili brenda 48 orëve,

¹⁷⁰ Dokumenti 6/ 1.3. rregullore-e-universitetit-te-tiranes-2022.pdf;

¹⁷¹ Dokumenti 110/ 5.4. Rregullorja e programit te studimit.pdf;

	<i>informon drejtuesin e njësisë bazë, personelin akademik të lëndës dhe ankuesin</i>".¹⁷² Gjatë vizitës në institucion, GVJ u informuar nga studentët se institucioni trajton me seriozitet kërkesat dhe rastet e ankimit të tyre lidhur me rezultatin e vlerësimit apo çështje të tjera që shqetësojnë studentët. Stafi akademik tregoi gjithashtu, se institucioni zbaton përcaktimet sipas Rregulloreve përkatëse lidhur me kërkesat apo ankimet e studentëve. Autoritetet drejtuese të FSHS/DPP dëshmuar se çdo kërkesë, ankim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.			
Konkluzione	FSHS/DPP siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	Programi i studimit Master i Shkencave në Psikologji me profil Psikologji Shkollore zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve. Sipas dokumentit “Korniza konceptuale e programit të studimit Master i Shkencave në Psikologji me Profil ‘Psikologji Shkollore’”, çështja 7 “Njohuritë dhe kompetencat që karakterizojnë profilin”, deklarohet se “Dijet dhe njohuritë e përvetësuara në këtë program studimi janë të orinetuara drejt thellimit të shprehive klinike për të ndihmuar individët, familjet dhe grupet me çrregullime të ndryshme neurologjike apo të personalitetit. Ndërlidhja e ngushtë e dijeve teorike, aftësive kërkimore, studimeve të rastit udhëheqin drejt formimit të profesionistëve të rinj. Ky program studimi i orienton studentët drejt praktikave kërkimore, për të rritur aftësitë përshtatëse në tregun e punës ku roli i kërkuesit shkencor po bëhet gjithnjë e më i domosdoshëm” (fq. 8). “Realizimi i programit të studimit, bazohet

¹⁷² Dokumenti 29/ 2.4.Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale 2023.pdf;

	<i>në planin mësimor të hartuar, i cili ndërthur disiplina të formimit të përgjithshëm me ato të formimit karakterizues (profesional); disiplina të përafërta plotësuese me ato të natyrës praktike. Programi është ndërtuar në mënyrë të atillë që të mundësojë psikologët shkollorë të zhvillojnë aftësidhe shkathtësi specifike, përmes të cilave mund të përballen me një gamë të gjerë çështjesh të lidhura me intervistimin e personave për qëllime vlerësimi, ndërtimi të planeve për shërbim psikologjik në shkollë, vlerësimi i nevojave institucionale, ndërtimi i instrumenteve të vlerësimit dhe monitorimit, ofrimi i këshillimit për grupet shkollore, përbën fokusin kryesor të programit të formimit të psikologut shkollor, si dhe kompetenca të lidhura me rritjen e efikasitetit profesional dhe bashkëveprimin me profesionistë të tjerë në fushën e shëndetit mendor, si edhe aftësi në kërkimin shkencor cilësor dhe sasior” (fq. 4).¹⁷³</i> Programi i studimit synon që studenti të marrë njohuri të thelluara dhe aftësim profesional me qëllim orientimin e tij praktik në fushën e Psikologjisë Shkollore që të jetë konkurrent i denjë në tregun e punës. Nga kjo pikëpamje, përmbajtja e programit të studimit të marrë në vlerësim, dhe mënyra se si ky program zhvillohet/ofrohet nga FSHS/DPP, garanton thellimin e njohurive, zhvillimin e aftësive profesionale të studentëve.
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Në Planin Mësimor (2018-2019) të programi i studimit Master i Shkencave në Psikologji me profil në Psikologji Shkollore nuk ka një lëndë/modul të dedikuar zhvillimit të aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.¹⁷⁴ Institucioni sqaron se: “Teknologjia e informacionit rezulton të jetë një aset në ndihmesë të informacioneve ndihmëse, në funksion të zhvillimit të aftësive të komunikimit digjital”.¹⁷⁵ Gjatë vizitës në institucion, autoritetet drejtuese dhe stafi akademik shpjeguan se: “Programi mundëson studentët të përdorin teknologjinë bashkëkohore dhe të zhvillojnë aftësitë për të komunikuar e ndërvepruar në funksion të arritjes së objektivave mësimore teoriko- praktikë dhe kërkimore shkencore. Studentët janë në kontakt të vazhdueshëm me teknologjinë informatike ndërkohë që realizojnë detyra mësimore, aftësohen për të kryer

¹⁷³ Dokumenti 100/ 4.1. Korniza konceptuale e programit të studimit.pdf;

¹⁷⁴ Dokumenti 99/4.2. Plani mësimor i programit të studimit.pdf

¹⁷⁵ Dokumenti 1/ 3.23. RVB ne gjuhen shqipe.pdf;

	<i>punë praktike, vlerësim, formulim, konceptualizim dhe trajtim të problematikave të ndryshme në grupmosha të ndryshme, si dhe zhvillojnë aftësitë e tyre hulumtuese/ kërkimore në fushën e psikologjisë shkollore”.</i> Referuar programeve lëndore (syllabuset) të programit të studimit Master i Shkencave në Psikologji me profil ‘Psikologji Shkollore’, vërehet se shumica e literaturës bazë të detyrueshme dhe literaturës së rekomanduar është në gjuhë të huaj, kryesisht në gjuhë angleze.¹⁷⁶ Gjithashtu, përfshirja e studentëve në projekte mobiliteti,¹⁷⁷ konferenca ndërkombëtare dhe trajnime me staf akademik të ftuar nga universitete të huaja¹⁷⁸, kontribuojnë për zhvillimin e aftësive të tyre për të komunikuar dhe ndërvepruar në gjuhë të huaj në fushën shkencore që ata studiojnë.
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.	DPP, njësia bazë përgjegjëse për zhvillimin e programit të studimit, realizon në mënyrë periodike analizën e punës. Në fund të semestrit, DPP kërkon nga pedagogu i çdo lënde apo moduli të raportojë në lidhje me arritjen e objektivave të lëndës, si dhe të paraqesë rekomandimet për përmirësim në të ardhmen. Të dhënat e grumbulluara dhe rekomandimet e mundshme përfshihen në raportin e analizës vjetore të DPP.¹⁷⁹ Kjo praktikë vlerësohet nga GJVJ si një tregues pozitiv i angazhimit institucional për të inkurajuar personelin akademik të analizojë, shqyrtojë dhe reflektojë mbi objektivat përkatëse, të rishikojë në mënyrë të vazhdueshme përmbajtjen lëndore dhe metodologjinë e mësimdhënies, si dhe të hartojë programe lëndore që thelbësisht synojnë zhvillimin e kompetencave dhe aftësive të studentëve. Gjatë vizitës në institucion, stafi akademik shpjegoi se “Pedagogu i çdo lëndë në fund të semestrit para provimit përfundimtar realizon seancë konsultimi me studentët për çështjet kryesore të trajtuara gjatë lëndës/modulit dhe orienton studentin për provimin përfundimtar. Gjithashtu, në përfundim të lëndës studentët prezantojnë edhe detyrat e kursit (individuale/ në grup) të cilat trajtojnë çështje teoriko-praktike të rëndësishme dhe orientojnë

¹⁷⁶ Dokumenti shtesë 5/ 2. Syllabuset 2024-2025 I (1).pdf;

¹⁷⁷ Dokumenti shtesë 3/ 5. Liste projektsh per kete program studimi (racionale) I 1.pdf;

¹⁷⁸ Dokumenti shtesë 1/ 3. Programi i trajnimit I.pdf;

¹⁷⁹ Dokumenti 123/ 3.18.1. Raport për veprimtarinë e programit të studimit për vitin akademik.pdf;

	<i>studentët drejt diskutimit për të gjetur mundësi për implementimin e tyre”.</i>
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Stafi akademik që mbulon programin e studimit Master i Shkencave në Psikologji me profil në Psikologji Shkollore, është i kualifikuar dhe i prirur për të realizuar një mësimdhënie mbi bazë kompetencash duke u dhënë mundësi studentëve të zhvillojnë dhe aplikojnë njohuritë e marra në praktikat e tyre profesionale. Kjo prirje gjen pasqyrim në hartimin e programeve lëndore dhe shprehet në mënyrë të veçantë në formulimin e rezultateve të pritëshme të të nxëniet që parashikohen të arrijnë studentët në përfundim të programit lëndor. Gjenden shëmbuj të mirë të formulimit të rezultateve të pritëshme të të nxëniet, ku përdoren folje të matëshme, të tilla si: Në përfundim të programit lëndor, studenti do të jetë në gjendje - të identifikojë, të dallojë, të krahasojë, të diskutojë, të demonstrojë, të përdorë, të shkruajë, të hartojë, të interpretojë, të realizojë, të planifikojë, të analizojë, të argumentojë, të vlerësojë, të aplikojë, etj., duke vënë theksin tek demonstrimi, përdorimi dhe aplikimi i aftësive dhe kompetencave në situata praktike.¹⁸⁰ Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara. Në programet lëndore/syllabuset, në kategorinë “<i>Përmbledhje dhe rezultatet e të nxëniet</i>”, vërehet se shumica e titullarëve të lëndëve kanë projektuar mësimdhënien e tyre dhe të nxëniet e studentëve të bazuar në diskutime, studime rasti, punë në grup, detyra, projekte studimore, etj., duke synuar nxitjen e të nxëniet autonom, mendimit kritik dhe krijues në përvetësimin e dijeve, interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara të lidhura me lëndën.¹⁸¹ Si pjesë e UT, personeli akademik i FSHS zbaton “Kodin e Etikës” (2011), Nenin 6 “<i>Për përhapjen e dijes dhe lirisë akademike</i>”, Pika 2 që përcakton se “<i>Çdo pedagog duhet të njohë dhe respektojë kontributet shkencore të kolegëve dhe studentëve</i>” dhe Pika 3 që shprehet se “<i>Pedagogët duhet të përmirësojnë vazhdimisht metodologjinë në mënyrë që të kenë efektivitet në mësimdhënie, të inkurajojnë studentët për të vepruar në mënyrë të lirë dhe të pavarur, si dhe t’u shpjegojnë atyre metodat e vlerësimit</i>”.¹⁸²

¹⁸⁰ Dokumenti shtesë 5/ 2. Syllabuset 2024-2025 1 (1).pdf;

¹⁸¹ Dokumenti shtesë 5/ 2. Syllabuset 2024-2025 1 (1).pdf;

¹⁸² Dokumenti 186/ 1.5. kodi-i-etikes 2011.pdf;

	Gjatë vizitës në institucion, GVJ mësoi se personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve, jo vetëm përmes inkurajimit të diskutimit të lirë në auditor dhe veprimtarive zhvilluese jashtë programit të studimit, por edhe nëpërmjet mbështetjes me literature dhe udhëzime për realizimin e detyrave me natyrë studimore të cilat punohen individualisht ose në grup. Gjithashtu, personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve. Sipas tabelës përmbledhëse me të dhëna për mobilitetin e studentëve dhe pedagogëve të FSHS/DPP në kuadër të programit ERASMUS+, mësohet se gjatë dy viteve të fundit (2022-2023; 2023-2024) kanë përfutur 2 pedagogë nga programet e mobilitetit dhe 1 student.¹⁸³ Aktualisht, FSHS/DPP është pjesë e projekteve Erasmus+ që mundëson mobilitetin e stafit dhe studentëve të programit të studimit të marrë në vlerësim.¹⁸⁴ Thirrjet për aplikim të stafit dhe studentëve në programe shkëmbimi publikohen herë pas here në faqen zyrtare të UT https://unitir.edu.al/ dhe FSHS https://fshs-ut.edu.al/.
Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Referuar dokumenteve “<i>Format për raportin vjetor për punët e kryera</i>” (2020-2021; 2021-2022), vërehet se stafi akademik ka përfutur dhe është angazhuar në ngjarje të ndryshme shkencore, të cilat janë realizuar në UT/FSHS përgjatë dy viteve akademike, të tilla si: konferenca, simpoziume, workshope, seminare shkencore, leksione të hapura me të ftuar dhe personalitete të larta të vendit dhe të huaj, tavolina të rrumbullakëta, veprimtari promovuese, etj.¹⁸⁵ <i>Personeli akademik i programit të studimit, dëshmon të jetë një urë lidhëse ndërmjet informacioneve më të fundit të shkencës dhe teknologjisë dhe studentëve të programit të studimit. Personeli akademik i integron këto dije në strukturën e programeve lëndore dhe temave mësimore ose i shpërndan këto njohuri nëpërmjet orëve të hapura të zhvilluara edhe jashtë strukturës së programit</i>

¹⁸³ Dokumenti 121/ 3.20. Të dhëna për mobilitetin e studentëve dhe të pedagogëve.pdf;

¹⁸⁴ Dokumenti shtesë 3/5. Liste projektsh për këtë program studimi (racionale) 1 1.pdf;

¹⁸⁵ Dokumenti 123/ 3.18.1. Raport për veprimtarinë e programit të studimit për vitin akademik.pdf; Dokumenti 124/ 3.18. Raport për veprimtarinë e programit të studimit për vitin akademik.pdf;

	të studimit, duke qenë të angazhuar vetë si lektorë ose duke ftuar kolegë vends dhe të huaj ekspertë në fusha të ndryshme që lidhen me programin e studimit”.¹⁸⁶ Në dokumentin “Program i trajnimit: Metodologjia e kërkimit shkencor dhe etika në kërkim” është një shëmbull i përfshirjes së studentëve dhe pedagogëve në programe trajnimi të përbashkëta, të realizuara jashtë strukture së programit studimor, por në kuadër projekti Erasmus+ me lektorë të ftuar nga universitete partnere jashtë vendit.¹⁸⁷
Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	Në dokumentin “Strategjia e zhvillimit të programit të studimit Master i Shkencave në Psikologji me profil “Psikologji Shkollore”, Prioriteti strategjik 3 “Për kërkimin shkencor”, mes të tjerash theksohet se “Kërkimi shkencor është një nga format kryesore të veprimtarisë së DPP dhe që nxitet të zhvillohet për t’u vendosur edhe në dispozicion të programit të studimit të ciklit të dytë “Master i Shkencave” ... Vetë studentët nxiten të zhvillojnë praktika të kërkimit shkencor duke zbatuar kriteret akademike dhe duke konsoliduar aftësitë në hulumtim. Ndër objektivat kryesore në këtë drejtim, DPP ka vendosur: (1) Të realizohen projekte shkencore në njësinë bazë me pjesëmarrje të studentëve; (2) Të përfshihen në aplikime dhe realizime të projekteve kërkimore në nivel FSHS/UT edhe student; (4) Të nxiten aktivitetet kërkimore dhe debatet shkencore të vetë studentëve; (5) Promovimi i modeleve të hulumtuesve të rinj nëpërmjet pjesëmarrjes së përbashkët me pedagogët në konferenca pse në realizimin e botimeve në revista shkencore; (6) Nxitja e studentëve ekselentë të botojnë gjetjet e punimeve të mikrotezave në përmbyllje të ciklit të studimeve”.¹⁸⁸ Gjatë vizitës në institucion, GVJ mësoi se FSHS/DPP mbështet zhvillimin e ideve inovative dhe nismat studentore. Fakulteti dhe departamenti inkurajon përfshirjen e studentëve në projekte studimore apo botime të artikujve dhe punëve shkencore në bashkëpunim me pedagogët e tyre. Zakonisht, institucioni mbështet bashkëpunimin me studentën në kuadër të konferencave dhe ngjarjeve të tjera shkencore në nivel kombëtar/ndërkombëtar,

¹⁸⁶ Dokumenti 1/ 3.23. RVB ne gjuhen shqipe.pdf;

¹⁸⁷ Dokumenti 1/3. Programi i trajnimit 1.pdf;

¹⁸⁸ Dokumenti 139/ 3.5. Strategjia e zhvillimit të programit të studimit.pdf;

	organizuar nga FSHS, duke mirëpritur pjesëmarrjen dhe prezantimet e ideve të tyre në bashkëpunim me pedagogët.			
Konkluzione	<i>Programi i studimit Master i Shkencave në Psikologji me profil Psikologji Shkollore, ka përcaktuar qartë objektivat formues dhe synon zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët nëpërmjet tërësisë së përmbajtjeve lëndore në fushën e psikologjisë shkollore, si dhe përfshirjes së metodave interaktive të mësimdhënies, të tilla si: punë në grupe, diskutime, interpretime, analiza, reflektim, zbatim idesh, etj., të cilat mundësojnë studentët të zhvillojnë njohuritë dhe shprehjet e nevojshme profesionale në situata praktike.</i> <i>Gjithashtu, programi i studimit Master i Shkencave në Psikologji me profil Psikologji Shkollore garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët nëpërmjet përfshirjes së tyre në detyra kursi me natyrë teoriko-praktike, punë studimore në kuadër të mbrojtjes së tezës së diplomimit, ose projekte shkencore dhe konferenca në nivel kombëtar/ndërkombëtar në bashkëpunim me pedagogët e tyre.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	Institucioni ka hartuar dhe publikuar rregullore të posaçme për programin e studimit të marrë në vlerësim, dhe ndjek procedura të qarta për detyrimet përmbyllëse para realizimit të tyre dhe i bën publike. Dokumenti “Rregullore e UT”,¹⁸⁹ neni 67, neni 68 dhe neni 69 përshkruan procedurat e posaçme për detyrimet përmbyllëse. Programi i studimi Master i Shkencave në Psikologji, me profil “Psikologji Shkollore” përmbyllet me mbrojtjen e temës së diplomës para komisionit të posaçëm që ngrihet nga departamenti për këtë qëllim.

¹⁸⁹ Dokumenti 6/ 1.3. rregullore-e-universitetit-te-tiranes-2022.pdf;

	FSHS/DPP ka hartuar procedura të posaçme për mbrojtjen e diplomës të cilat bëhen publike për studentët para diplomimit. Kriteret për fitimin e diplomës dhe procedurat e diplomimit janë përcaktuar në dokumente rregullatore të veprimtarisë së institucionit, si: Rregullore e FSHS (2019)¹⁹⁰, neni 52, neni 53 dhe neni 54; Rregullore e Programit të Studimit Master i Shkencave në Psikologji me Profil ‘Psikologji Shkollore’ (anglisht),¹⁹¹ neni 24 dhe neni 25. Rregullorja për diplomat e ciklit të dytë Master i Shkencave (2019)¹⁹² është një dokument rregullator i posaçëm që përcakton standardet dhe rregullat e punimit, të udhëheqjes, mbrojtjes dhe vlerësimit të punimit të temës së diplomës për programin e ciklit të dytë Master i Shkencave në Psikologji me profil Psikologji Shkollore. Të gjitha këto dokumente janë publike dhe të aksesueshme për të gjithë studentët në faqen zyrtare institucionit.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.	FSHS/DPP, përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit të marrë në vlerësim, dhe personeli akademik që mbulon këtë program, asistojnë studentët tyre, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës. FSHS ka publikuar <i>Rregulloren për diplomat e ciklit të dytë Master i Shkencave (2019)</i> që përbën një dokument rregullator të posaçëm i cili përcakton standardet dhe rregullat e punimit, të udhëheqjes, mbrojtjes dhe vlerësimit të punimit të temës së diplomës për programin e ciklit të dytë Master i Shkencave në “Psikologji” me profil “Psikologji Shkollore”. Në nenin 2 /a të kësaj Rregullore, përkthehet se “Në fillim të vitit akademik studentët e vitit të dytë Master i Shkencave njihen nga drejtuesi i DPP ose koordinatori i programit të studimit me rregulloren e punimit të diplomës. Studentët ftohen të projektojnë fushën e tyre të interesit për punimin e diplomës në vijim të semestrit të parë. Në muajin dhjetor-janar studentëve të vitit të dytë ju kërkohet të plotësojnë formularin e kërkesës për temën dhe udhëheqësin, që ata propozojnë”.¹⁹³

¹⁹⁰ Dokumenti 29/ 2.4. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale 2023.pdf;

¹⁹¹ Dokumenti 110/ 5.4. Rregullorja e programit të studimit.pdf;

¹⁹² Dokumenti 106/ 4.5. Paketa e punimit të diplomës për programin e studimit.pdf;

¹⁹³ Dokumenti 106/ 4.5. Paketa e punimit të diplomës për programin e studimit.pdf;

	<i>"Koordinatori i programit është përgjegjës për të monitoruar ecurinë e ndërvëprimit të studentëve me pedagogët udhëheqës përkatës, si dhe sigurimin që studentët disponojnë të gjithë informacionin dhe dokumentacionin ndihmues përkatës".¹⁹⁴</i>
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Ky kriter nuk është i aplikueshëm për programin e studimit Master i Shkencave në Psikologji me profil Psikologji Shkollore sepse programi përmbyllet me punim diplome.
Kriteri 4. Personeli akademik/Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Sipas Rregullores për diplomat e ciklit të dytë Master i Shkencave në Psikologji me profil Psikologji Shkollore (2019), Neni 5 "Udhëheqja shkencore", specifikon se "Çdo student/e ka të drejtë të ketë një udhëheqës shkencor. Udhëheqësi/ja, që të drejtojë punën gjatë realizimit të temës së diplomës duhet të ketë të paktën gradën shkencore ose në raste të veçanta të jetë në proces dhe të ketë përvojë mësimdhënëse ose studimore në fushën në të cilën do të kryhet punimi i diplomës. Neni 6 i kësaj Rregullore, përcakton "Përgjegjësitë dhe të drejtat e udhëheqësit", ku midis të tjerash, përcakton se udhëheqësi duhet: (c) Të japë mbështetjen e duhur akademike dhe konsulencën e nevojshme që t'i mundësojë studentit /studentes të arrijë standarde të larta të hulumtimit. Kjo përfshin ndihmën në formulimin e titullit të punimit, rekomandimin e metodologjisë së studimit, rekomandimin e literaturës dhe të burimeve të tjera të informacionit, konsulencën për organizimin e shënimeve dhe përgatitjen e punimit. (d) Të vetëdijësojë studentin/studenten për rrezikun e falsifikimeve dhe të plagjiaturës. (e) Të mbajë takime të rregullta me studentin/studenten mbi ecurinë e punimit. (f) Të vlerësojë progresin e studentit/studentes rregullisht dhe të monitorojë punën e tij përkundrejt standardit të kërkuar. Të vetëdijësojë studentin/studenten nëse puna e tij është nën standardin e kërkuar dhe të ndërmarrë veprimet e duhura mbështetëse. (g) të kontrollojë dhe të garantojë se studenti/studentja i ka plotësuar të gjitha vërejtjet dhe rekomandimet e reflektuara gjatë procesit të konsultimeve." ¹⁹⁵

¹⁹⁴ Dokumenti 1/ 3.23. RVB ne gjuhen shqipe.pdf;

¹⁹⁵ Dokumenti 106/ 4.5. Paketa e punimit të diplomës për programin e studimit.pdf;

	Bazuar në përcaktimet e mësipërme, dëshmohej se personeli akademik/ udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në formulimin e temës së punimit të diplomës. Udhëheqësi e asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuara. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit. <i>Në përfundim, udhëheqësi duhet të japë dakortësinë e tij për temën dhe firmos temën e diplomës që studenti do të mbrojë para komisionit në department, gjë që garanton korrektesën akademike dhe cilësinë e saj</i>.¹⁹⁶
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Gjatë vizitës në institucion , GVJ mësoi se FSHS/DPP asiston studentët brenda dhe jashtë institucionit për kryerjen e punimeve të tyre studimore. FSHS si pjesë e UT, ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucione arsimore publike, qendra të shërbimit psiko-sociale, agjensi e biznese private, organizata të ndryshme joqeveritare, të cilat krijojnë mundësi jo vetëm për realizimin e praktikave profesionale, por edhe për realizimin e punimeve studimore nga ana e studentëve. FSHS/DPP asiston studentët brenda institucionit për kryerjen e punimeve studimore, duke ofruar seanca metodologjike, konsulta me pedagogët udhëheqës, akses në bibliotekat online, sallë leximi dhe kompjuter në bibliotekë, mjedis të mbuluar me WiFi.
Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Në Rregulloren për diplomat e ciklit të dytë të studimeve Master i Shkencave në Psikologji me profil 'Psikologji Shkollore' (2019), Neni 8 "Për komisionin e vlerësimit të punimit të diplomës", përcaktohet se: (a) Komisioni i vlerësimit përbëhet nga jo më pak se tre anëtarë. (b) Përbërja e komisionit të vlerësimit dhe kryetari i tij caktohet nga Përgjegjësi i Departamentit dhe i përcillet Dekanit të FSHS për miratim... (e) Komisioni në përfundim të prezantimeve nga secili student, bën vlerësimin e punës së tyre me notë. Notat rregjistrohen në procesverbalin përkatës të firmosura nga anëtarët e komisionit dhe u komunikohet studentëve. (f) Nota përfundimtare si rregull përcaktohet me pëlqimin e të gjithë anëtarëve të Komisionit dhe në rast mosmarrëveshje, nota përfundimtare caktohet nga Kryetari i Komisionit. Neni 11 i kësaj Rregullore "Për kushtet dhe praktikën për mbrojtjen e punimit të diplomës", specifikon si vijon: (d) Data

¹⁹⁶ Dokumenti 1/ 3.23. RVB ne gjuhen shqipe.pdf;

	e mbrojtjes bëhet publike në mjediset e FSHS rreth një muaj para. (e) Mbrojtja fillon me prezantimin e Komisionit të vlerësimit nga Kryetari, më pas studenti bën prezantimin e temës brenda një kohe 15-20 minuta. Anëtarët e komisionit mund t'i bëjnë pyetje të ndryshme në lidhje me temën për një kohë jo më të gjatë se 10 minuta. (g) Vlerësimin me note udhëheqësi e paraqet në komision në mungesë të studentëve gjatë kohës së mbledhjes së komisionit për vlerësimin përfundimtar.”¹⁹⁷ “Rezultati përfundimtar që pasqyrohet në procesverbal, bëhet public në fund të çdo séance të mbrojtjes së diplomave, dhe iu komunikohet studentëve.”¹⁹⁸
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Në përfundim të studimeve të ciklit të ciklit të dytë Master i Shkencave në Psikologji me profil Psikologji Shkollore, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Kjo procedure është e përcaktuar në Rregulloren e FSHS (2023), Neni 55 “Lëshimi dhe tërheqja e diplomës/certifikatës”, i cili shprehet se “(1) Universiteti i Tiranës pajis studentët, që kanë përfunduar të gjitha detyrimet e një programi studimi me diplomën ose certifikatën përkatëse, e cila është një dokument zyrtar. (2) Elementët përbërës të diplomës/certifikates, forma dhe procedurat për regjistrimin e saj, përcaktohen nga ministria përgjegjëse për arsimin. Neni 56 “Për Suplementin e Diplomës”, përcakton se (1) Diplomat për programet e studimit të ciklit të parë, të dytë, për programet e integruara, si edhe për ato “Master ekzekutiv” të ciklit të tretë, shoqërohen me Suplementin e Diplomës, i cili hartohet, sipas përcaktimeve në aktet nënligjore të ministries përgjegjëse për arsimin. (2) Për studentët e FSHS, që gjatë viteve të tyre të arsimimit, kanë qënë pjesë e skemave të mobilitetit me të cilat UT-ja ka patur marrëveshje, pas kthimit nga mobiliteti, rezultatet e lëndëve për të cilat nuk bëhet konvertimi, do të pasqyrohen në Suplementin e Diplomës.”¹⁹⁹ UT/FSHS/DPP shprehet në RVB (2024) se “Për studentët që kanë përfunduar studimet me të gjitha notat dhjeta, jepet Çertifikata “Medalje e Artë” dhe për studentët që gjatë studimeve, kanë

¹⁹⁷ Dokumenti 106/ 4.5. Paketa e punimit të diplomës për programin e studimit.pdf;

¹⁹⁸ Dokumenti 1/ 3.23. RVB ne gjuhen shqipe.pdf;

¹⁹⁹ Dokumenti 29/ 2.4.Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale 2023.pdf;

	<i>marrë mbi 80% të notave 10 (dhjeta) dhe pjesën tjetër vetëm 9 (nënta), jepet Çertifikata "Student i Shkëlqyer".</i>²⁰⁰ Përmbushja e kriterit 7, dëshmohet edhe nga dokumentt që institucioni ka depozituar në e-ASCAL për modelin e Diplomës të miratuar nga ministria përgjegjëse për arsimin.²⁰¹ Por nuk është depozituar dokumenti për modelin e Suplementit të Diplomës të programit të studimit Master i Shkencave në Psikologji me Profil 'Psikologji Shkollore'. Gjatë vizitës në institucion GVJ mësoi se <i>"Kopja zyrtare e programit të studimit, përfshin syllabuset e këtij programi. Ajo vihet në dispozicion të studentëve në varësi të kërkesës së bërë dhe për interesa të studimit. Gjithashtu, Sekretaria Mësimore harton dhe pajis studentin me Suplementin e Diplomës, ku pasqyrohen të detajuara të dhënat mbi kualifikimin e arritur (në gjuhët shqip dhe anglisht)".</i>
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	UT/FSHS ruan për një periudhë të pacaktuar/pa afat kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen. Nga takimi me personelin në Sekretarinë Mësimore, GVJ mësoi se FSHS disponon një databazë të plotë të të dhënave të studentëve, dhe përpunon të dhëna statistikore sipas kërkesave të Ministrisë përgjegjëse për Arsimin, Agjencisë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë, apo nevojave të vetë institucionit. Këto të dhëna administrohen në përputhje me Rregulloren për mbrojtjen, përpunimit, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në UT (2015).²⁰² Pas përfundimit të studimeve nga studenti, kopje e dokumentacionit të tij të regjistrimit arkivohet dhe ruhet për një periudhë pa afat. Në përmbushje të detyrimeve institucionale, informacioni mbi studentët paraqitet rast pas rasti, dhe jepet për palët e interesuara apo institucionet përkatëse në përputhje me parashikimet ligjore dhe përcaktimet në aktet e brendshme rregullatore".²⁰³

²⁰⁰ Dokumenti 1/ 3.23. RVB ne gjuhen shqipe.pdf;

²⁰¹ Dokumenti 150/ 3.8.1. Modeli i diplomës.pdf;

²⁰² Dokumenti 14/ 1.8. Rregullore UT për "Mbrojtjen, Përpunimin, ruajtjen dhe sigurimin e të dhënave personale.pdf;

²⁰³ Dokumenti 1/ 3.23. RVB ne gjuhen shqipe.pdf;

Konkluzione	GVJ konkludon se Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit Master i Shkencave në Psikologji me profil 'Psikologji Shkollore', dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.			
Shkalla e përmbushjes sëstandardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6 Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	FSHS/DPP në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të njohurive, garanton mjedise brenda institucionit, të përshtatshme për realizimin e leksioneve, seminareve, praktikë lëndore/profesionale, aktivitete promovuese, etj. Sallat dhe klasat janë të pajisuara me mjete audiovizive dhe teknologjike për të zhvilluar aktivitete dhe orë laboratorike në përputhje me kërkesat e kurseve në përbërje të programit.²⁰⁴ Gjatë vizitës në institucion, GVJ pati mundësi të vëzhgoonte nga afër disa nga klasat dhe sallat ku studentët e programit të studimit të marrë në vlerësim, zhvillojnë leksione, seminare, mësim praktikë. Ndërsa, për realizimin e praktikës profesionale, institucioni ka siguruar marrëveshje bashkëpunimi me institucione arsimore publike dhe private, organizata dhe shoqata jofitimprurëse, ku përcakton detyra, përgjegjësi dhe të drejta respektive për mbarëvajtjen e praktikave profesionale.²⁰⁵
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim	UT/FSHS/DPP, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave profesionale me qëllim përfutimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale të studentëve të programit të studimit “Master i Shkencave” në “Psikologji, me profil “Psikologji Shkollore”.

²⁰⁴ Dokumenti 54/ 2.28.Të dhëna për infrastrukturën, Tabela 16.pdf;

²⁰⁵ Dokumenti 144/ 3.17. Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe e partnerëve për praktikën profesionale.pdf;

përfitimim më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	Sipas Rregullores së FSHS (2023), Neni 51, shprehet se: (3) Çdo njësi përgjegjëse për programin, në bashkëpunim me titullarin e lëndëve përkatëse organizon zhvillimin e praktikës mësimore/profesionale, duke mbajtur në konsideratë përzgjedhjen dhe sigurimin e institucioneve / subjekteve ku do të zhvillohet praktika, nënshkrimin e marrëveshjeve përkatëse me secilin prej tyre, caktimin e personave të kontaktit nga institucioni pritës, etj. Për sigurimin e marrëveshjeve të qëndrueshme dhe afatgjata me institucionet/ subjektet, japin kontributin e tyre edhe strukturat përkatëse të Dekanatit. (4) Praktikrat mësimore/profesionale kryhen në grupe mësimore, sipas përcaktimeve në aktet nënligjore në fuqi dhe kërkesave në këtë Rregullore. (7) Ndjekja e praktikës mësimore/profesionale nga studenti është e detyruar në masën 100%. Studenti që nuk realizon programin e praktikës mësimore/profesionale, i nënshtrohet rregullave të vendosura si për të gjitha detyrimet e tjera, të përcaktuara në këtë Rregullore, ose në rregulloret e brendshme të njësisë kryesore.”²⁰⁶ Zhvillimi i praktikës profesionale bazohet në aktmarrëveshjet ndërinstitutionale ku parashikohen detyrimet dhe të drejtat e secilës palë.²⁰⁷
Kriteri 3. Praktikrat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Referuar Planit Mësimor, vërehet se praktika profesionale është vlerësuar me 10 kredite/ 225 orë.²⁰⁸ Sipas Rregullores së FSHS (2023), Neni 51, shprehet se: (8) Në përfundim të praktikës mësimore/profesionale, studenti përgatit një relacion për punën e kryer, e cila vlerësohet nga personeli akademik që drejton praktikën, pasi merr edhe mendimin e punonjësit të caktuar përgjegjës, në institucionin ku ajo është kryer. Vlerësimi bëhet sipas kërkesave të planit mësimor. Për praktikrat mësimore/profesionale, në përbërje të programve të lëndëve të caktuara, kjo notë përfshihet në vlerësimin përfundimtar të lëndës përkatëse. (10) Praktikrat mësimore/profesionale vlerësohen me “kalon/nuk kalon” ose me notë...”²⁰⁹
Konkluzione	Në rastin e programit të studimit në Master i Shkencave në Psikologji me profil ‘Psikologji Shkollorë’, GVJ konkludon se

²⁰⁶ Dokumenti 29/ 2.4.Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale 2023.pdf;

²⁰⁷ Dokumenti 229/doc00115820241218114644.pdf; Etj

²⁰⁸ Dokumenti 99/4.2. Plani mësimor i programit të studimit.pdf;

²⁰⁹ Dokumenti 29/ 2.4.Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale 2023.pdf;

12 90

	<i>institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet ushtrimeve, laboratoreve dhe praktikës mësimore / profesionale.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka	Personeli akademik efektiv dhe me kontratë i angazhuar në programin e studimit Master i Shkencave në “Psikologji” me profil në “Psikologji Shkollorë” përmbush kërkesat ligjore në lidhje me kualifikimin akademik ²¹⁰ . Për vitin akademik 2023-2024 në këtë program studimi janë angazhuar: 3 Profesorë, 7 Profesorë të Asociuar, dhe 4 Doktorë Shkencash. GVJ konstaton përputhshmëri mes fushave kërkimore të profesorëve dhe lëndëve përkatëse që ata mbulojnë në programin e studimit Master i Shkencave në “Psikologji” me profil ‘Psikologji Shkollorë’ ²¹¹ .

²¹⁰ Evidenca 4.15: CV e personelit akademik

²¹¹ Evidenca shitesë 6.1: Ngarkesa mësimore 2024-2025

fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	Personeli akademik efektiv në përputhje me kornizën ligjore në fuqi mbulon rreth 90% të ngarkesës mësimore për vitet akademike 2023-2024 dhe 2024-2025, ndërkohë që personeli akademik me kontratë mbulon rreth 10% të ngarkesës ^{212, 213} .
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	Nga shqyrtimi i ngarkesës mësimore ndër vite, GVJ konstatoi qëndrueshmëri të personelit akademik të angazhuar në programin e studimit ²¹⁴ . Gjithashtu gjatë takimit me stafin akademik ata konfirmuan të qenit titullarë të të njëjtës lëndë për vite me radhë. Institucioni dëshmon korrektësi në procedurat e angazhimit të personelit akademik cka u konstatua gjatë shqyrtimit të dosjeve të personelit, specifikisht kontratave të punësimit si për personelin efektiv dhe atë me kontratë. ^{215, 216}
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriterë të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Gjatë vizitës në institucion, dhe takimit me pedagogët dhe Zyrën e Burimeve Njerëzore u konstatua se institucioni ka politika të qarta përsa i takon rekrutimit të stafit, përfshi publikimin e thirrjes duke përdorur kriterë të përgjithshme si edhe specifike. ²¹⁷ Gjithashtu kandidatët vlerësohen me dosje nga Komisioni i vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit akademik i cili ngrihet nga Dekani përkatës ²¹⁸ .
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e	Ky program nuk përmban orë laboratorike.

²¹² Evidenca shtesë 6.1: Ngarkesa mësimore 2024-2025

²¹³ Evidenca 4.16: Aneks tabela

²¹⁴ Evidenca 4.16: Aneks tabela

²¹⁵ Evidenca shtesë 6.1: Ngarkesa mësimore 2024-2025

²¹⁶ Evidenca: Shënime gjatë vizitës

²¹⁷ Evidenca 2.18. Informacion për politikën e burimeve njerëzore dhe vlerësimin e personelit.

²¹⁸ Evidenca 2.21. Udhëzim për dosjen e pedagogut.

personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	Institucioni ruan dhe përditëson të dhënat e personelit akademik dhe administrative ndër vite. ²¹⁹ Zyra e Burimeve Njerëzore administron të dhënat për stafin akademik efektiv dhe me kontratë, si dhe stafin administrative. ²²⁰ Gjatë vizitës në institucion, u konstatua se dosjet e stafit janë të plota dhe përmbajnë informacion të saktë ndër vite.
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të	Praktika profesionale dhe Punimi i diplomës mbikqyren nga personel akademik efektiv pranë Departamentit të Pedagogjisë dhe Psikologji. ²²¹ Departamenti disponon një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me palë të treta në funksion të programit të studimit, ²²² të cilat vijnë në ndihmë në realizimin e praktikave profesionale, sikundër u konfirmua gjatë takimeve me studentët e këtij programi. ²²³

²¹⁹ Evidenca 1.12. Manuali për punësimin e personelit në UT.

²²⁰ Evidenca 2.18. Informacion për politikën e burimeve njerëzore dhe vlerësimin e personelit.

²²¹ Evidenca 3.17. Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe e partnerëve për praktikën profesionale

²²² Evidenca 4.5. Paketa e punimit të diplomës për programin e studimit.

²²³ Evidenca: Shënime gjatë vizitës

tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.				
Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Praktikat profesionale realizohen në bashkëpunim me institucionet përkatëse në bazë të marrëveshjeve të bashkëpunimit. Këto institucione mbështesin studentët gjatë procesit si dhe marrin pjesë në vlerësimin e tyre përfundimtar ²²⁴ . Procedura e zhvillimit të praktikës profesionale është e specifikuar në rregullore dhe gjatë vizitës në insitucion u konstatua se studentët ishin në dijeni të modalitetit të zhvillimit dhe formave të vlerësimit. ²²⁵			
Konkluzione	<i>Personeli akademik efektiv dhe me kontratë i angazhuar në programin e studimit Master i Shkencave në Psikologji me Profil 'Psikologji Shkollore' përbush kërkesat ligjore në lidhje me kualifikimin akademik. Institucioni ka procedura të qarta për përzgjedhjen e personelit akademik dhe administrativ</i>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të	Infrastruktura e vënë në dispozicion për zhvillimin e programit të studimit plotëson të gjitha standardet përsa i takon hapësirës, sistemit ngrohje/ftohje, ndricimit si dhe pajisjes me teknologjinë e nevojshme (kompjuter, videoprojektor) ²²⁶ . Sipas të dhënave të vëna në dispozicion nga institucioni, sipërfaqja është 3577m ² , me nje mesatare 1.33m ² /student ²²⁷ .

²²⁴ Evidenca 4.4. Paketa e praktikës për programin e studimit.

²²⁵ Evidenca: Shënime gjatë vizitës

²²⁶ Evidenca 4.13. Te dhenat per infrastrukturen ne funksion te programit te studimit.

²²⁷ Evidenca 2.28. Të dhëna për infrastrukturën, Tabela 16.

studimit dhe moduleve përkatëse.	
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Mjediset mësimore të Fakultetit të Shkencave Sociale janë moderne dhe të pajisura me mjete të teknologjisë së informacionit në funksion të procesit të mësimdhënies ²²⁸ . Auditoret ku zhvillohen leksionet dhe seminarët janë të pajisura me videoprojektorë, dhe biblioteka disponon kompjutera për përdorim nga studentët sipas nevojave ²²⁹ .
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Programi përkatës Master i Shkencave në “Psikologji” me profil “Psikologji Shkollore” nuk kërkon përdorimin e ambjenteve specifike si laboratorë apo atelie. Gjithsesi infrastruktura e Fakultetit është në dispozicion të studentëve përmes hapësirave si biblioteka etj.
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Programi përkatës Master i Shkencave në “Psikologji” me profil “Psikologji Shkollore” nuk kërkon përdorimin e programeve profesionale të teknologjisë së informacionit. Ky kriter nuk aplikohet për programin në fjalë.
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të	Nga vizita në institucion por edhe shqyrtimi i dokumentacionit mbështetës, GVJ konkludon se mjediset e ofruara nga institucioni janë të përshtatshme për zhvillimin e procesit mësimor ²³⁰ . Praktika profesionale realizohet pranë institucioneve me të cilat UT ka

²²⁸ Evidenca 4.13. Te dhenat per infrastrukturen ne funksion te programit te studimit.

²²⁹ Evidenca: Shënime gjatë vizitës

²³⁰ Evidenca: Shënime gjatë vizitës

posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorie me kapacitetet e nevojshme.	marrëveshje bashkëpunimi në përputhje me udhëzimet përkatëse për zhvillimin e praktikave profesionale ²³¹ .			
Konkluzione	<i>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion një infrastrukturë cilësore me mjedise mësimore të përshtatshme për realizimin e procesit mësimor për programin e studimit Master i Shkencave në Psikologji me Profil 'Psikologji Shkollore'.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3	
Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Gjatë vizitës në institucion, vëzhgimit të ambjenteve të bibliotekës por edhe takimeve me studentët, u konstatua se institucioni vë në dispozicion literaturën e nevojshme në funksion të realizimit të programit të studimit Master i Shkencave në "Psikologji" me profil "Psikologji Shkollore" ²³² . Përveç teksteve fizike, biblioteka siguron akses edhe në platforma digjitale si EBSCO, Medline, Eric dhe Proquest të cilat mund të shfrytëzohen në studentët për marrjen e njohurive bashkëkohore në nivel ndërkombëtar ²³³ .

²³¹ Evidenca 3.17. Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe e partnerëve për praktikën profesionale

²³² Evidenca: Shënime gjatë vizitës.

²³³ Evidenca: 2.25.1. Të dhëna të plota për platformat on-line tabela 17.

Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet e literaturës me botime të viteve të fundit.	Departamenti i Pedagogji-Psikologjisë propozon cdo vit një listë të përditësuar të literaturës në funksion të programeve të studimit, bazuar mbi syllabuset e secilës lëndë ²³⁴ , ²³⁵ .
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Biblioteka është në dispozicion të studentëve, duke u dhënë atyre mundësinë për të shfrytëzuar literaturën në versionet hard copy por edhe aksesin në platformat digjitale online ²³⁶ . Biblioteka ka një hapësirë fizike 300 m ² dhe 48 poste leximi duke u dhënë akses një numri të konsiderueshëm studentësh njëkohësisht. Mundësia e shfrytësimit sa më të mirë nga ana e studentëve rritet edhe nga fasha orare e punës e cila shtrihet nga ora 8 në mëngjes deri në orën 18:00 pasdite ²³⁷ .
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Gjatë vizitës në institucion u konstatua se biblioteka ka një fond fizik dhe një tjetër digjital në funksion të programit të studimit ²³⁸ . Tekstet bazë në gjuhën shqipe por edhe atë angleze ndodhen në bibliotekë dhe studentët gjithashtu konfirmuan aksesin që ju mundësohet në literaturë përmes këtij shërbimi. Nga ana tjetër biblioteka online siguron akses në revistat më të mira shkencore të fushës, me të rejat më të fundit të shkencës. Sipas dokumentacionit mbështetës, fondi i bibliotekës ka rreth 7000 tituj fizikë (rreth 850 psikologji) dhe 54 revista shkencore në shqip dhe anglisht ²³⁹ . Në rastet ku tekstet mungojnë, pedagogët vënë në dispozicion në bibliotekë broshura leksionesh.
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Gjatë vizitës në bibliotekë por edhe takimit me studentët u konfirmua se këta të fundit kanë akses pa pagesë në bibliotekat online të universitetit, brënda hapësirës fizike të bibliotekës. Cdo student ka të drejtën e anëtarësimit falas në bibliotekë dhe shfrytëzimit të materialeve didaktike ²⁴⁰
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të	Nga vizita në institucion por edhe raportimi dokumentar u konstatua se biblioteka disponon një numër të vogël postesh kompjuteri për akses të studentëve online (10 copë), të cilat lejojnë

²³⁴ Evidenca 2.26. Buxhetimi për pasurim të bibliotekës.

²³⁵ Evidenca 2.27. Dokument mbi librat e fundit për bibliotekën.

²³⁶ Evidenca 2.24. Rregullore e Bibliotekës 2019.

²³⁷ Evidenca 2.25. Të dhëna për bibliotekën.

²³⁸ Evidenca: Shënime gjatë vizitës

²³⁹ Evidenca 2.25. Të dhëna për bibliotekën.

²⁴⁰ Evidenca: Shënime gjatë vizitës

tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	shfrytëzim të kufizuar nga studentët ²⁴¹ , ²⁴² por nga vizita në institucion u konstatua se janë ndërmarrë hapa konkrete përmes përmirësimit të infrastrukturës me shtesën e një kati.
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Oraret e shërbimit të bibliotekës janë mjaft të përshtatshme pasi përkojnë me oraret e zhvillimit të mësimi. Mundësia e shfrytësimit sa më të mirë nga ana e studentëve rritet edhe nga fasha orare e punës e cila shtrihet nga ora 8 në mëngjes deri në orën 18:00 pasdite ²⁴³ . Biblioteka ka 48 poste leximi por vetëm 10 vende për akses online (të pajisura me kompjutera), cka kufizon disi aksesin e studentëve në literaturë ndërkombëtare ²⁴⁴ .
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësia përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	Njësia bazë, Departamenti i Pedagogji-Psikologjisë bën përpjekje të vazhdueshme për përditësimin e fondit fizik të bibliotekës ²⁴⁵ . Gjithsesi GJVJ nuk gjeti evidencë mbi raportime të Bibliotekës mbi cilësinë, përditësimin, apo shkallën e shfrytëzimit të fondit të bibliotekës nga ana e studentëve apo stafit akademik ²⁴⁶ . Raportime të tilla do të konsideroheshin të dobishme për të gjykuar mbi efektivitetin e përpjekjeve për pasurim të fondit të bibliotekës apo performancën e stafit akademik.
Konkluzione	<i>Biblioteka përban një fond tekstesh bazë në funksion të programit të studimit dhe siguron akses në biblioteka online. Gjithsesi</i>

²⁴¹ Evidenca 2.25. Të dhëna për bibliotekën.

²⁴² Evidenca: Shënime gjatë vizitës

²⁴³ Evidenca: Shënime gjatë vizitës

²⁴⁴ Evidenca 2.25. Të dhëna për bibliotekën.

²⁴⁵ Evidenca 2.25. Të dhëna për bibliotekën.

²⁴⁶ Evidenca: Shënime gjatë vizitës

	gjkohet se nevojitet një përpjekje për të rritur numrin e posteve fizike për akses online (aktualisht vetëm 10), dhe nga vizita në institucion u konstatua se janë ndërmarrë hapa konkrete përmes përmirësimit të infrastrukturës me shtesën e një kati. Gjithashtu rekomandohet inicimi i praktikës së mirë të raportimit periodik nga ana e bibliotekës në lidhje me shkallën e shfrytëzimit të materialeve/literaturës dhe rekomandimeve përkatëse për përmirësim.			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Institucioni disponon sistemin e menaxhimit të të dhënave, e-student i cili ruan, administrojnë dhe përpunon të dhënat e studentëve nga regjistrimi deri në diplomim. Sistemi gjithashtu mbart vlerësimin e studentëve, informacion i cili administrohet nga sekretaria mësimore. Sistemi mirëmbahet nga Zyra e IT pranë Fakultetit të Shkencave Sociale ²⁴⁷ .
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Informacioni, dokumentacioni dhe aktiviteti i personelit akademik dhe administrative menaxhohet nga Zyra e Burimeve Njerëzore në përpunim me Manualin për punësimin e personelit në UT ²⁴⁸ . Ajo mban të dhëna në versionet hard copy dhe elektronike për gjithë stafin e angazhuar në programin e studimit ²⁴⁹ .

²⁴⁷ Evidenca 2.9. Rregullore e Sekretarisë Mësimore 2018.

²⁴⁸ Evidenca 1.12. Manuali për punësimin e personelit në UT.

²⁴⁹ Evidenca 2.18. Informacion për politikën e burimeve njerëzore dhe vlerësimin e personelit.

Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Gjatë vizitës në institucion dhe takimit me studentët, u përmend rëndësia e përdorimit të sistemit e-student për mbarëvajtjen e procesit mësimor. Sistemi e-student siguron akses të dedikuar në dokumentacion dhe informacion për personelin akademik /administrativ dhe studentët. Secili përdorues ka emrin e përdoruesit dhe fjalëkalimin përkatës për të aksesuar në sistem, duke kontrolluar kështu aksesin në të dhëna ²⁵⁰ .
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Gjatë takimit me studentët dhe pedagogët u konstatua se përveç sistemit e-student edhe Platforma Teams përdoret gjerësisht nga pedagogët dhe studentët duke siguruar komunikim interaktiv dhe ndarje materialesh didaktike (leksione, detyra, rezultatet etj.) ²⁵¹ . Cdo student ka akses në këtë platformë përmes emrit unik të përdoruesit dhe fjalëkalimit përkatës. Kjo platformë e cila fillimisht u përdor gjatë periudhës së pandemisë ende vazhdon të ruajë funksionalitetin e saj në shërbim të mbarëvajtjes së procesit mësimor ²⁵² .
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Sistemi brendshëm i menaxhimit të informacionit mundëson bashkërendimin efektiv të aktivitetit akademik dhe administrative sikundër u evidentua në takimet me drejtuesit por edhe stafin akademik ²⁵³ .
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Në faqen zyrtare të Fakultetit të Shkencave Sociale paraqitet informacion i detajuar në lidhje me Departamentin Pedagogji-Psikologji, programet e studimit, personeli akademik, aktiviteti shkencor, projektet etj. Faqja është e përditësuar dhe informacioni përgjithësisht është në të dyja gjuhët shqip dhe anglisht ²⁵⁴ .
Konkluzione	<i>Institucioni disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit të informacionit, e-student i cili është vënë në dispozicion të</i>

²⁵⁰ Evidenca: 2.10.Baza rregullatore për mësimdhënien, të nxënës dhe provimet.

²⁵¹ Evidenca: Shënime gjatë vizitës

²⁵² Evidenca 1.15. Udhëzues i UT-së për përdorimin e sistemit të mësimi në distancë.

²⁵³ Evidenca: Shënime gjatë vizitës

²⁵⁴ Evidenca: Faqja Zyrtare <https://fshs-ut.edu.al/>

	informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik dhe administrativ për programin e studimit Master i Shkencave në "Psikologji" me profil "Psikologji Shkollore".			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar në kuadër të akreditimit të programit Master i Shkencave në "Psikologji" me profil "Psikologji Shkollore", GVJ konstatoi se Institucioni disponon raporte financiare të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe si dhe ka hartuar plane për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi ^{255, 256} .
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në	Plani i financimit i hartuar në nivel Fakulteti përmban informacion për Departamentin e Pedagogji-Psikologjisë, njësinë bazë përgjegjëse për programin e studimit Master i Shkencave në Psikologji me Profil 'Psikologji Shkollore' ^{257, 258} . Dokumentacioni paraqet të dhëna në lidhje me financimin e burimeve njerëzore, shpenzimeve operative për mirëmbajtje mjediseshe si dhe teknologjinë mbështetëse, shpenzime për pasurimin e bibliotekës përfshi aksesin online, grante nga projektet etj.

²⁵⁵ Evidenca 2.33.Buxheti i FSHS 2023.

²⁵⁶ Evidenca 2.32.Buxheti afatmesëm FSHS 2022-2025.

²⁵⁷ Evidenca 2.33.Buxheti i FSHS 2023.

²⁵⁸ Evidenca 2.32.Buxheti afatmesëm FSHS 2022-2025.

Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Universiteti i Tiranës si institucion publik harton një raport vjetor auditit të brendshëm nga njësia përkatëse që ka këtë funksion brenda universitetit. Evidenca dokumentare e paraqitur nga institucioni vërteton se ky i fundit kryen auditim periodik, harton raporte financiare me të dhëna të hollësishme të cilat vlerësojnë gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij ²⁵⁹ .			
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Evidenca dokumentare e dorëzuar nga institucioni vërteton transparencë në raportim në lidhje me buxhetin, përshi të ardhurat nga tarifat e shkollimit, projektet, trajnimet, grantet kërkimore etj si dhe shpenzimet përkatëse në funksion të realizimit të programeve të studimit në nivel Fakulteti ²⁶⁰ .			
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	Universiteti i Tiranës garanton qëndrueshmëri financiare për zhvillimin e programit të studimit Master i Shkencave në “Psikologji” me profil “Psikologji Shkollore”. Institucioni ka kapacitet financiar të mjaftueshëm për të garantuar ecurinë normale të programit të studimit ^{261, 262} . GVJ nuk konstatoi nevojë për ndërhyrje për përmirësimin e situatës financiare apo diversifikimin e financimit në kuadër të programit specifik të studimit.			
Konkluzione	<i>Universiteti i Tiranës, si institucion publik, garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

²⁵⁹ Evidenca 2.34. Raport auditit FSHS.

²⁶⁰ Evidenca 2.33. Buxheti i FSHS 2023.

²⁶¹ Evidenca 2.32. Buxheti afatmesëm FSHS 2022-2025.

²⁶² Evidenca 2.33. Buxheti i FSHS 2023.

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1 Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Rregullorja e Departamentit dhe ajo e Programit të Studimit Master i Shkencave në “Psikologji” me profil “Psikologji Shkollore” përcakton politikat dhe procedurat e ndjekura për këtë cikël studimesh që nga momenti i regjistrimit të studentëve dhe deri në diplomim ²⁶³ . Programi ofrohet në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë. Kuotat e pranimit miratohen periodikisht nga Senati akademik dhe studentët informohen në mënyrë të vazhdueshme në lidhje me gjithë proceset akademike dhe administrative ku përfshihen ²⁶⁴ .
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe	Rregullorja e Programit të Studimit Master i Shkencave në “Psikologji” me profil “Psikologji Shkollore” garanton barazinë dhe të drejta të njëjta për gjithë studentët në lidhje me gjithë procedurat e ndjekura, përfshi regjistrimin, transferimin e deri në diplomim ²⁶⁵ . Procedurat janë në përputhje me Ligjin për Arsimin

²⁶³ Evidenca 3.3. Rregullore e departamentit.

²⁶⁴ Evidenca: Rregullore e Programit të Studimit Master i Shkencave në Psikologji me Profil ‘Psikologji Shkollore’

²⁶⁵ Evidenca: Rregullore e Programit të Studimit Master i Shkencave në Psikologji me Profil ‘Psikologji Shkollore’

studentët e programit të studimit.	e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë si dhe Udhëzimet e MASR.
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.	Departamenti i Pedagogji-Psikologjisë propozon cdo vit kriteret e pranimi të cilat miratohen nga Dekani përkatës dhe bëhen publike ²⁶⁶ . Kuotat për cdo vit akademik dhe cdo program miratohen nga Senati akademik, duke pasur parasysh kapacitetet e institucionit për zhvillimin e një mësimdhënie cilësore ²⁶⁷ . Lista e kandidatëve fitues është gjithashtu publike ²⁶⁸ .
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimi dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Institucioni bën publike në faqen zyrtare të web si dhe në mediumet online procedurat dhe kriteret e përzgjedhjes dhe pranimi të studentëve ²⁶⁹ , ²⁷⁰ . Gjithashtu Rregullorja e Departamentit përcakton procedurat mbi njohjen dhe transferimin e krediteve, për të cilat informohen korrektësisht të gjithë të interesuarit. Kurrikula e programit të studimit gjithashtu është publike duke rritur aksesueshmërinë për të gjithë të interesuarit ²⁷¹ .
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Përpara cdo viti akademik institucioni publikon kriteret pranimi për programet e studimit në mediumet online si dhe në faqen zyrtare të universitetit ²⁷² . Gjithashtu gjatë ditëve të hapura në universitet vihen në dispozicion broshura informuese në lidhje me kriteret, procedurat, organizimin e institucionit si dhe specifika të programit të studimit. Sipas rregullores Fakulteti bën publike kriteret e pranimi brenda muajit dhjetor të vitit para-ardhës.
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti	Institucioni i kushton rëndësi të vecantë edhe përfshirjes së kandidatëve me aftësi të vecanta apo atyre nga shtresa të

²⁶⁶ Evidenca 3.3. Rregullore e departamentit.

²⁶⁷ Evidenca 2.31. Ngritja e grupeve të punës për pranimit e reja në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve në Fakultetin e Shkencave Sociale, për vitin akademik 2024-2025.

²⁶⁸ Evidenca: 3.13. Vendimi për miratimin e kuotave të pranimi për programin e studimit.

²⁶⁹ Evidenca: 3.13. Vendimi për miratimin e kuotave të pranimi për programin e studimit.

²⁷⁰ Evidenca: 3.14. Vendimi për miratimin e kriterëve të pranimi për programin e studimit.

²⁷¹ Evidenca 3.3. Rregullore e departamentit.

²⁷² Evidenca: 3.14. Vendimi për miratimin e kriterëve të pranimi për programin e studimit.

akademik kriteret e veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	margjinalizuara sikundër vërehet në aplikimin e kuotave për minoritetet, Rome apo Egjiptiane dhe për student me statusin e jetimit ^{273, 274}			
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Në miratimin e kuotave për cdo vit akademik, Senati I UT miraton kuota të vecanta për kandidatët nga shtete të tjera. Për programin përkatës Master i Shkencave në Psikologji me Profil ‘Psikologji Shkollore’ janë 5 kuota për kandidatët nga shtete të tjera. Shembuj që u përmendën përfshijnë student nga nga shtete te tjera shqipfolëse si Maqedonia e Veriut apo Mali I Zi ²⁷⁵ . Informacioni në lidhje me pranimin e kandidatëve nga shtete të tjera është publik dhe pasqyrohet në faqet online të Universitetit.			
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimin në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	Institucioni ka politika të qarta për mbështetjen e studentëve me disa kategori bursash, si ato për studentët ekselentë apo studentët nga shtresat e marginalizuara apo me pamundësi ekonomike. Informacioni në lidhje me bursat është publik dhe u konfirmua gjatë takimeve me studentët e programit të studimit Master i Shkencave në “Psikologji” me profil “Psikologji Shkollore” ²⁷⁶ .			
Konkluzione	<i>Institucioni ka politika dhe procedura të qarta dhe publike për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit Master i Shkencave në “Psikologji” me profil “Psikologji Shkollore”.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
----------	------------------------

²⁷³ Evidenca: 3.13. Vendimi për miratimin e kuotave të pranimin për programin e studimit.

²⁷⁴ Evidenca: 3.14. Vendimi për miratimin e kriterëve të pranimin për programin e studimit.

²⁷⁵ Evidenca: 3.13. Vendimi për miratimin e kuotave të pranimin për programin e studimit.

²⁷⁶ Evidenca: Shënime gjatë vizitës

Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Fakulteti i Shkencave Sociale dhe Departamenti Psikologji-Pedagogji përcakton në Rregulloret përkatëse kriteret dhe procedurat e programeve të studimit përfshi kalimin nga një vit akademik në tjetrin ²⁷⁷ . Gjatë takimit me studentët GVJ konstatoi se ata ishin të informuar për detyrimet e tyre në lidhje me përparimin akademik dhe kalimin në vitin pasardhës ²⁷⁸ .
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Institucioni ka procedura të qarta në lidhje me njohjen e studimeve të mëparshme, të cilat shprehen në aktet rregullatore ²⁷⁹ . Gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi se studentët informohen në lidhje me këtë çështje përmes informacionit në web dhe gjithashtu përmes koordinаторit të programit ²⁸⁰ .
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Gjatë javës së parë të orientimit në institucion studentët marrin informacion të përgjithshëm në lidhje me kriteret dhe procedurat e vlerësimit në programin përkatës të studimit ²⁸¹ . Gjithashtu secili pedagog me prezantimin e syllabusit të lëndës, kryen edhe informimin e studentëve për format e vlerësimit në lëndën përkatëse. Format e vlerësimit përfshijnë vlerësimin e vazhduar përmes 4 komponentëve: provimit të ndërmjetëm, detyrës së kursit, aktivizimit në seminare dhe provimit përfundimtar. Studenti gjithashtu njihet me të drejtën për ankimimin e vlerësimit dhe procedurën që duhet ndjekur në rastin specifik. Gjatë vizitës në institucion dhe takimit me studentët ata konfirmuan se kishin informacion në lidhje me të gjitha procedurat e sipërpërmendura ²⁸² .
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Rregullorja e Programit të Studimit dhe Rregullorja e Diplomimit përcaktojnë qartë kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës për programin e studimit Master i Shkencave në "Psikologji" me profil "Psikologji Shkollore" ^{283, 284} . Informacioni i paraqitur lidhet me strukturën e punimit, fazat e dorëzimit, procedurën e supervizimit deri në dorëzimin e produktit final.

²⁷⁷ Evidenca 3.3 Rregullore e Departamentit

²⁷⁸ Evidenca: Shënime gjatë vizitës

²⁷⁹ Evidenca 3.3 Rregullore e Departamentit

²⁸⁰ Evidenca: Shënime gjatë vizitës

²⁸¹ Evidenca: Rregullore e Programit të studimit Master i Shkencave në Psikologji me Profil 'Psikologji Shkollore'

²⁸² Evidenca: Shënime gjatë vizitës

²⁸³ Evidenca 2.11. Rregullore e Diplomimit FSHS.

²⁸⁴ Evidenca 5.4. Rregullorja e programit të studimit.

Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Departamenti i Pedagogji- Psikologjisë gjatë javës së orientimit organizon takime informuese me studentët e rinj për ti informuar ata në lidhje me programin e studimit, rregulloren, organizimin e praktikës mësimore, punimin e diplomës, frekuentimin, format e vlerësimit etj. Krahas departamentit, Zyra e Karrierës luan gjithashtu një rol të rëndësishëm këshillues për studentët, që nga momenti i regjistrimit dhe deri në diplomim ²⁸⁵ .			
Konkluzione	<i>Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit Master i Shkencave në Psikologji Shkollore informacion të plotë mbi detyrimet dhe përparimin akademik, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në atë program.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Përpara fillimit të vitit akademik, gjatë javës së orientimit, studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit. Departamenti dhe vecanërisht koordinatori i programit të studimit jep informacion të detajuar në lidhje me lëndët, detyrimet, vlerësimin, afatet kohore etj ²⁸⁶ . Gjatë vizitës në institucion studentët konfirmuan se janë informuar hollësisht në lidhje me programin Master i Shkencave në Psikologji me profil 'Psikologji Shkollore' ²⁸⁷ .
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të	Me fillimin e vitit akademik studentët njihen me Rregulloren e Programit të Studimit, Kurrikulën e programit si dhe programet e lëndëve përkatëse. Koordinatori i programit, por edhe secili pedagog shpjegon në mënyrë të hollësishme strukturën dhe format

²⁸⁵ Evidenca 2.22.Rregullore e Zyrës së Këshillimit për Karrierë 2021.

²⁸⁶ Evidenca 3.3 Rregullore e Departamentit

²⁸⁷ Evidenca: Shënime gjatë vizitës

posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	e vlerësimit të lëndëve përkatëse, si dhe detyrimet në lidhje me praktikën dhe mbrojtjen e diplomës. Informacioni shpërndahet përmes broshurave informuese por edhe përmes mediumit online, në faqen zyrtare të Fakultetit dhe Departamentit përkatës ^{288, 289} .
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Zyra e Karrierës mundëson lidhjen e studentëve me tregun e punës edhe gjatë kohës që ata janë duke kryer studimet ²⁹⁰ . Gjatë vizitës në institucion, dhe takimeve me përfaqësues të kësaj zyre, GVJ konstatoi rolin e rëndësishëm të saj në njoftimin e studentëve mbi intershipte, mundësi punësimi, trajnime, mobilitete etj. Udhëzuesi i Karrierës i hartuar nga kjo Zyrë është një ndihmë konkrete ndaj studentëve për orientim në tregun e punës ²⁹¹ . Gjithashtu bordi i punës është një tjetër strukturë e rëndësishme që mundëson lidhjen e studentëve me tregun e punës sikundër janë edhe aktivitete si panairi i punës apo leksionet e hapura me profesionistë të fushës.
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Përpara fillimit të vitit akademik, gjatë javës së orientimit, studentët informohen në mënyrë të hollësishme për kalendarin akademik, organizmin e procesit mësimor si dhe mjediset/infrastrukturën në shërbim të realizimit të programit të studimit ²⁹² . Informacioni përcillet edhe përmes mediumeve online si dhe platformës e-student ²⁹³ .
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Institucioni përdor sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit e-student si dhe platformën Microsoft Teams në funksion të procesit mësimor. Përmes këtyre platformave studentët njihen me programet e lëndëve, syllabuset, detyrat, oraret, njoftimet, vlerësimet nga pedagogët etj., informacion i cili është i aksesueshëm edhe në distancë ²⁹⁴ .
Konkluzione	<i>Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë në lidhje me strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënës dhe mundësitë e punësimit.</i>

²⁸⁸ Evidenca 3.3 Rregullore e Departamentit

²⁸⁹ Evidenca: Shënime gjatë vizitës

²⁹⁰ Evidenca: 2.23.Politika për mbështetjen për studentët dhe strukturat e tyre organizative.

²⁹¹ Evidenca: 2.22.Rregullore e Zyrës së Këshillimit për Karrierë 2021.

²⁹² Evidenca 3.3 Rregullore e Departamentit

²⁹³ Evidenca: Shënime gjatë vizitës

²⁹⁴ Evidenca 1.15. Udhëzues i UT-së për përdorimin e sistemit të mësimi në distancë.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve të diplomuarve, në programin e studimit.	Institucioni mban dhe raporton statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar dhe të diplomuar në programin e studimit Master i Shkencave në “Psikologji” me profil “Psikologji Shkollore” ²⁹⁵ . Përgjatë 2 viteve të fundit akademike numri i studentëve të diplomuar ka qenë përkatësisht: Në vitet akademike 2022-2023- 27 studentë të diplomuar Në vitet akademike 2023-2024- 24 studentë të diplomuar
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Sekretaria mësimore disponon informacion mbi numrin e studentëve të regjistruar, të larguar dhe të diplomuar për cdo program studimi ²⁹⁶ . Përgjatë 2 viteve të fundit të studimit, numri i studentëve të regjistruar ka qenë përkatësisht: ➤ Në vitet akademike 2022 – 2023: 33 studentë 2023 – 2024: 31 studentë Nuk ka studentë të larguar nga programi i studimit
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurt dhe lehtësisht	Sekretaria mësimore menaxhon të dhënat statistikore të studentëve përmes sistemit të brendshëm të informacionit Gradua dhe E-student ²⁹⁷ . Përmes platformës E-student studentët aksesojnë informacionin në lidhje me vlerësimin në lëndët përkatëse. Të dhënat nga këto platforma përdoren për të gjeneruar statistika në lidhje me studentët dhe për ti ndarë ato me personat e autorizuar ²⁹⁸ .

²⁹⁵ Evidenca shitesë: Aneks Tabelat

²⁹⁶ Evidenca shitesë: Aneks Tabelat

²⁹⁷ Evidenca 2.9. Rregullore e Sekretarisë Mësimore 2018.

²⁹⁸ Evidenca 2.10. Baza rregullatore për mësimdhënien, të nxëniet dhe provimet.

të verifikueshme nga personat e autorizuar.				
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretarisë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Institucioni mbështet me aktet e veta rregullatore mirëfunksionimin e sekretarisë mësimore dhe sistemit të brendshëm të menaxhimit të informacionit. Rregullorja e Sekretarisë Mësimore ²⁹⁹ përcakton formën e administrimit të të dhënave, regjistrat themeltarë dhe të diplomave, dosjet e studentëve, regjistrin e arritjeve akademike etj.			
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Departamenti Pedagogji- Psikologji harton Raporte Vjetore ³⁰⁰ ku përfshihet analizë e cilësisë në hyrje dhe dalje e studentëve, shkalla e punësimit të tyre dhe rekomandime në lidhje me treguesit përkatës. Të dhënat e raportuara në nivel programi dhe departamenti janë pjesë e raportit vjetor në nivel Universiteti.			
Konkluzione	<i>Institucioni mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre. Sekretaria mësimore, Zyra e Karrierës dhe Departamenti janë 3 njësitë përgjegjëse të cilat bashkëpunojnë për realizimin e këtij funksioni.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

²⁹⁹ Evidenca 2.9. Rregullore e Sekretarisë Mësimore 2018.

³⁰⁰ Evidenca: Raporti vjetor i Departamentit.

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e Universitetit, studentët përfshihen në organet vendimmarrëse dhe këshilluese të universitetit, si psh. Senati Akademik, Komisioni i Sigurimit të Standardeve të Cilësisë, Komisioni i Kurrikulës, Këshilli i Etikës dhe Këshillat Studentorë ³⁰¹ . Gjatë vizitës në institucion u konstatua se studentët ishin në dijeni të këtyre strukturave dhe pjesëmarrës në to ³⁰² .
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Institucioni bën përpjekje maksimale për përfshirjen konkrete të studentëve në të gjitha proceset vendimmarrëse apo këshilluese ³⁰³ . GVJ konstatoi se ky ishte edhe rasti i studentes të përfshirë në procesin e hartimit të raportit të GVB për akreditimin e Programit Master i Shkencave në Psikologji me profil 'Psikologji Shkollore'. Përveç këtij shembulli, gjatë takimit me studentët ata theksuan përfshirjen e tyre reale edhe në procese si vlerësimi i cilësisë përmes procedurave të NJSBC ³⁰⁴ .
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	Në përputhje me Rregulloren e Programit Master i Shkencave në Psikologji me Profil 'Psikologji Shkollore' studentët angazhohen në vlerësim të programit dhe pedagogëve përkatës cdo vit akademik. Komentet dhe sugjerimet e tyre nga pyetësorët përfshihen në raportin vjetor të hartuar nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë ³⁰⁵ . Gjatë vizitës në institucion nuk u konstatua ndonjë shembull konkret sesi sugjerime konkrete të studentëve janë përdorur në funksion të përmirësimit të këtij programi studimi në mënyrë specike.
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe	Në përputhje me Rregulloren e Departamentit Pedagogji-Psikologji dhe Rregulloren e Programit të Studimit Master i Shkencave në Psikologji me profil 'Psikologji Shkollore', dhe

³⁰¹ Evidenca 2.23. Politika për mbështetjen për studentët dhe strukturat e tyre organizative.

³⁰² Evidenca: Shënime gjatë vizitës

³⁰³ Evidenca: 1.23. Rregullore për zgjedhjet e këshillave të studentëve në Universitetin e Tiranës.

³⁰⁴ Evidenca: Shënime gjatë vizitës

³⁰⁵ Evidenca 2.17. Raporte periodike NJSBC 2023, 2024.

13  111

ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Bazën rregullatore për mësimdhënien, të nxëniet dhe provimet, provimet kryhen me sekretim, dhe studentët kanë të drejtën e ankimimit dhe rivlerësimit të provimeve ³⁰⁶ . Gjatë vizitës në institucion GVI konstatoi se studentët ishin në dijeni të këtij procesi por nuk kishte raste konkrete për programin e studimit ³⁰⁷ .			
Konkluzione	<i>Institucioni angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, si Senati Akademik, Komisioni i Sigurimit të Cilësisë etj., në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Institucioni ka një sërë njësish në shërbim të studentëve; krahas Departamentit të Pedagogjisë dhe Psikologjisë, njësi të tjera në ndihmë të studentëve përfshijnë Sekretarinë, Zyrën e Karrierës, Zyrën e IT, Zyrën e Financës etj. Rregullorja e Departamentit dhe ajo e Programit të Studimit, përcaktojnë procedurat përmes të cilave secila prej këtyre njësive bashkëpunon në funksion të shërbimit ndaj studentit ^{308,309,310} .
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të	Zyra e Karrierës në bashkëpunim me Departamentin e Pedagogji-Psikologjisë ofron këshillim dhe orientim të studentëve ³¹¹ . Vecanërisht koordinatori i programit të studimit angazhohet për

³⁰⁶ Evidenca: 2.10. Baza rregullatore për mësimdhënien, të nxëniet dhe provimet.

³⁰⁷ Evidenca: Shënime gjatë vizitës

³⁰⁸ Evidenca 3.3. Rregullore e Departamentit

³⁰⁹ Evidenca: Rregullore Programit të Studimit Master i Shkencave në Psikologji me Profil 'Psikologji Shkollore'

³¹⁰ Evidenca: 2.9. Rregullore e Sekretarisë Mësimore 2018.

³¹¹ Evidenca 3.3. Rregullore e Departamentit

studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	i takon progresit akademik të studentëve dhe adreson çështje të cilat mund të lindin në proces ³¹² .			
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Shërbimi i këshillimit të karrierës ofrohet përmes Zyrës përkatëse të këshillimit e cila informon dhe mbështet studentët në një sërë procesesh ³¹³ . Gjatë vizitës në institucion u konstatua se kjo Zyrë përvec këshillimit ofron mundësi konkrete aplikimi në intershipe, trajnime, apo edhe projekte brënda dhe jashtë vendit ³¹⁴ . Rrjeti i Alumnit gjithashtu ka një kontribut të vecantë përsa i takon lidhjes me tregun aktual të punësimit.			
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Zyra e Karrierës gjurmon studentët e diplomuar dhe mban kontakte të vazhdueshme me ta. Alumnit e programeve të studimit janë pjesë aktive e jetës universitare, sikundër u dëshmuua edhe gjatë vizitës në institucion ³¹⁵ . Alumni të Programit Master i Shkencave në Psikologji me profil 'Psikologji Shkollore' dëshmuuan përfshirjen e tyre të vazhdueshme si lektorë të ftuar ose ura lidhëse për realizimin e praktikave profesionale të studentëve ³¹⁶ .			
Konkluzione	<i>Institucioni ka procedura si edhe njësi të vecanta për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

³¹² Evidenca 2.22.Rregullore e Zyrës së Këshillimit për Karrierë 2021.

³¹³ Evidenca 2.22.Rregullore e Zyrës së Këshillimit për Karrierë 2021.

³¹⁴ Evidenca: Shënime gjatë vizitës

³¹⁵ Evidenca 2.22.Rregullore e Zyrës së Këshillimit për Karrierë 2021.

³¹⁶ Evidenca: Shënime gjatë vizitës

				X
--	--	--	--	---

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Institucioni ka strukturat e veta përkatëse në funksion të monitorimit dhe rritjes së cilësisë në mësimdhënie si njësi e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Komisioni i Përhershëm i Garantimit të Standardeve dhe Cilësisë. Gjithashtu institucioni ka hartuar një bazë rregullatore të posacme në lidhje me sigurimin e standardeve të cilësisë, si dhe hartimin e udhëzuesve me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të procesit të mësimdhënies. ^{317,318,319}
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative	Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi funksionimin e qartë dhe efikas të Komisionit të përhershëm për sigurimin e Brendshëm të Cilësisë si dhe Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Komisioni i përhershëm për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë monitoron, vlerëson aspektet e ndryshme të procesit mësimor. Njësi e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë mbledh të dhëna periodike në lidhje me aftësitë mësimdhënëse, cilësinë e kurrikulës

³¹⁷ Evidenca 1.3. Rregullore-e-universitetit-te-tiranes-2022.

³¹⁸ Evidenca 1.11 Manuali i cilësisë.

³¹⁹ Evidenca 2.12. Vendim i FSHS-së për ngritjen e Njësisë së Sigurimit të Cilësisë.

të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	etj., harton raporte dhe i paraqet ato para Komisionit për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë. ^{320,321,322}			
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	Në përputhje me Rregulloren për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë, Institucioni organizon vlerësime periodike, gjatë të cilave studentët kanë mundësi të japin feedback në lidhje me mësimdhënien, format e vlerësimit etj ³²³ . Gjatë vizitës në institucion studentët konfirmuan përfshirjen e tyre aktive në këtë proces ³²⁴ . Rezultatet e këtij vlerësimi përmbledhen në raportet periodike të hartuara nga NJSBC, së bashku me rekomandimet për përmirësim.			
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Rezultatet e procesit periodik të vlerësimit të brendshëm të cilësisë, ndahen me autoritetet drejtuese përfshi përgjegjësin e departamentit si dhe me pedagogët dhe studentët ³²⁵ . Në përputhje me Manualin e Cilësisë ³²⁶ , këto rezultate bëhen publike me qëllim transparencën dhe informimin, por sigurisht në respektim të plotë të privatësisë dhe etikës profesionale ³²⁷ .			
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Njësia bazë, në analizën e saj vjetore ³²⁸ përfshin elementë të sigurimit të standardeve të cilësisë duke reflektuar mbi praktikën e mira dhe duke dhënë rekomandime për përmirësim në disa drejtime përfshi mësimdhënien, kurrikulën, cilësinë e studentëve në hyrje/dalje, cilësinë e stafit akademik etj. Mbështetur në këtë reflektim hartohen planet vjetore të punës të cilat synojnë promovimin e praktikave të mira por edhe adresimin e mangësive në rastet kur janë të pranishme.			
Konkluzione	<i>Institucioni ka një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies përmes strukturave si Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë. Institucioni ka një Rregullore specifike mbi bazën e të cilës operon dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

³²⁰ Evidenca 2.15. Te dhena per NJSBC (tabela 24)

³²¹ Evidenca 2.12. Vendim i FSHS-së për ngritjen e Njësive të Sigurimit të Cilësisë.

³²² Evidenca 1.11 Manuali i cilësisë.

³²³ Evidenca 2.17. Raporte periodike NJSBC 2023, 2024.

³²⁴ Evidenca: Shënime gjatë vizitës

³²⁵ Evidenca 1.8. Rregullore UT për "Mbrojtjen, Përpunimin, ruajtjen dhe sigurimin e të dhënave personale.

³²⁶ Evidenca 1.11 Manuali i cilësisë.

³²⁷ Evidenca 1.5. kodi-i-etikes 2011.

³²⁸ Evidenca: Raporti vjetor i Departamentit Pedagogji Psikologji

				X
--	--	--	--	---

Standardi VI.2 Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore në fuqi, Rregullorja e UT ³²⁹ parashikon strukturat përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë përfshi Komisionin e Përherëshëm të Garantimit të Standardeve dhe Cilësisë si dhe Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë ³³⁰ . NJSBC vepron në zbatim të Manualit të cilësisë i cili përcakton procedurat e ndjekura për monitorimin, vlerësimin dhe raportimin mbi cilësinë në nivel njësie bazë dhe Fakulteti ³³¹ .
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Strukturat përgjegjëse për monitorimin e cilësisë në institucion bashkëpunojnë ngushtë me stafin akademik dhe studentët me qëllim identifikimin e çështjeve të rëndësishme në lidhje me procesin e mësimdhënies, cilësinë e stafit dhe kurrikulën ^{332, 333} . Gjatë takimit në institucion GVJ konstatoi se sistemi i sigurimit të brendshëm të cilësisë është funksional dhe aktiv në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të procesit mësimor ³³⁴ .
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të	Institucioni përdor një sërë instrumentash vlerësues për sigurimin e brendshëm të cilësisë përfshi pyetësorë për stafin dhe studentët, të cilët aspekte të ndryshme të cilësisë së mësimdhënies ³³⁵ . Krahas monitorimit të brendshëm të cilësisë, institucioni tashmë i nënshtrohet edhe vlerësimit të jashtëm, përmes procesit të akreditimit institucional dhe të programeve, sikundër rasti për

³²⁹ Evidenca 1.3. rregullore-e-universitetit-te-tiranes-2022.

³³⁰ Evidenca 2.12.Vendim i FSHS-së për ngritjen e Njësisë së Sigurimit të Cilësisë.

³³¹ Evidenca 2.15. Te dhena per NJSBC (tabela 24)

³³² Evidenca 2.15. Te dhena per NJSBC (tabela 24)

³³³ Evidenca 1.11Manuali i cilësisë.

³³⁴ Evidenca: Shënime gjatë vizitës

³³⁵ Evidenca: 1.14.Paketa e instrumenteve të cilësisë.

akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	Masterin e Shkencave në “Psikologji” me profil “Psikologji Shkollore”.			
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	Bazuar mbi Rregulloren përkatëse institucioni përdor instrumentat e duhur për vlerësim e për pasojë indikatorë të qartë në lidhje me cilësinë e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Raportimi nga perspektiva e studentëve por edhe stafit siguron paraqitjen e perspektivave të ndryshme mbi situatën si dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e procesit ^{336, 337} . Gjithsesi GVJ nuk gjeti evidencë konkrete në lidhje me shembuj promovimi të stafit akademik bazuar mbi tregues cilësorë nga ky proces vlerësimi.			
Konkluzione	<i>Institucioni disponon politika dhe procedura të qarta për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, si njësi e sigurimit të brendshëm të cilësisë, dhe komisioni i përhershëm për sigurimin e standardeve të cilësisë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë bashkëpunon me Zyrën e Kurrikulës në funksion të monitorimit të programit të studimit me qëllim rritjen e cilësisë. Krahas raporteve periodike të Njesisë, cdo vit Departamenti harton raportin analitik në nivel njësie baze, në të cilin reflektohen pikat e dobëta dhe të forta në nivel programi,

³³⁶ Evidenca: 1.14. Paketa e instrumenteve të cilësisë.

³³⁷ Evidenca 2.17. Raporte periodike NJSBC 2023, 2024.

mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	gjithmonë në funksion të rritjes së cilësisë. Raportet e hartuara nga të gjitha njësitë e përfshira vihen në dispozicion të strukturave drejtuese (Dekanati), me qëllim informimin si dhe hartimin e planeve strategjike të zhvillimit^{338, 339}.
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	GVJ konstatoi se raportet e vlerësimit janë të detajuara duke përfshirë indikatorë sasiorë të cilësisë³⁴⁰. Rezultatet e këtyre raporteve diskutohen në mbledhje Senati, ku edhe evidentohen praktikat e mira ose masat e nevojshme për të adresuar mangësitë. Gjithsesi GVJ nuk gjeti informacion mbi format e motivimit pozitiv të stafit apo studentëve për arritje të larta në mësimdhënie apo kërkim shkencor³⁴¹.
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i	Format e ndryshme të vlerësimit të drejtpërdrejtë të përdorura nga institucioni përfshijnë:^{342, 343} -Monitorimin dhe certifikimin e syllabuseve nga drejtuesi i njësisë bazë-proces i cili siguron standardizimin e formës dhe përditësimin e përmbajtjes në funksion të ruajtjes së standardeve të cilësisë

³³⁸ Evidenca 1.11 Manuali i cilësisë.

³³⁹ Evidenca: Shënime gjatë vizitës.

³⁴⁰ Evidenca 2.17. Raporte periodike NJSBC 2023, 2024.

³⁴¹ Evidenca: Shënime gjatë vizitës.

³⁴² Evidenca 1.14. Paketa e instrumenteve të cilësisë.

³⁴³ Evidenca Rregullore e Programit të studimit

cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitutionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	-Certifikimin e tezave të provimeve nga drejtuesi i njësisë bazë, proces i cili minimizon arbitraritetin në format e vlerësimit -Vëzhgime në auditor në lidhje me cilësinë e mësimdhënies sidomos për asistent lektorët dhe pedagogët e rinj.
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.	Format e ndryshme të vlerësimit të përdorura nga institucioni përfshijnë³⁴⁴: 1. Vetëraportim i pedagogëve (në lidhje me lëndët dhe kërkimin shkencor) 2. Pyetësorët e studentëve (mësimdhënia, pedagogët, përmbajta e lëndës etj) 3. Analizë e indikatorëve sasiorë, psh mesatarja në hyrje/dalje Gjithsesi GVJ nuk gjeti evidencë për përfshirjen e alumni apo palëve të treta në procesin e vlerësimit të cilësisë³⁴⁵.
Konkluzione	<i>Institucioni monitoron dhe vlerëson në mënyrë periodike programin e studimit, duke përdorur metodologji të drejtpërdrejta dhe tërthorta nga aktorë të ndryshëm si studentët dhe stafi.</i>

³⁴⁴ Evidenca: 1.14.Paketa e instrumenteve të cilësisë.

³⁴⁵ Evidenca: Shënime gjatë vizitës.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Institucioni përfshin aktorët e brendshëm si studentët dhe stafin akademik në procesin e vlerësimit të cilësisë ³⁴⁶ , por GVJ nuk gjeti evidencë të dokumentuar, formale, për përfshirjen e alumni apo palëve të treta në procesin e vlerësimit të cilësisë ³⁴⁷ .
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Në përputhje me Manualin e Cilësisë ³⁴⁸ , janë përcaktuar qartë përgjegjësitë dhe detyrat konkrete të anëtarëve të Komisionit për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë dhe Njësisë së Brendshme për Sigurimin e Cilësisë. Gjatë takimit me përfaqësues nga të dyja këto struktura GVJ konstatoi se anëtarët ishin të qartë për detyrat dhe përgjegjësitë e tyre si dhe për modalitetet e bashkëpunimit në funksion të rritjes së cilësisë. Studentët ishin gjithashtu të qartë për formën e përfshirjes së tyre në procesin e vlerësimit të brendshëm të cilësisë ³⁴⁹ .
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e	Në përputhje me Rregulloren, institucioni garanton përfshirjen e njësisë bazë dhe asaj kryesore në procesin e vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë së programit të studimit. Drejtuesi i njësisë përfshihet në procesin e vlerësimit të drejtpërdrejtë dhe tërthorë të stafit akademik, mësimdhënies, cilësisë së syllabuseve etj. Gjithashtu studentët përfshihen në raportimin e drejtpërdrejtë në lidhje me

³⁴⁶ Evidenca 1.11Manuali i cilësisë.

³⁴⁷ Evidenca: Shënime gjatë vizitës

³⁴⁸ Evidenca 1.11Manuali i cilësisë.

³⁴⁹ Evidenca: Shënime gjatë vizitës

studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.	cilësinë e mësimdhënies dhe programit të studimit si edhe përmes pjesëmarrjes me përfaqësi në strukturat drejtuese të institucionit ^{350, 351} .			
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Në zbatim të Kodit të Etikës si dhe akteve rregullatore të institucionit, procesi i vlerësimit të cilësisë përfshin të gjithë aktorët e parashikuar në respekt të plotë të integritetit të tyre, duke shmangur diskriminimin dhe pabarazinë ^{352, 353} .			
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Pavarësisht se aktorët e jashtëm përfshihen në realizimin e programit të studimit, GVJ nuk gjeti informacion mbi përfshirjen e tyre aktive në procesin e vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë ³⁵⁴ .			
Konkluzione	<i>Institucioni përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë së programit të studimit. Gjithsesi rekomandohet që institucioni të bëjë përpjekje për përfshirje në mënyrë aktive të ekspertëve dhe bashkëpunëtorëve të jashtëm.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

³⁵⁰ Evidenca 1.11 Manuali i cilësisë.

³⁵¹ Evidenca: Shënime gjatë vizitës.

³⁵² Evidenca 1.8. Rregullore UT për "Mbrotjtjen, Përpunimin, ruajtjen dhe sigurimin e të dhënave personale.

³⁵³ Evidenca 1.5. kodi-i-etikes 2011.

³⁵⁴ Evidenca: Shënime gjatë vizitës

Standardi VI.5 Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Procedurat e ndjekura për sigurimin e brendshëm të cilësisë janë transparente për stafin dhe studentët. Dokumentacioni bazë në lidhje me politikën, strategjinë, si dhe organizimin e veprimtarive në kuadër të sigurimit të brendshëm të cilësisë është publikuar në website të Fakultetit për gjithë të interesuarit ³⁵⁵ .
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Gjatë vizitës në institucion u konstatua se autoritetet drejtuese si edhe personeli akademik dhe administrativ i përfshirë bëhen me dije në lidhje me rezultatet e vlerësimeve ³⁵⁶ . Gjithsesi GVJ konstatoi se këto raporte nuk janë publike në website të Universitetit ³⁵⁷ .
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Raporti i vlerësimit përfshin evidentimin e çështjeve për përmirësim dhe në përputhje me Manualin e Cilësisë ³⁵⁸ hartohet një plan masash për të adresuar magësitë e evidentuara ^{359, 360} . Gjithsesi në rastin specifik të programit Master i Shkencave në “Psikologji” me profil “Psikologji Shkollore” nuk është paraqitur evidencë konkrete mbi aspekte specifike të cilat janë adresuar në një plan masash.
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e	Raporti periodik i vlerësimit të brendshëm ³⁶¹ përdoret në funksion të identifikimit të çështjeve për përmirësim dhe rritjes së cilësisë së programeve. Disa prej mënyrave sesi rritet cilësia e programeve

³⁵⁵ Evidenca: Website <https://fshs-ut.edu.al/rreth-fakultetit/sigurimi-i-cilesise>

³⁵⁶ Evidenca: Shënime gjatë vizitës

³⁵⁷ Evidenca: Website <https://fshs-ut.edu.al/rreth-fakultetit/sigurimi-i-cilesise>

³⁵⁸ Evidenca 1.11 Manuali i cilësisë.

³⁵⁹ Evidenca 2.17. Raporte periodike NISBC 2023, 2024.

³⁶⁰ Evidenca shtesë: Evidenca nr. 9. Plane pune NISBC 1.

³⁶¹ Evidenca 2.17. Raporte periodike NISBC 2023, 2024.

veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	të studimit përfshijnë rishikimin e strukturës së syllabuseve në përputhje me komentet/rekomandimet nga stafi dhe studentët, përditësimin dhe pasurimin e literaturës etj.			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Sikundër përmendet në Manualin e Cilësisë ³⁶² por edhe gjatë takimeve në institucion, stafi akademik dhe studentët përfshihen në procesin e sigurimit të brendshëm të cilësisë në forma të ndryshme, si vlerësimet periodike në lidhje me programin e studimit, trajnimet periodike të stafit me funksion rritjen e cilësisë në mësimdhënie etj ^{363, 364} .			
Konkluzione	<i>UT siguron transparencë në lidhje me politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programet e studimit. Raporti vjetor publikohet online, por gjithmonë në respektim të aspektit etik dhe mbrojtjes së të dhënave personale.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

³⁶² Evidenca 1.11 Manuali i cilësisë

³⁶³ Evidenca shpërndarë: Evidenca nr. 9. Plane pune NJSBC 1.

³⁶⁴ Evidenca: Shënime gjatë vizitës

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë “Master i Shkencave në Psikologji” me profil në “Psikologji Shkollore” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti i Tiranës”.

Pikat e forta dhe afirmime

1. UT/FSHS ka një përvojë të gjatë, të konsoliduar dhe vlerësohet si institucion lider në fushën e Arsimit të Lartë në Shqipëri.
2. UT/FSHS/DPP që ofron programin e studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në Psikologji, me profil në Psikologji Shkollore, ka projektuar strategji të qarta për zhvillimin institucional, sigurimin e cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, zgjerimin e bashkëpunimeve dhe partneriteteve në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, si dhe synon ndërkombëtarizimin e programit të studimit të marrë në vlerësim.
3. Stafi akademik me kohë të plotë që mbulon programin e studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në Psikologji, me profil në Psikologji Shkollore është i kualifikuar me grada e tituj, dhe demonstroi përkushtim për sigurimin e cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Trupa akademike ka përvojë akademike dhe praktike që përshtatet me programin aktual dhe specifikën e lëndëve/moduleve që mbulon në programin e studimit të marrë në vlerësim.
4. FSHS/DPP, ka realizuar marrëveshje bashkëpunimi në nivel institucional për organizimin dhe përmbushjen e qëllimeve të praktikës profesionale, si dhe veprimtarive të tjera mësimore për realizimin e programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në Psikologji, me profil në Psikologji Shkollore.
5. FSHS/DPP demonstroi se bën përpjekje të vazhdueshme për të qenë në kontakt me tregun e punës, duke u mundësuar studentëve praktikë profesionale dhe mundësi punësimi. Përqindja e studentëve të punësuar është inkurajuese për programin e marrë në vlerësim.
6. Studentët janë të kënaqur me klimën positive institucionale dhe ndërveprimin me stafin akademik të angazhuar në program.
7. Institucioni ka një infrastrukturë funksionale dhe cilësore në funksion të programit të studimit (Sallat e leksioneve me teknologji bashkëkohore, biblioteka fizike dhe elektronike etj).
8. Cilësia e stafit akademik është mjaft e lartë, me pedagogë të specializuar në fushën specifike të studimit.
9. Përfshirja e studentëve në jetën universitare, strukturat drejtuese, kërkimin shkencor dhe vlerësimin e cilësisë është maksimale.

Pika të dobta

1. Shpërndarja e ngarkesës së shprehur në kredite për kategoritë e veprimtarive formuese (A, B, C, D, E) të programit të studimit Master i Shkencave në Psikologji, me profil në Psikologji Shkollore, nuk përputhet respektivisht me ngarkesën në kredite të përcaktuar sipas VKM Nr. 41, datë 24.01.2018; (*Standardi II.1, kriteri 1*).
2. Një pjesë e personelit akademik me kontratë (PAK) e angazhuar në realizimin e programit të studimit Master i Shkencave në Psikologji, me profil në Psikologji Shkollore, rezulton të jetë me nivel MSc të kualifikimit. (*Standardi II.2, kriteri 1*).
3. Rënie e numrit të studentëve të regjistruar në programin e studimit Master i Shkencave në Psikologji, me profil në Psikologji Shkollore.
4. Mungesë e përfshirjes së bashkëpunëtorëve të jashtëm në procesin e sigurimit të standardeve të cilësisë.

Rekomandime

1. Të rishikohet Plani Mësimor i programit të studimit Master i Shkencave në Psikologji, me profil në Psikologji Shkollore, lidhur me ngarkesën e shprehur në kredite për kategoritë e veprimtarive formuese nga A në E, për të siguruar përputhje me përcaktimet e VKM Nr. 41, datë 24.01.2018.
2. Të pasqyrohet në Planin Mësimor informacioni i nevojshëm për formën e kontrollit të dijeve/shlyerjes së lëndëve/moduleve, duke specifikuar lëndët që shlyen me provim (P) dhe lëndët/modulet apo praktika që shlyen me firmë (F).
3. Rekomandohet që institucioni të rrisë përpjekjet konkrete për promovim të programit të studimit në mënyrë që të reflektohet në rritjen e numrit të studentëve.
4. Rekomandohet përfshirja e bashkëpunëtorëve të jashtëm në procesin e monitorimit dhe vlerësimit të standardeve të cilësisë.

Evaluation's conclusions for the second cycle study program Master of Sciences in "School Psychology" provided by the Higher Education Institution "University of Tirana"

Strengths and affirmations

1. UT/FSHS has a long, consolidated experience and is regarded as a leading institution in the field of Higher Education in Albania.
2. UT/FSHS/DPP, which offers the second cycle study program Master of Science in Psychology, with a profile in School Psychology, has designed clear strategies for institutional development, ensuring the quality of teaching and scientific research, expanding collaborations and partnerships at the national and international level, and aims to internationalize the study program under evaluation.


3. The full-time academic staff covering the second-cycle study program Master of Science in Psychology, with a profile in School Psychology are qualified with degrees and titles, and demonstrate commitment to ensuring the quality of teaching and research. The academic body has academic and practical experience that fits the current program and the specificity of the subjects/modules it covers in the program of study taken into consideration.
4. FSHS/DPP, has implemented cooperation agreements at the institutional level for the organization and fulfillment of the goals of professional practice, as well as other educational activities for the realization of the study program of the second cycle Master of Science in Psychology, with a profile in School Psychology.
5. FSHS/DPP demonstrates that it makes continuous efforts to be in contact with the labor market, providing students with professional practice and employment opportunities. The percentage of employed students is encouraging for the program under evaluation.
6. Students are satisfied with the positive institutional climate and the interaction with the academic staff engaged in the program.
7. The institution has a highly functional infrastructure, including classrooms equipped with the latest technology, library (online and hard copy etc.)
8. High quality academic staff, specialized in the specific field of study.
9. Student involvement in university life, management bodies, scientific research, quality evaluation etc.

Weaknesses

1. The distribution of the load expressed in credits for the categories of formative activities (A, B, C, D, E) of the study program Master of Science in Psychology, with a profile in School Psychology, does not correspond respectively with the load in credits determined according to VKM No. 41, dated 24.01.2018; (**Standard II.1, criterion 1**).
2. A part of the academic staff with a contract (PAK) engaged in the implementation of the study program Master of Science in Psychology, with a profile in School Psychology, turns out to be at the MSc level of qualification. (**Standard II.2, criterion 1**).
3. Decreasing number of students enrolled in the study program Master of Science in Psychology, with a profile in School Psychology.
4. No involvement of external collaborators in the process of quality assurance of the study program.

Recommendation

1. To review the Curriculum / Academic Plan of the study program Master of Science in Psychology, with a profile in School Psychology, regarding the load expressed in credits for the categories of formative activities from A to E, to ensure compliance with the provisions of VKM No. 41, dated 24.01.2018.
2. To reflect in the Curriculum / Academic Plan the necessary information for the form of knowledge control for the subjects/modules, specifying the subjects that are given with an exam (P) and the subjects/modules or practices that are given without an exam (F).
3. We recommend the institution to increase efforts in promoting the study program in order to increase the number of students enrolled in this program.
4. We recommend the involvement of external collaborators in the process of quality assurance of the study program.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X